KOMUNITETI MYSLIMAN I SHQIPËRISË

E DREJTA ISLAME
(FIKH)
II

Tekst mësimor për shkollat e mesme fetare Islame

Përkthyes: Dr. MITHAT HOXHA

STAMBOLL, 2013

Përpunimi kompjuterik

dhe kapakët: Mustafa KAYAN

Shtypur në Shtëpinë Botuese ERKAM

Tel.0090 212 671 07 07

Tirazhi : 2.000

Viti i Botimit: Stamboll, 2013

Ky tekst është përgatitur nga një komision pranë
Qendrës së Studimeve Shkencore Islamike
Stamboll

Komuniteti Mysliman i Shqipërisë

بسم الله الرحمن الرحيم

PJESA I
AGJËRIMI

ÇËSHTJET

A. Përkufizimi, rëndësia, urtësia dhe dobitë e agjërimit
2. Detyrimi (farz) i agjërimit
3. Llojet e agjërimit
4. Kushtet, konkluzioni dhe vendimi i agjërimit
5. Gjërat që e prishin dhe nuk e prishin agjërimin
6. Ndëshkimi i prishjes së agjërimit
7. Rastet kur prishja e agjërimit kërkon edhe kazanë, edhe kefaretin
8. Rastet kur prishja e agjërimit kërkon vetëm kazanë
9. Gjërat që janë ose s'janë mekruh për agjëruesin
10. Gjërat e pëlqyeshme (mustehab) të agjërimit
11. Justifikimet që e bëjnë normal mosmbajtjen ose prishjen e agjërimit
12. Shpërblimi (fidje) i agjërimit
13. Lutjet e agjërimit
14. I'tikafi

PUNË PËRGATITORE

1. Mësoni, mundësisht nga një mjek, ndikimet pozitive të agjërimit mbi shëndetin e njeriut.
2. Merrni njohuri nga mësuesi mbi urtësinë dhe vlerat e agjërimit.
3. Nga një libër ilmihali, mësoni rastet kur prishet agjërimi.
4. A ka ndodhur të agjëroni vetë ose të takoni njerëz që agjërojnë jashtë Ramazanit? Ç'agjërime janë agjërimet jashtë Ramazanit?
5. A keni ngrënë iftar me të tjerë? Sipas jush, a kanë ndryshime iftaret e përbashkëta me hajet e tjera të përbashkëta në ditë të tjera? Nëse kanë ndryshime, cilat janë këto?
6. Ç'lehtësi i njeh feja jonë një njeriu të moshuar si dhe një të sëmuri sa për të mos agjëruar dot? Merrni njohuri për këtë nga librat e fikhut.

A. PËRKUFIZIMI, RËNDËSIA, URTËSIA DHE DOBITË E AGJËRIMIT

a. Kuptimi leksikor dhe terminologjik i fjalës "agjërim"

Përgjegjëset arabishte të fjalës **agjërim** janë **saum** dhe **sijam**. Kuptimi leksikologjik i fjalës arabishte saum është *shmangie nga një veprim ose punë e caktuar, ndërprerje e ushqyerjes.*

Si një term i të drejtës Islame (fikh), agjërimi është, për personat nën përgjegjësinë e agjërimit, ndërprerja me qëllim adhurimi e ushqyerjes dhe marrëdhënieve seksuale nga agimi i parë (fexhrul sidk) e gjer në perëndimin e diellit.

Siç kuptohet, koha e agjërimit është periudha nga agimi i parë e gjer në perëndimin e diellit. Kurse në polet ose në zonën polare ku dita dhe nata zgjasin nga gjashtë muaj, kjo periudhë rregullohet sipas kalendarit të zonës më të afërt me shkëmbim normal mes ditës dhe natës.

b. Rëndësia dhe dobitë e agjërimit

Adhurimi i agjërimit ka shumë anë të dobishme për njeriun. Njeriu formon disa shprehi të këqija edhe pse e di se ato janë të dëmshme si dhe bën gjynahe për shkak të dobësisë së vullnetit. Duke e forcuar vullnetin, agjërimi siguron marrjen nën kontroll të kërkesave dhe dëshirave të vetes (nefs). Njeriu, i cili, në saje të agjërimit, parandalon disa kërkesa të vetes që e shtyjnë në gjynah, duke ndenjur, kështu, larg gjynaheve, arrin pjekuri shpirtërore. Njeriu që agjëron tregon kujdes për të qëndruar larg ndalimeve të vëna nga Allahu. Njeriu, i cili e forcon vullnetin në saje të agjërimit, përpiqet t'i çojë në vend ashtu siç duhet urdhrat e Allahut.

Njeriu që agjëron, meqë mbetet tërë ditën i pangrënë, e kupton më mirë vlerën e të mirave (nimet), për rrjedhojë, ruhet nga shpenzimi i tyre i panevojshëm. Krahas kësaj, ai nuk e nxjerr nga mendja Zotin e vet që ia ka dhuruar çdo gjë që ka. Kështu, njeriu e mban larg veten nga gjynahet.

Njeriu mund të përballet në jetë me vështirësi dhe fatkeqësi të ndryshme, për përballimin e të cilave duhet të jetë i durueshëm. Agjërimi e mëson njeriun të jetë i durueshëm. Profeti ynë (a.s.) ka bërë fjalë për këtë të vërtetë duke thënë: *"Agjërimi është gjysma e durimit!"*[1]

1 Sunenu ibn Mâxhe, Kitabu's-sijam, 44.

Ai që agjëron njihet me gjendjen e të varfërve, të cilëve, në kohë agjërimi, u zgjat dorën e ndihmës më shumë se në kohë të tjera.

Një tjetër hadith që shpreh rëndësinë e agjërimit, është kështu. Një njeri shkon te Profeti dhe i thotë: *"Më urdhëro për një gjë me të cilën Allahu të më japë dobi!"*

Dhe Profeti i tha kështu: *"Po të këshilloj të agjërosh dhe të vazhdosh me agjërim, sepse ai është një adhurim i pashoq!"*[2]

Sa për dobitë e tij, agjërimi, meqë vë në veprim ndjenjat e mëshirës, dhembshurisë dhe dashurisë te njeriu, bën që vendin e nervozizmit dhe zemërimit ta zërë paqja.

Agjërimi bëhet shkak që trupi të pushojë, të mos bjerë shpejt dhe të funksionojë mirë. Në saje të agjërimit, yndyrnat e tepërta të mbledhura në trup shkrihen dhe trupi lehtësohet. Prandaj Profeti ka porositur: *"Agjëroni që të keni shëndet!"*[3]

Një tjetër hadith i Profetit lidhur me agjërimin është kështu:

"Agjërimi është një mburojë që e mbron njeriun përballë gjynaheve. Ai që agjëron të mos thotë fjalë të këqija. Atij që kërkon të ngacmohet me të, t'i thotë dy herë: "Unë jam i agjëruar!" Zoti ka urdhëruar: "Ai që agjëron, ka lënë ngrënien, pirjen dhe dëshirat seksuale për pëlqimin tim. Agjërimi është një adhurim që bëhet vetëm për pëlqimin tim. Edhe shpërblimin për të unë e jap!"[4]

Ky hadith profetik bën të ditur se agjërimi e ruan njeriun prej gjynaheve si dhe parashtron vlerën e agjërimit te Allahu. Është vështirë që në agjërim të përzihen dukja dhe qëllime të tjera. Agjërimi është një adhurim me shumë vlera i bërë vetëm për pëlqim të Allahut. Kur njeriu është i agjëruar, shpirti i tij që qëndron larg gjynaheve e të këqijave, fiton pjekuri, morali i tij zbukurohet.

Ngaqë bëhet pretekst për faljen e gjynaheve, agjërimi i jep njeriut shpirtërisht qetësi dhe e bën të kënaqur. Njeriu që agjëron ndjen lumturinë e plotësimit të detyrës së robit ndaj Zotit të vet.

Faktin që agjërimi bëhet shkak për faljen e gjynaheve Profeti e ka deklaruar edhe me këtë hadith: *"Nëse dikush agjëron duke i besuar vlerës së muajit të Ramazanit dhe duke e shpresuar shpërblimin nga Allahu, i falen gjynahet e së kaluarës!"*[5]

Agjërimi është një adhurim që bën të kuptohet rëndësia e ndihmës reciproke midis njerëzve, e pjesëmarrjes në hallet e të varfërve.

2 Sunenu'n-Nesâî, Kitabu's-sijam, IV, 165.

3 Sunenu't-Taberânî, Babu's-saum, 5.

4 Sahîhu'l-Muslim, Kitabu's-sijam, 162.

5 Sahîhu'l-Buhârî, Kitabu's-saum, vëll. II, f. 288.

B. DETYRIMI (FARZ) I AGJËRIMIT

Njëri prej pesë kushteve të Islamit është agjërimi në muajin e Ramazanit. Agjërimi është bërë i detyruar (farz) në vitin e dytë të emigrimit (hixhretit) të profetit Muhammed nga Meka në Medine. Në Kuran urdhërohet:

يَا أَيُّهَا الَّذِينَ آمَنُواْ كُتِبَ عَلَيْكُمُ الصِّيَامُ كَمَا كُتِبَ عَلَى الَّذِينَ مِن قَبْلِكُمْ لَعَلَّكُمْ تَتَّقُونَ * ... فَمَن شَهِدَ مِنكُمُ الشَّهْرَ فَلْيَصُمْهُ ...

"O ju që besuat! Agjërimi është bërë farz për ju siç qe bërë edhe për paraardhësit tuaj, që të ruheni (nga kundërshtimi i Allahut)**."**[6] Si dhe: **"... cili prej jush arrin muajin e Ramazanit, të agjërojë!.."**[7]

Edhe i Dërguari i Allahut ka porositur: "Islami është ngritur mbi pesë themele: dëshmimi se s'ka zot tjetër veç Allahut dhe se Muhammedi është i dërguari i

6 Kurani, El-Bekare: 183.

7 Kurani, El-Bekare: 185.

Allahut, falja e namazit, dhënia e zekatit, kryerja e haxhit dhe agjërimi i muajit të Ramazanit."[8]

Siç kuptohet nga këto ajete dhe hadithi profetik, agjërimi çdo vit i muajit të Ramazanit është farz (detyrim) për çdo mysliman nën përgjegjësi.

Kushtet e detyrimit (farz) të agjërimit të Ramazanit

Që agjërimi i Ramazanit të jetë farz për një njeri, duhet që ai njeri:

* Të bartë kushtet e personit nën përgjegjësi për të agjëruar, domethënë, të jetë mysliman, të ketë zhvillim mendor normal dhe të ketë arritur moshën e pubertetit;

* Të mos jetë udhëtar dhe të mos ketë pengesa të tilla si sëmundje, etj.;

* Të ketë hyrë muaji i Ramazanit, sepse agjërimi bëhet farz kur hyn muaji i Ramazanit. Profeti ka thënë: "Kur të shihni lindjen e hënës së muajit të Ramazanit, agjëroni!"[9] (110) Pra, që agjërimi i Ramazanit të bëhet farz, duhet që të hyjë muaji i Ramazanit.

C. LLOJET E AGJËRIMIT

Agjërimi ndahet në lloje sipas konkluzioneve: agjërimi farz, agjërimi vaxhib, agjërimi nafile, agjërimi mekruh.

a. Agjërimi farz

Agjërimi farz ndahet në dy nënlloje:

1. Agjërimi i Ramazanit. Është agjërimi për mbajtjen e të cilit në muajin e Ramazanit janë nën përgjegjësi myslimanët me zhvillim mendor normal që kanë arritur moshën e pubertetit dhe s'kanë ndonjë justifikim. Agjërimi i Ramazanit ka kohë (kalendarike) të caktuar.

2. Agjërimet kaza (zëvendësim pas) dhe kefaret (shlyerje). Agjërimi kaza është zëvendësimi i agjërimit të Ramazanit të pakryer në kohën e vet ose të prishur për shkak të ndonjë pengese. Agjërimi kefaret është shlyerja e agjërimit të Ramazanit të prishur pa justifikim.

8 Sahîhu'l-Buhârî, Kitabu's-iman, vëll. I, f. 8; Sahîhu'l-Muslim, Kitabu'l-iman, 21.

9 Sunenu't-Tirmidhi, Babu's-saum, 683.

Agjërimet kaza dhe kefaret mbahen jashtë muajit të Ramazanit në ditët kur veprimi i agjërimit konsiderohet normal (mubah).

b. Agjërimi vaxhib

Është agjërimi i paurdhëruar nga feja, por i bërë detyrim (vaxhib) për personin për një shkak çfarëdo. Edhe ky ndahet në dy nënlloje:

1. Agjërimi i kushtimit (adak). Është agjërimi i kushtuar (i premtuar) për një shkak çfarëdo si dhe agjërimi i'tikaf gjithashtu i kushtuar (i premtuar). Agjërimi i'tikaf mbahet në ditët i'tikaf, kurse agjërimi i kushtuar mbahet në ditët kur është premtuar për t'u mbajtur. Agjërimi i kushtuar, mbajtja e të cilit nuk është premtuar për ditë të caktuara, mbahet në një kohë të përshtatshme.

2. Kazaja e agjërimit nafile. Është vaxhib (i domosdoshëm) edhe agjërimi nafile i filluar dhe, pastaj, i prishur.

c. Agjërimet nafile

Janë agjërimet që nuk janë farz apo vaxhib. Agjërimet e mbajtura në kohët si më poshtë, emërtohen si agjërime nafile:

1. Agjërimi i mbajtur në ditën e nëntë dhe të dhjetë ose në ditën e dhjetë dhe të njëmbëdhjetë të muajit muharrem.

2. Agjërimi i mbajtur në ditën e trembëdhjetë, të katërmbëdhjetë dhe të pesëmbëdhjetë të muajve hënorë si dhe në ditët e hënë dhe të enjte të javës. Janë agjërime nafile edhe agjërimi gjashtëditor në muajin shevval, agjërimi një ose dy ditë para Bajramit të Kurbanit si dhe agjërimi një ditë po e një ditë jo i Hz. Daudit (a.s.).

3. Agjërimet e mbajtura jashtë agjërimeve të përshkruara më sipër, për pëlqim të Allahut dhe në kohë të përshtatshme.

d. Agjërimet mekruh

Janë agjërimet, kryerja e të cilave, për shkaqe të ndryshme, konsiderohet mekruh (e shëmtuar). Këto ndahen në dy nënlloje:

1. Agjërimet tahrimisht mekruh (ndalimisht mekruh, mekruh ngaqë agjërimi në atë apo ato ditë është haram, i ndaluar): Agjërimi në ditën e parë të Bajramit të Ramazanit dhe në të gjitha ditët e Bajramit të Kurbanit është mekruh pranë haramit.

2. Agjërimet tenzihisht mekruh (përjashtimisht mekruh):

* Agjërimi i mbajtur vetëm në ditën e Ashures (dita e dhjetë e muharremit). Që agjërimi i mbajtur këtë ditë të mos jetë mekruh, duhet agjëruar edhe dita e mëparshme (dita e nëntë e muharremit) ose dita e pasme (dita e dhjetë e muharremit).

* Agjërimi në ditën e Nevruzit me qëllim respekti për këtë ditë.

* Agjërimi i mbajtur vetëm ditën e xhuma ose vetëm ditën e shtunë. Nuk quhet mekruh nëse agjërohet edhe dita e mëparshme ose e mëpasme. Për shembull, personi që dëshiron të agjërojë ditën e xhuma, duhet të agjërojë edhe të enjten ose të shtunën.

* Agjërimi i dy ditëve radhazi pa e prishur, domethënë pa ngrënë iftar pas agjërimit të ditës së parë.

* Agjërimi me qëllim Ramazanin në *ditën e dyshimtë*, atë ditë kur ende nuk është përcaktuar nëse është apo jo ajo dita e parë e Ramazanit, domethënë pa u përcaktuar ende fillimi i Ramazanit.

* Mbajtja e një agjërimi vaxhib (si, p.sh., agjërimi i kushtimit) në ditën e dyshimtë.

* Edhe agjërimi i haxhinjve në ditët tervije dhe arife konsiderohet në mënyrë përjashtuese mekruh nëse i rëndon shumë.

e. Agjërimi nedher (kushtuar Allahut), konkluzioni dhe vendimi i tij

Agjërimi kushtuar Allahut (nedhr) është agjërimi për hir të Allahut që dëshiron ta mbajë dikush. Ky agjërim është dy nënllojesh:

1. Agjërimi i pakushtëzuar, i cili bëhet i detyrueshëm (vaxhib) të kryhet në ditën kur është premtuar, nëse është premtuar një ditë e caktuar, ose në një ditë çfarëdo nëse nuk është premtuar një ditë e caktuar. Për shembull, nëse dikush ka premtuar se *do të agjërojë ditën e hënë të pritshme për hir të Allahut,* duhet (vaxhib) të agjërojë të hënën e pritshme. Por nëse ka premtuar se *do të agjërojë një ditë për hir të Allahut,* duhet (vaxhib) të agjërojë një ditë kur të dëshirojë.

2. Agjërimi kushtuar Allahut lidhur me një kusht të caktuar. Kur të realizohet kushti në fjalë, agjërimi i premtuar duhet (vaxhib) mbajtur. Për shembull, personi që ka premtuar se *do të agjërojë tri ditë për hir të Allahut nëse i realizohet një punë,* duhet (vaxhib) t'i agjërojë ditët e premtuara sapo t'i realizohet dëshira. Por përsa kohë dëshira nuk i është realizuar, agjërimi i ditëve të premtuara nuk është vaxhib.

D. KUSHTET, KONKLUZIONI DHE VENDIMI I AGJËRIMIT

a. Kushtet e detyrimit (farz)

Që agjërimi të jetë detyrim (farz) për një person, duhet që ai të plotësojë këto kushte:

1. Të jetë mysliman.

2. Të ketë zhvillim mendor normal dhe të ketë arritur moshën e pubertetit. Agjërimi nuk është farz për fëmijët dhe të sëmurët mendorë.

3. Të jetë i aftë për të agjëruar. Agjërimi nuk është farz për personat me pleqëri të thellë që nuk mund të agjërojnë ose për të sëmurët. Pleqtë japin kefaret (vlerë shlyerëse) për ditët e paagjëruara, kurse të sëmurët i agjërojnë kaza ditët e paagjëruara pasi të shërohen dhe të rifitojnë shëndetin.

Agjërimi nuk është farz për gratë shtatzana ose me fëmijë në gji në gjendjen në të cilën agjërimi do t'i dëmtonte si ato vetë, ashtu edhe fëmijën dhe vazhdon të mos jetë farz për gjatë gjithë periudhës kur vazhdon kjo gjendje. Gratë në këtë gjendje i agjërojnë kaza më pas ditët e paagjëruara.

4. Të jetë vendas ose me banim të qëndrueshëm (mukim). Personi që quhet fetarisht udhëtar, nuk e ka të detyruar (farz) të agjërojë gjatë gjithë kohës kur quhet udhëtar. Megjithëkëtë, po të dëshirojë, mund të agjërojë. Ditët e paagjëruara i agjëron kaza pasi të ketë përfunduar koha kur quhet udhëtar dhe pas Ramazanit.

b. Kushtet e rregullsisë së agjërimit

1. Qëllimi (nijeti) i agjërimit. Duhet bërë qëllim me zemër për të agjëruar. Kjo gjë është kusht që agjërimi të jetë i rregullt. Kurse shqiptimi i qëllimit (nijetit) është sunnet.

Nijeti më i mirë është nijeti i bërë në mbrëmje ose para se të zbardhë. Po s'qe e mundur kjo, mund të bëhet nijet për agjërimin e asaj dite - nëse nuk është bërë gjer në atë çast ndonjë veprim që e prish agjërimin - gjer afër mesditës. Nga mesdita e gjer në perëndimin e diellit nuk mund të bëhet nijet për asnjë lloj agjërimi (që i përket asaj dite). Edhe ngritja në syfyr me qëllim për të agjëruar ditën në vazhdim, quhet nijet.

Nijeti në kazanë e agjërimit të Ramazanit mund të bëhet nga mbrëmja gjer në të zbardhur. Nijeti i bërë pas këtij caku nuk është i vlefshëm. Duke bërë këtë nijet,

duhet theksuarse bëhet *për kazanë e agjërimit të Ramazanit*. Edhe kur bëhet nijet për agjërimet e tjera duhet theksuar se për ç'agjërim po bëhet nijet.

2. Femra s'duhet të jetë me të përmuajshme ose lehonë. Që femra të mund të agjërojë, s'duhet të jetë me të përmuajshme ose lehonë. Femra me të përmuajshme ose lehonë, ditët e paagjëruara të Ramazanit i agjëron kaza pasi të ketë përfunduar periudha përkatëse e të përmuajshmeve ose lehonia, të jetë pastruar si dhe gjithmonë pas Ramazanit.

c. Konkluzioni dhe vendimi i agjërimit

Agjërimi i Ramazanit është farz i njëjtë (fardu'l-ajn) për të gjithë myslimanët që plotësojnë kushtet përkatëse.

Nënvleftësimi i agjërimit ose mohimi i detyrimit (farz) të tij bëhen shkak që personi të dalë nga feja. Kurse personi që beson se agjërimi i Ramazanit është detyrim (farz), por nuk agjëron pa pasur për këtë ndonjë justifikim, bëhet mëkatar.

E. GJËRAT QË E PRISHIN DHE NUK E PRISHIN AGJËRIMIN

a. Gjërat që e prishin agjërimin

Agjërimi prishet kur personi që agjëron, ha e pi me dashje, vjell me gojën plot me dashje, krijon afrí seksuale, pikon ilaç në hundë, pikon vaj në vesh, bën injeksion.

b. Gjërat që nuk e prishin agjërimin

* Ngrënia e pirja pa dashje, duke harruar.

* Ejakulimi (ihtilam) i pavullnetshëm.

* Kalimi në grykë i pluhurit ose mizës.

* Përcjellja e një thërrmije ushqimi më të vogël se një kokërr qiqër të mbetur mes dhëmbëve.

* Hyrja e ujit në vesh.

* Hyrja e jashtëvullnetshme e tymit në grykë.

* Përcjellja e të vjellës së pjesshme (jo goja plot) të ardhur nga stomaku.

* Pikimi i ilaçit në sy.

* Vjellja e jashtëvullnetshme. (Vjellja e vullnetshme duke provokuar me gishta si dhe me gojën plot e prish agjërimin).

* Heqja e dhëmbëve.

* Marrja (dhënia) e gjakut.

* Larja.

* Marrja erë luleve, esencave të mira. (Ka edhe që e pranojnë këtë si mekruh).

F. NDËSHKIMI I PRISHJES SË AGJËRIMIT

Nëse personi, i cili plotëson të gjitha kushtet për të qenë përgjegjës për të agjëruar, e prish pa justifikim dhe me dashje agjërimin e një dite Ramazani të filluar duke bërë në kohën e duhur nijet për të, duhet të bërë shlyerjen (kefaret) të agjërimit të prishur. Shlyerja (kefareti) e prishjes së agjërimit pa justifikim është çlirimi i një skllavi apo skllaveje. Por meqë në ditët tona s'ka skllevër, personi duhet të agjërojë si shlyerje (kefaret) 60 ditë njërën pas tjetrës. Ky është ndëshkimi i prishjes së agjërimit të një dite, kurse agjërimi kaza i asaj dite bëhet në ditën e 61-të. Nëse agjërimi i gjashtëdhjetë ditëve të njëpasnjëshme është i pamundur, në vend të kësaj mund të ushqehen 60 të varfër për një ditë të plotë ose të ushqehet një i varfër për gjashtëdhjetë ditë të plota. Edhe dhënia e vlerës të këtij ushqimi është i vlefshëm.

G. RASTET KUR PRISHJA E AGJËRIMIT KËRKON EDHE KAZANË, EDHE KEFARETIN

Kur personi nën përgjegjësi për të agjëruar kryen me qëllim njërin prej veprimeve të mëposhtme megjithëse është i agjëruar, ngarkohet edhe me shlyerjen (kefaretin) e prishjes së agjërimit, edhe me kazanë e tij:

* Ngrënia apo pirja e një gjëje të ngrënshme ose të pijshme.

* Përcjellja poshtë e shiut, borës apo breshërit të hyrë në gojë.

* Pirja e duhanit, thithja e burnotit.

* Kryerja e marrëdhënies seksuale.

* Ngrënia apo pirja e diçkaje pas përfoljes së dikujt, dhënies së gjakut ose vjelljes së pavullnetshme edhe pse dihet se këto veprime nuk e prishin agjërimin.

Në rastet e mëposhtme ndëshkimi i kefaretit bie dhe mbetet vetëm kazaja:

* Nëse një person, i cili e ka prishur agjërimin në ato kushte kur prishja ndëshkohet edhe me kefaret (shlyerje), edhe me kaza, shfaqet para iftarit një justifikim që e bën prishjen të rregullt (mubah), si: sëmundje, lindje fëmije, të përmuajshme, ndëshkimi i kefaretit bie.

Ndërkaq, nëse personi është bërë vetë shkaktar për sëmundjen, kefareti nuk bie. Për shembull, nëse një person e plagos veten në atë shkallë saqë të mos jetë i aftë për të agjëruar dhe e prish agjërimin, kefareti për të nuk bie. Po kështu nuk bie kefareti për personin i cili, pasi e ka prishur agjërimin, niset për në udhëtim me dëshirën e vet apo i detyruar. (Nëse personi e prish agjërimin pas daljes në udhë, duhet të bëjë vetëm kaza).

H. RASTET KUR PRISHJA E AGJËRIMIT KËRKON VETËM KAZANË

* Prishja e një agjërimi tjetër veç Ramazanit.

* Ngrënia e gjërave të pangrënshme ose që nuk është bërë zakon të hahen, si oriz i pazier, dhé, çakëll, letër, pambuk, etj.

* Bërja e injeksionit.

* Dhënia ilaç qeses së urinës.

* Tërheqja e ilaçit me hundë.

* Arritja në veshin e brendshëm e vajit apo ilaçit të pikuar në vesh.

* Arritja në stomak e ilaçit të hedhur mbi plagën në bark dhe në tru e ilaçit të hedhur mbi plagën në kokë.

* Vazhdimi i ngrënies dhe pirjes megjithëse ka kaluar koha e syfyrit, duke pandehur se nuk ka kaluar.

* Fillimi i ngrënies (hapja e agjërimit) pa ardhur koha e iftarit, duke pandehur se ka ardhur.

* Ejakulimi pas prekjes ose puthjes së bashkëshortes.

* Gëlltitja pa dashje e shiut, dëborës ose breshërit të hyrë në gojë. (Gëlltitja me dashje kërkon edhe kefaret).

* Nëse personi i cili, pasi ka ngrënë e pirë për harresë, kujton se është i agjëruar dhe vazhdon të hajë e të pijë duke pandehur se i është prishur agjërimi.

* Vajtja në grykë pa dashje e ujit të dhënë gojës dhe hundës gjatë abdestit.

* Prishja e agjërimit nën shtrëngim.

* Prishja e agjërimit pas daljes për në udhëtim.

* Gëlltitja e një thërrmije më të vogël se një kokërr qiqërr të mbetur mes dhëmbëve.

I. GJËRAT QË JANË OSE S'JANË MEKRUH PËR AGJËRUESIN

a. Gjërat që nuk janë mekruh për agjëruesin:

* Marrja erë e një gjëje erëmirë si trëndafili ose një locion parfumor (misk).

* Dhënia e gjakut nëse kjo nuk e dobëson sa për të mos qenë në gjendje për lëvizje.

* Përdorimi i misvakut ose larja e dhëmbëve me furçë.

* Marrja e ujit në gojë dhe shpëlarja e gojës; tërheqja e ujit me hundë.

* Lyerja (makiazh) e syve.

* Larja për t'u freskuar, veshja e rrobave të lagura.

b. Gjërat janë mekruh për agjëruesin

* Kontrolli i shijes së një gjëje ushqimore me kusht që të mos gëlltitet. Por nuk është mekruh për gruan që, duke u drojtur prej burrit ose nga frika është e detyruar ta kontrollojë shijen e gjellës.

* Përtypja e një cope letre ose bezeje pa qenë e nevojshme kjo gjë e pa justifikim.

* Mbledhja e pështymës në gojë dhe gëlltitja e saj.

* Kryerja nga agjëruesi e një pune të rëndë e dërrmuese që do t'ia bënte të pamundur agjërimin. Por nëse personi është i detyruar të punojë në një punë të tillë të rëndë, puna e tij nuk është mekruh.

* Teprimi i dhënies ujë gojës dhe hundës gjatë marrjes së abdestit.

J. GJËRAT E PËLQYESHME (MUSTEHAB) TË AGJËRIMIT

* Ngritja në syfyr.

* Ngrënia e iftarit para faljes së namazit të mbrëmjes që i ka hyrë koha.

* Hapja e agjërimit me hurma, ujë ose një gjë të ëmbël.

* Këndimi i një lutjeje para hapjes së iftarit. (Për shembull: **"Allahu im! Për ty agjërova, me atë që më ke dhënë ti e hapa, ty të besova, te ty u mbështeta!"**)

* Ruajtja prej fjalëve të panevojshme.

* Në Ramazan, më shumë ndihmë e më shumë sadaka se në muajt e tjerë për të afërmit dhe të varfrit.

* Hyrja në i'tikaf.

Lexim letrar
Si na mban agjërimi?

Shihni se si u tërheq vëmendjen Profeti ynë (a.s.) njerëzve që nuk e kanë kuptuar frymën e agjërimit:

"Sa e sa veta ka që agjërojnë, por s'përfitojnë asgjë tjetër veç urisë dhe etjes!"

Agjërimi gjatë të cilit personi nuk shmanget nga të folurit haram dhe nga veprimet haram, nuk i jep dobi njeriut. Ky hadith profetik i rëndësishëm duhet të na mbajë syçelë dhe ne, duke agjëruar, duhet t'u kushtojmë kujdes këtyre gjërave:

Qëllimi (nijeti) ynë duhet të jetë vetëm fitimi i pëlqimit të Allahut.

Gjatë gjithë kohës kur jemi të agjëruar duhet të përpiqemi që sytë, veshët, gjuhën, stomakun dhe të gjitha organet e tjera t'i mbajmë larg nga gjynahet dhe haramet.

Shpirtin dhe zemrën, sa të mundemi, t'i mbajmë lidhur pas Allahut të Lartë dhe t'ua kushtojmë dashurise dhe përmendjes së Tij.

T'ia njohim vlerën muajit të Ramazanit dhe t'i shtojmë adhurimet dhe veprat e mira.

Për të kaluar një agjërim të qetë e të begatë, të ushqehemi me masë, pa e mbushur stomakun në iftar e në syfyr plot e përplot, në mënyrë që të mundemi ta marrim edhe ushqimin shpirtëror për të cilin bëhet pretekst agjërimi.

Me sa të kemi mundësi, të përpiqemi të organizojmë iftare ku të ftojmë edhe të varfër për të fituar të mirën (thevabin) e ushqimit të të varfërve.

Agjërimi i mbajtur siç u përshkrua gjer këtu, do të bëhet, siç shprehet Profeti, *mburojë përballë gjynaheve* duke na mbrojtur për të mos rënë në to!

K. JUSTIFIKIMET QË E BËJNË NORMALE (MUBAH) MOSMBAJTJEN OSE PRISHJEN E AGJËRIMIT

Islami është feja e lehtësive. Allahu i Lartë nuk u ka ngarkuar robve të vet një barrë që nuk kanë mundësi ta përballojnë. Kjo vlen edhe për agjërimin. Kështu, lehtësitë e njohura për agjërimin bëhen të ditura në ajetet si më poshtë:

"(Agjërimi u bë farz për ju) **në ditë të caktuara. Kush nga ju të jetë i sëmurë ose udhëtar, bën kaza në ditë të tjera** (aq ditë sa s'ka agjëruar). **Ata që nuk kanë mundësi të agjërojnë** (sepse janë pleq ose vuajnë nga ndonjë sëmundje e pashpresë), **duhet të japin fidje sa ushqimi i një të varfri. Megjithëkëtë, kush bën mirë vullnetarisht, e ka në dobi të vet. Po ta dinit, mbajtja e agjërimit** (megjithëse është e vështirë), **është më e dobishme për ju!"**[10]

a. Justifikimet që e bëjnë normale (mubah) mosmbajtjen ose prishjen e agjërimit të Ramazanit, konkluzioni dhe vendimi mbi to

Në rastet e mëposhtme, feja jonë e ka quajtur normale (mubah) mosmbajtjen e agjërimit ose prishjen e agjërimit të filluar:

1. Udhëtim. Në Ramazan mund të mos agjërojë personi që shkon në një vend 90 km. larg me qëllim udhëtimi, me kusht që të rrijë atje më pak se pesëmbëdhjetë ditë. Edhe personi që niset për udhë i agjëruar, mund ta prishë agjërimin. Ndërkaq, për ata që janë të fuqishëm, është më mirë të agjërojnë, sepse, kështu, e kryejnë agjërimin në kohën e duhur. Ditët e paagjëruara gjatë udhëtimit agjërohen kaza më pas.

2. Sëmundje. Personi që ka frikë se mos agjërimi i shkakton vdekjen, ia rëndon sëmundjen, ia zgjat periudhën e shërimit ose i dëmton mendjen, mund të mos agjërojë ose mund ta prishë agjërimin e filluar. Edhe personi që e mëson nga vizita te një mjek mysliman se, po të agjërojë, do të sëmuret ose që, me një parandjenjë të fuqishme, e kupton se do të sëmuret, konsiderohet si i sëmurë. Edhe personi që kujdeset për të sëmurin mund ta lërë agjërimin në qoftë se kujdesi e bën krejtësisht të pafuqishëm dhe, ditët e paagjëruara i bën kaza më pas.

3. Gruaja me fëmijë në gji ose shtatzënë. Nëse gruaja me fëmijë në gji ose shtatzënë ka frikë se, po të agjërojë, do t'i shkaktojë dëm vetes ose fëmijës, nuk agjëron dhe, ditët e paagjëruara i bën kaza më pas. Kjo vlen edhe për mëndeshën, domethënë për gruan që i jep gji një fëmije të huaj.

10 Kurani, El-Bekare: 184.

4. Pleqëri. Është e mundshme, e lejueshme (xhaiz) që burrat dhe gratë shumë pleq, të paaftë për të agjëruar, të mos agjërojnë. Këta s'janë të detyruar as për kazanë e agjërimit të pakryer. Por duhet të japin fidje për çdo ditë të paagjëruar.

5. Luftë kundër armikut. Nëse personi që po lufton kundër armikut, ka frikë se agjërimi mund ta dobësojë duke e bërë të pafuqishëm, mund të mos agjërojë gjer në përfundim të luftës. Ditët e paagjëruara i bën kaza më pas.

6. Gjendja nën shtrëngim dhe kërcënim. Personi që kërcënohet me jetë ose me dëmtim të një organi, e prish agjërimin dhe e bën kaza më pas.

7. Uri ose etje e fortë. Personi që ka frikë se nga uria ose etja e fortë do të dëmtohet ose do t'i prishet ekuilibri mendor, e prish agjërimin dhe e bën kaza kur të ketë forca për të agjëruar.

8. Gjendja me të përmuajshme ose në lehoni. Femra, të cilës i fillojnë të përmuajshmet duke qenë e agjëruar ose bën lindje, e prish agjërimin. Gjatë periudhës me të përmuajshme ose në lehoni, agjërimi për të është i palejueshëm (nuk është xhaiz). Gruaja në këto kushte, ditët e paagjëruara i bën kaza pasi të përfundojë periudha përkatëse e të përmuajshmeve ose lehonisë dhe të bëjë pastrimin e duhur.

9. Puna në punë të rënda. Nëse personi që punon në një punë të rëndë ka frikë se po të agjërojë, do të sëmuret ose do të vdesë, nuk agjëron. Kur një rrezik i tillë nuk ekziston më, ditët e paagjëruara i bën kaza. Por nëse rreziku vazhdon dhe nuk i bëjnë kaza, japin fidje.

b. Justifikimet që e bëjnë normale (mubah) prishjen e agjërimit nafile, konkluzioni dhe vendimi mbi to

Prishja e agjërimit nafile është e lejueshme (xhaiz) në këto kushte:

1. Kur shfaqet njëra prej gjendjeve që e bëjnë normale mosagjërimin.

2. Kur gruan nuk e lejon burri të agjërojë.

3. Kur personi ftohet në një gosti.

Kazaja e agjërimit të prishur është vaxhib (domosdoshmëri). Personi që nuk e bën kazanë, mban përgjegjësi për këtë.

L. SHPËRBLIMI (FIDJE) I AGJËRIMIT

Fidja (shpërblimi) është zëvendësimi material i çdo agjërimi farz dhe vaxhib të pakryer që janë të detyruar ta bëjnë personat e paaftë fizikisht. Dhënia e fidjes për agjërimin mbështetet në ajetin sipas të cilit, **"... ata që nuk kanë mundësi të agjërojnë** (sepse janë pleq ose vuajnë nga ndonjë sëmundje e pashpresë), **duhet të japin fidje sa ushqimi i një të varfri ..."**[11] Një fidje është ushqimi ditor (mëngjes-mbrëmje) i një të varfri ose dhënia atij të varfri e vlerës së ushqimit ditor në monedhë. Madhësia e kësaj vlere është sa një sadaka fitri.

Personi që nuk gjen mundësi të agjërojë për shkak pleqërie ose një sëmundjeje që bëhet pengesë për agjërim të vazhdueshëm, jep fidje për çdo ditë të paagjëruar. Fidje u jepet personave që mund t'u jepet zekat. Një të varfri mund t'i jepet si fidje ushqimi i një dite ose edhe vlera e tij në monedhë. Fidja për më shumë se një ditë të paagjëruar mund t'i jepet e tëra menjëherë një të varfri ose të ndahet midis disa të varfërve.

Fidja mund të jepet në fillim të Ramazanit, gjatë Ramazanit ose në fund të tij. Ata që s'kanë mundësi të japin fidje, i kërkojnë Allahut falje, sepse Allahu nuk ngarkon askënd me përgjegjësinë që s'mund ta bartë.

Reduktimi i agjërimit (iskatu saum)

Fjala iskat do të thotë *rrëzim, reduktim, kompensim*. Iskati është kompensimi i agjërimeve farz dhe vaxhib të pakryera të një të vdekuri, i cili nuk ka dhënë as fidjen e tyre. Ky kompensim bëhet duke dhënë një fidje për çdo ditë agjërimi farz ose vaxhib të paagjëruar.

Një person, me qëllim që të shpëtojë nga borxhi i agjërimeve të pambajtura, lë porosi që me një të tretën e trashëgimit të vet të paguhet fidja e atyre agjërimeve. Nëse personi nuk lë porosi, iskatin mund ta japë edhe trashëgimtari i tij ose dikush tjetër. Me iskatin shpresohet falja e borxhit të të vdekurit.

M. LUTJET E AGJËRIMIT

Ka hadithe që thonë se lutjet e bëra duke hapur agjërimin, do të pranohen nga Allahu. Një prej këtyre është edhe hadithi: *"Lutja e bërë në kohën e iftarit nga ai që agjëron, nuk hidhet poshtë!"*[12]

11 Kurani, El-Bekare: 184.

12 Sunenu Ibn Mâxhe, hadithi nr. 1753.

Është rrëfyer (rivajet) se Profeti (a.s.) ka bërë këto lutje në iftar:

اَللَّهُمَّ لَكَ صُمْتُ، وَبِكَ آمَنْتُ، وَعَلَيْكَ تَوَكَّلْتُ، وَعَلَى رِزْقِكَ أَفْطَرْتُ، وَصَوْمَ الْغَدِ مِنْ شَهْرِ رَمَضَانَ نَوَيْتُ فَاغْفِرْ لِي مَا قَدَّمْتُ وَما أَخَّرْتُ

"Allahu im! Për pëlqimin tënd agjërova, me atë që më ke dhënë ti, e hapa agjërimin, te ti u mbështeta, ty të besova. Bëra nijet të agjëroj ditën e nesërme të Ramazanit. M'i fal mua gjynahet e shkuara e të ardhshme!"

"Allahu im! Për pëlqimin tënd agjërova, me atë që më ke dhënë ti prisha, te ti u mbështeta, ty të besova! Uria shkoi, damarët u ngrohën. Inshallah, edhe sevapi u pranua! Zoti im shumëbujar, m'i fal gjynahet! Lavdi Allahut që më ndihmoi dhe agjërova, që më furnizoi dhe agjërimin hapa!"

"Allahu im! për pëlqimin tënd agjërova, me atë që më dhe ti, prisha! Zoti im që fal shumë, Më fal mua, prindërit e mi dhe të gjithë besimtarët ditën e gjykimit!"

N. I'TIKAFI

Si fjalë, i'tikaf do të thotë të presësh diku në një vend, të bësh durim, të qëndrosh gjatë në një vend pa u larguar prej aty. Si term i së drejtës Islame (fikh), i'tikafi është qëndrimi për një farë kohe me qëllim adhurimi në një faltore (xhami) ose mjedis që përdoret si xhami. Sipas një përkufizimi tjetër, i'tikafi është qëndrimi në një xhami ose mjedis ku falet namaz me xhemaat duke bërë nijet i agjëruar për i'tikaf.

Si konkluzion dhe vendim juridiko-fetar, i'tikafi është tre llojesh: vaxhib, sunnet muekked dhe mustehab.

I'tikafi i kushtuar është vaxhib. I'tikafi i dhjetë ditëve të fundit të Ramazanit është sunnet muekked. Kurse i'tikafi i bërë në kohë të tjera me qëllim adhurimi është mustehab.

Synimi i i'tikafit të bërë për pëlqim të Allahut është që, duke u veçuar dhe çliruar për një periudhë kohe kalimtare nga bota e jashtme, të drejtohet nga Allahu dhe të kalohet koha me falje e adhurim.

a. Si bëhet i'tikaf?

I'tikafi i një mashkulli bëhet në një xhami ose faltore ku falet namaz me xhemaat.

I'tikafi vaxhib bëhet brenda asaj kohe dhe për aq kohë që është bërë nijet. I'tikafi sunnet bëhet në dhjetë ditët e fundit të Ramazanit. Kurse i'tikafi nafile bëhet në një kohë të përshtatshme. Gjatë i'tikafit vaxhib dhe sunnet duhet qenë i agjëruar.

Në i'tikafin nafile të bërë jashtë Ramazanit, të qenët i agjëruar nuk është kusht. Periudha më e shkurtër e i'tikafit nafile është pritja pak në faltore.

Gjatë i'tikafit duhet të vishen rroba të pastra dhe të bëhet lyerje me aroma të mira. Duhet të lexohen Kurani, libra të hadithit dhe libra të tjerë fetarë. Koha duhet kaluar me dhikër, namaz nafile ose namaze kaza.

b. Kushtet e i'tikafit

* Personi që hyn në i'tikaf duhet të jetë mysliman, me aftësi mendore normale dhe i pastër.

* Personi duhet të ketë bërë nijet për i'tikaf.

* I'tikafi duhet bërë në xhami ose në një vend që përdoret si xhami. Kurse vendi i i'tikafit për femrën është, në shtëpinë e vet, dhoma ku ajo fal namaz.

* Personi që po bën i'tikaf vaxhib, duhet të jetë i agjëruar.

* Gruaja që hyn në i'tikaf duhet të ketë marrë leje nga i shoqi.

c. Rastet kur prishet i'tikafi

* Dalja jashtë vendit të i'tikafit pa justifikim.

* Gjatë i'tikafit, kalimi i disa ditëve në gjendje të fikti ose si i sëmurë mendor.

* Kryerja e marrëdhënies seksuale.

d. Rastet që s'e prishin i'tikafin

* Dalja jashtë për të kryer nevojën e madhe e të vogël fiziologjike (për të urinuar dhe defekuar).

* Nëse në mjedisin ku hyhet në itifak, nuk falet namaz, dalja për të shkuar në një xhami ku falet e xhumaja me qëllim për ta falur xhumanë.

* Dalja nga vendi i i'tikafit për të shpëtuar familjen ose pasurinë nëse ata ndodhen para ndonjë rreziku. Nëse bëhet fjalë për shembjen e vendit ku bëhet i'tikaf, ai mund të vazhdohet në një vend tjetër.

* Të fiktit për një kohë të shkurtër, fjalët e këqija, grindja nuk e prishin i'tikafin por e pakësojnë sevapin që do të fitohet nga adhurimi.

PËRMBLEDHJE

1. Bëni përkufizimin e agjërimit.
2. Shpjegoni shkurt rëndësinë dhe vlerën e agjërimit.
3. Përcaktojeni se kur agjërimi është farz.
4. Thoni një ajet dhe një hadith profetik lidhur me agjërimin si farz.
5. Cilat janë kushtet që agjërimi të jetë farz?
6. Cilat janë llojet e agjërimit?
7. Cilat janë agjërimet vaxhib?
8. Cilat janë agjërimet nafile?
9. Thoni kushtet e kryerjes dhe vlershmërisë së agjërimit.
10. Përcaktojeni konkluzionin dhe vendimin e agjërimit.
11. Cilat janë gjërat që e prishin agjërimin?
12. Ç'është kefareti i agjërimit? Si zbatohet?
13. Në ç'raste duhet të japë kefaret personi që e prish agjërimin?
14. Përcaktoni rastet që e rrëzojnë kefaretin.
15. Thoni mustehabet e agjërimit.
16. Cilat janë mekruhet e agjërimit?
17. Thoni rastet që e bëjnë mubah mosmbajtjen e agjërimit.
18. Jepni të dhëna mbi fidjen e agjërimit.
19. Ç'është i'tikafi? Si bëhet?
20. Thoni lutjet që bëhen duke hapur agjërimin.

PJESA II
ZEKATI

ÇËSHTJET

1. Përkufizimi dhe rëndësia e zekatit
2. Dobitë e zekatit
3. Kushtet e detyrimit të zekatit
4. Kushtet e vlefshmërisë së zekatit
5. Mallrat e ngarkuara me zekat
6. Mallrat dhe shpenzimet e pangarkuara me zekat
7. Personat që u jepet zekat dhe radha prioritare

PUNË PËRGATITORE

1. Duke mbajtur parasysh se zekati është një prej pesë kushteve të Islamit, diskutoni rëndësinë fetare të këtij adhurimi.
2. Mësoni nga mësuesi se kur u bë zekati për herë të parë farz.
3. Thoni mendimet tuaja mbi dobitë ekonomike të zekatit.
4. Kërkoni të mësoni rëndësinë e zekatit për ndihmën dhe solidaritetin mes njerëzve.
5. Mendoni se cilat janë kushtet që duhet të plotësojë një person në mënyrë që zekati të bëhet farz për të.
6. Kërkoni të mësoni se kujt duhet t'u jepet zekat.

A. PËRKUFIZIMI DHE RËNDËSIA E ZEKATIT

a. Përkufizimi i zekatit

Fjala zekat do të thotë pastërti, përplotësi, pjesa më e pastër e çdo gjëje, begati dhe tepricë. Si term i fikhut, zekati është **"dhënia nga një mysliman i quajtur i pastër fetarisht, i një pjese të pasurisë personave të caktuar për pëlqim të Allahut"**.

Dhënia e zekatit quhet tezkije (pastrim malli), kurse dhënësi i zekatit quhet muzekki (pastrues i mallit nga e drejta e të tjerëve duke dhënë zekat).

b. Rëndësia e zekatit

Zekati, për detyrimin e të cilit flitet në afro dyzet ajete të Kuranit dhe që është një prej pesë parimeve themelore të Islamit, bart një rëndësi të madhe individuale e shoqërore.

Feja jonë ka treguar se janë një sërë të drejtash mes njerëzve që duhen respektuar në mënyrë që shoqëria të jetojë në qetësi dhe lumturi. Njëra nga këto të drejta është zekati, e drejta ose haku i të varfrit, sepse zekati është një adhurim i rëndësishëm që e vë në rregull jetën e shoqërisë dhe mundëson sigurinë shoqërore të të varfërve. Në të njëjtën kohë, zekati mundëson që të pasurit të kontribuojnë në të ardhurat e të varfërve.

Kur nuk jepet zekat, dallimi ekonomik mes të pasurve e të varfërve theksohet edhe më shumë. Meqë zekati është e drejta e natyrshme ose, siç thotë populli, haku i të varfrit, ky do të fillojë të ndjejë armiqësi ndaj pasurisë së të pasurit dhe vetë atij për shkak se nuk i është dhënë e drejta e vet. I varfri do t'ia vërë syrin mallit të të varfrit, gjë që i hap rrugë prishjes së paqes shoqërore. Për këtë arsye qe ndeshur Hz. Ebu Bekri (r.a.) si kalif me ata që nuk jepnin zekat.

Njeriu ka nevojë për para dhe pasuri ose, siç themi ndryshe, për mundësi materiale që të mund të vazhdojë të jetojë. Mundësitë materiale njeriu i shtie në dorë në saje të aftësisë për të punuar dhe zotësisë për të fituar që ia ka dhënë Zoti. Është gjithashtu Zoti që i ka krijuar dhe i krijon mundësitë materiale që i fiton njeriu duke punuar dhe që ia ofron shërbimit të njeriut. Detyra që i bie përsipër njeriut është që mundësitë materiale (para, mall dhe pasuri të ndryshme) të dhëna atij nga Zoti si kundërvlerë të punës dhe përpjekjeve të tij, t'i përdorë ashtu siç e urdhëron dhe porosit Zoti e t'i vlerësojë në formën dhe mënyrën më të mirë. Dhe

njëra nga këto forma dhe mënyra të mira vlerësimi është zekati. Meqë Zoti ka urdhëruar dhënien e zekatit, njeriu duhet ta çojë në vend, në të kundërt, do të marrë ndëshkimin përkatës në këtë jetë e në jetën tjetër. Kurse kur ta japë zekatin, do të marrë shpërblimin e duhur.

B. DOBITË E ZEKATIT

Ashtu si adhurimet e tjera që ka urdhëruar Islami, edhe zekati ka shumë dobi për njeriun dhe shoqërinë.

* Njeriu që jep zekat, ka treguar bindje dhe adhurim ndaj Allahut. Përgjegjësen e kësaj njeriu e merr edhe në këtë botë, edhe në jetën e pasme (ahiret).

* Zekati bëhet shkak që njeriu të afrohet me Zotin edhe në këtë botë, edhe në botën tjetër, që të fitojë mëshirën dhe dashurinë e Tij.

* Zekati e mbron njeriun nga koprracia, ia zhvillon ndjenjat e bujarisë dhe ndihmës për të tjerët.

* Zekati siguron formimin e lidhjes dhe dashurisë mes të pasurit dhe të varfrit. I pasuri që jep zekat, bëhet i mëshirshëm ndaj të varfrit. Edhe i varfri nuk ushqen urrejtje dhe armiqësi ndaj të pasurit, nuk ia vë syrin mallit dhe pasurisë së tij.

* Duke dhënë zekat me mendimin se në mallin dhe pasurinë e tij është edhe e drejta e të varfërve, i pasuri ka paguar të drejtën (hakun) e të varfrit dhe e ka pastruar pasurinë, sepse, kur s'e jep zekatin, pra, s'e paguan të drejtën e të varfrit, në pasurinë e tij është përzier gjëja e huaj, harami.

* Dhënia e zekatit është shenjë e besimit te Allahu, sepse zekatin e jep njeriu që e beson Allahun. Njeriu që e beson Allahun, është njeriu që i çon në vend urdhrat e Tij dhe që është jo i dëmshëm, por i dobishëm për shoqërinë mes së cilës jeton, sepse nuk i vjen e keqe mjedisit dhe shoqërisë nga njeriu besimtar që ia jep një pjesë të pasurisë të varfërve për pëlqim të Allahut, pa pritur shpërblim për këtë.

* Zekati nuk e pakëson mallin, por e shton. Allahu i Lartë u tregon bujari me të tepërt njerëzve që e zbatojnë këtë urdhër të Tij.

* Zekati siguron ndihmën dhe solidaritetin, forcimin e marrëdhënieve të mira midis njerëzve.

* Zekati parandalon që malli dhe pasuria, kapitali, të grumbullohen në një dorë, parandalon formimin e pasurisë dhe varfrisë skajore.

* Zekati u bëhet pengesë njerëzve me qëllim të keq për të krijuar armiqësi mes të pasurve e të varfërve, duke kontribuar, kështu, për mbrojtjen e paqes shoqërore.

* Zekati e ndihmon edhe të varfrin që të punojë. I varfri, i cili nuk ka mundësi materiale, sapo këto t'i bien në dorë, përpiqet të hapë një punë.

* Zekati është falënderim për të mirat që na jep Allahu.

* Zekati është edhe falënderim i individit të pasur ndaj shoqërisë, sepse në saje të njerëzve dhe shoqërisë e ka fituar atë pasuri.

Konkluzioni mbi zekatin

Zekati është një adhurim pasuror i detyruar (farz) për njerëzit që janë të ngarkuar me përgjegjësinë për ta dhënë. I pasuri është i detyruar të japë zekat nga malli i vet. Duke i dhënë zekat të varfrit, i pasuri nuk dhuron, nuk bën gjest bujarie, sepse zekati është një e drejtë e të varfrit e përcaktuar nga Allahu. Prandaj, ai që jep zekat, nuk jep duke pritur mirënjohje; as ai që merr, nuk merr duke shprehur mirënjohje. I varfri që merr zekat nuk duhet të qëndrojë para të pasurit i turpëruar e me qafë përkulur.

Zekati, i cili është njëri prej pesë parimeve themelore të Islamit, është bërë farz (detyrim) në muajin shevval të vitit të dytë të hixhretit, emgrimit të Profetit nga Meka në Medine. Allahu i Lartë ka urdhëruar për zekat në disa ajete të Kuranit. Për shembull, ajetet në vijim tregojnë se dhënia e zekatit për myslimanët që plotësojnë kushtet përkatëse, është farz (detyrim).

وَأَقِيمُوا الصَّلَوةَ وَءَاتُواالزَّكَوةَ

"Falni namaz e jepni zekat..."[1]

وَأَوْحَيْنَآ إِلَيْهِمْ فِعْلَ الخَيْرَاتِ وَإِقَامَ الصَّلَوةِ وَإِيتَآءَالزَّكَوةِ

"... Dhe u zbuluam atyre të bëjnë punë të mira, të falin namaz, të japin zekat..."[2]

"Si një farz i Allahut, zekatet u takojnë vetëm të varfërve, nevojtarëve, nëpunësve (që mbledhin zekat)**, atyre që kërkohet t'u ngrohen zemrat me Islamin, skllevërve** (që përpiqen të fitojnë lirinë)**, atyre që kanë borxhe, atyre që luftojnë në rrugë të Allahut dhe udhëtarëve. Allahu është i ditur dhe i urtë!"**[3]

1 Kurani, El-Bekare: 110; En-Nisa: 77; En-Nur: 65.

2 Kurani, El-Enbija: 73.

3 Kurani, Et-Teube: 60.

Detyrimi i zekatit është i mbështetur edhe me hadithe profetike.

Sipas rivajetit (rrëfimit) të Ebu Xhemres (r.a.), Profeti (a.s.) ka pyetur: *"A e dini se ç'do të thotë t'i besosh Allahut që është një?"* Të pranishmit janë përgjigjur: «Allahu dhe i Dërguari i Tij e dinë më mirë!» Atëherë Profeti (a.s.) ka thënë: *"Ta besoni Allahun do të thotë të dëshmoni se nuk ka zot tjetër veç Allahut dhe se Muhammedi është i dërguari i Tij, të falni namaz, të jepni zekat, të agjëroni në muajin i Ramazanit dhe t'ia jepni një të pestën e plaçkës së luftës (ganimet) thesarit të shtetit."*[4]

Sipas rivajetit të Abdullah b. Abbasit (r.a.), sahabeve të dërguar si mësues në fiset fqinje, Profeti ua ka tërhequr vëmendjen në këto çështje:

"Në fillim shpjegojuni atyre se nuk ka zot tjetër veç Allahut; po ta pranojnë, u thoni se unë jam robi dhe i dërguari i Allahut. Po e pranuan edhe këtë, u shpjegoni se falja e pesë kohëve namaz në ditë është farz dhe se në mallin e të pasurve ndodhet e drejta e të varfërve!"[5]

Të gjithë dijetarët Islamë janë të një mendimi se zekati është farz (detyrim).

4 Sahihu'l-Buhari, Kitabu'l-Iman, vëll. I, f. 19.

5 Sahihu'l-Buhari, Kitabu'l-Zekât.

Zekati është quajtur edhe **"sadaka"**. Kështu, në ajetin që tregon se kujt duhet t'i jepet zekat, është përdorur emërtimi "sadaka". Megjithëkëtë, sadakaja është më e gjerë se zekati, sepse sadakaja përmbledh jo vetëm zekatin që është farz, por edhe format e tjera të dhënies që janë vaxhib dhe nafile.

C. KUSHTET E DETYRIMIT TË ZEKATIT

Detyrimi (farz) i zekatit për një person varet nga disa kushte. Disa nga këto kushte kanë të bëjnë me personin që do të japë zekat, kurse disa, me mallin që do të jepet si zekat.

a. Kushtet që duhet të plotësojë personi përgjegjës (personi që duhet të japë zekat)

Zekati është farz (detyrim) për personin që plotëson kushtet si më poshtë:

1. Të jetë mysliman. Dhënia e zekatit është farz për myslimanët. Zekati nuk është farz për jomyslimanin sado i pasur që të jetë. Kjo nuk ndryshon edhe nëse personi i pasur jomysliman jeton në një vend mysliman.

2. Të ketë zhvillim mendor normal. Islami e ngarkon personin me përgjegjësinë e kryerjes së adhurimeve me kusht që të ketë zhvillim mendor normal. Ky kusht vlen edhe për dhënien e zekatit. Për rrjedhojë, personat që s'kanë zhvillim mendor normal, nuk janë të ngarkuar me përgjegjësinë e dhënies së zekatit. Por nëse shërohen dhe kanë arritur moshën e pjekurisë seksuale si dhe, ndërkohë, plotësojnë edhe kushtet e tjera, bëhen të detyruar për të dhënë zekat.

Ky konkluzion është i vlefshëm edhe për personat që ndodhen në gjendje kome si dhe me konfuzion psikik për gjithë kohën kur vazhdon kjo gjendje. Pas shërimit duhet të japin zekat. Kurse asfiksia nuk është pengesë për dhënien e zekatit.

3. Të ketë arritur moshën e pubertetit (moshën e pjekurisë seksuale). Fëmijët, edhe sikur të jenë të rritur e të formuar sa për ta dalluar të mirën nga e keqja dhe të dobishmen nga e dëmshmja, nuk janë të detyruar të japin zekat. Ndërkaq, imam Shafiiu ka thënë se kujdestari i fëmijës së pasur duhet të japë zekat nga malli i fëmijës së pasur dhe në emër të tij.

4. Të jetë i lirë. Personi i detyruar për të dhënë zekat, nuk duhet të jetë skllav ose skllave. Kurse personat, që u është hequr liria me vendim gjykate dhe ndodhen në burg, duhet të japin zekat nëse plotësojnë kushtet e tjera.

5. Të zotërojë pasurinë minimale të quajtur "nisab". Personi që ka për të dhënë zekat, duhet të zotërojë pasuri në masën minimale të quajtur "nisab", të llogaritur pas zbritjes së nevojave themelore jetësore si dhe borxheve. Personi që nuk zotëron pasuri në masën minimale "nisab" siç u përshkrua më lart, nuk është i detyruar (nuk e ka farz) të japë zekat.

Në nevojat themelore jetësore hyjnë shtëpia e banimit, pajisjet e shtëpisë së banimit, librat që shfrytëzohen për punë, kafsha e shalës ose autovetura, ushqimet për një vit, mjetet dhe veglat e punës (profesionit), monedhë në sasinë e borxhit ekzistues.

Kurse nisabi është pasuria minimale e caktuar nga feja për mallrat. Sasia e nisabit për mallrat që plotësojnë kushtet për të dhënë zekat:

* Për arin, 20 mithkal ose 80.14 gr.

* Për argjendin, 200 derhem ose 561 gr.

* Për të imtat, 40 krerë.

* Për të trashat, 30 krerë.

* Për devetë, 5 krerë.

* Për paratë në monedhë dhe mallrat e tregtisë, sasia në vlerën 8.14 gram ar.

* Për produktet bujqësore, 611 kg. Sipas imam Adhamit, në produktet bujqësore nuk kërkohet nisab.

Veç kushteve që duhet të plotësojë personi që duhet të japë zekat, edhe mallrat për të cilat duhet të jepet zekat duhet të plotësojnë disa kushte.

b. Kushtet që duhet të plotësojë malli për të cilin do të jepet zekat

1. Malli duhet të jetë produktiv. Malli për të cilin do të jepet zekat, duhet të jetë produktiv, domethënë riprodhues, i shtueshëm. Malli i shtueshëm quhet nami, kurse pjesa e shtuar ose e riprodhuar quhet nema. Riprodhimi dhe shtimi në mall bëhet në dy forma:

E para, riprodhimi natyror dhe i vërtetë te kafshët e tregtisë si dhentë, dhitë, lopët, qetë, etj. Riprodhimi natyror te kafshët bëhet me anë të pjelljes. I kësaj forme është edhe shtimi numeriko-sasior i mallrave të tregtisë, shtimi i të cilave është real.

E dyta, shtimi ose riprodhimi konvencional i sendeve me vlerë si monedhat, ari, argjendi, etj. Këtu futet edhe monedha e huaj. Shtimi i këtyre quhet konvencional sepse nuk është numeriko-sasior, por në vlerë. Edhe nëse te ari, argjendi dhe monedha nuk ndodh ndonjë rritje sasie, për to jepet zekat për sa kohë që plotësojnë

vlerën e caktuar të nisabit, sepse këto quhen mall produktiv konvencional pasi përbëjnë një shkak thelbësor për tregti. Për to jepet zekat edhe nëse s'përdoren efektivisht në tregti.

Edhe pasuritë e tundshme e të patundshme që s'përdoren për qëllime tregtie por që sjellin të ardhura, quhen mallra produktive. Zekat nuk jepet për këto vetë, por për sasinë e të ardhurave që sjellin. Për shembull, jepet zekat për të ardhurat e taksive dhe makinave të transportit, për qiranë e shtëpisë ose vendit të punës, për prodhimet e tokës bujqësore. Ndërkaq, nëse të ardhurat e secilit prej këtyre nuk arrin masën e quajtur nisab, bashkohen me të ardhurat e tjera të të njëjtit lloj dhe për to jepet zekat kur të arrijnë masën nisab.

2. Malli për të cilin do të jepet zekat nga një person, duhet të jetë nën pronësi të plotë të atij personi, i cili duhet të ketë të drejtë ta përdorë atë mall si të dojë. Nuk kërkohet zekat për mallrat e humbura, për mallrat që nuk ndodhen nën pronësi, që ndodhen nën hipotekë, që janë marrë nga personi si amanet në ruajtje ose si peng. Po kështu, edhe për të ardhurat e papaguara personit ose të mohuara nuk kërkohet të jepet zekat.

Malli i blerë, i paguar, ngarkohet me zekat edhe nëse nuk është marrë ende në dorëzim.

Mallrat e dhuruara me qëllim mirëbërësie nuk ngarkohen me zekat. Po kështu, nuk ngarkohen me zekat mallrat e shtëna në dorë me rrugë të ndaluara (haram), sepse Islami nuk e njeh pronësinë mbi mallrat e fituara ose të përvetësuara me rrugë të palejuara e të pabekuara të cilësuara me një fjalë si haram.

3. Malli duhet të ketë një stazh prej një viti. Nuk ngarkohet me zekat malli i aftë për t'u shtuar që ka arritur sasinë e nisabit pa kaluar një vit hënor. Malli me stazh vjetor të plotësuar duhet të ketë në fillim dhe në mbarim të periudhës njëvjetore (hënore) sasinë nisab. Pakësimi kalimtar gjatë periudhës së stazhit nuk merret parasysh dhe nuk bëhet pengesë për dhënien e zekatit. Zekati për mallin me stazhin të plotësuar jepet sipas sasisë së fundit të vitit. Për shembull, nëse një person ka në fillim të vitit 40 dele të cilat i shtohen dhe në fund të vitit ai bëhet me 121 krerë, personi do të japë zekat për 121 krerë (2 dele).

Kur malli në sasinë e nisabit plotëson një vit stazh pasi kalon nën pronësinë e një personi të caktuar, për të jepet zekat. Për shembull, malli që ka kaluar nën pronësinë e një personi në datën një të Ramazanit, e mbush vitin në datën një të Ramazanit të vitit të ardhshëm.

Edhe malli që ndodhet nën një pronësi të caktuar, ngarkohet me zekat një vit hënor nga data kur ka arritur për herë të parë sasinë e nisabit. Për shembull, nën

pronësinë e dikujt, në datën një të Ramazanit ndodhet sasia prej 70 gr. ar, e cila është nën sasinë e quajtur nisab. Në datën dhjetë të Ramazanit, kësaj i shtohen edhe 15 gr. ar dhe bëhen 85 gr. që do të thotë se nisabi është plotësuar dhe tejkaluar. Kjo sasi ari ngarkohet me zekat një vit më vonë, më datën dhjetë të Ramazanit.

Për minierat, prodhimet bujqësore dhe pemët frutore nuk kërkohet si kusht stazhi prej një vit hënor. Për mineralet jepet zekat pasi të nxirren, kurse për prodhimet bujqësore dhe frutat, pasi të shihen, vilen dhe mblidhen.

D. KUSHTET E VLEFSHMËRISË SË ZEKATIT

Për vlefshmërinë e zekatit duhen ndjekur këto tri çështje të veçanta:

a. Kushtet që duhet të plotësojë personi që do të japë zekat

1. Kur të jepet zekat, duhet bërë qëllim (nijet). Është kusht që personi i ngarkuar me zekat, të bëjë qëllim me zemër si kur veçon mall për zekat, ashtu dhe kur jep zekat. Nuk kërkohet që zekati të shprehet me gojë. Edhe kur personi i ngarkuar me zekat e jep zekatin me ndërmjetësinë e një përfaqësuesi, duhet të bëjë qëllim vetë. Vetëm qëllimi i përfaqësuesit s'mjafton.

Nëse një person ka dhënë zekat pa bërë qëllim, mund ta bëjë këtë gjersa malli nuk ka dalë nga dora e marrësit. Por nëse marrësi e ka shpenzuar zekatin e marrë, qëllimi është i pamjaftueshëm.

2. Personi që do të japë zekat, duhet të zotërojë sasinë e mallit të quajtur nisab. Malli i dhënë pa e zotëruar sasinë nisab, quhet sadaka. Personi që ka mall në sasinë nisab, mund të japë zekat pa i ardhur koha, domethënë pa u mbushur një vit hënor.

b. Kushtet që duhet të plotësojë personi që do të marrë zekat

1. Malli që jepet, nuk duhet të jetë me cilësi të ulët. Malli që jepet si zekat duhet të jetë i përdorshëm dhe i dobishëm. Nëse malli që do të jepet si zekat, nuk i vlen të varfrit, atëherë jepet kundërvlera e tij.

2. Zekati duhet t'u jepet personave që kanë të drejtë të marrin zekat. Personat që duhet t'u jepet zekat janë përshkruar hapur në Kuran ashtu siç do të shihet më tej edhe në pjesën me titull "Personat që do t'u jepet zekat dhe radha e përparësisë".

Meqë zekati është e drejtë vetëm e personave realë, nuk jepet për xhamitë, çezmat, urat, shkollat, etj.

Në mënyrë të veçantë, personi nuk mund t'u japë zekat njerëzve të afërt si prindët, gjyshi e gjyshja, fëmijët, nipërit e mbesat, edhe sikur këta të jenë të varfër, sepse këta janë personat për të cilët ai duhet të kujdeset për t'i ushqyer dhe veshur.

As bashkëshortët nuk mund t'i japin zekat njëri-tjetrit.

Megjithëse afërsia nuk është kusht i mënyrës së dhënies së zekatit, është më mirë që të fillohet, duke përjashtuar personat e afërt si më sipër, nga farefisi më i afërt dhe duke vazhduar me njerëzit e lagjes, fshatit, zonës, rrethit e më larg.

E. MALLRAT E NGARKUARA ME ZEKAT

Llojet e mallrave për të cilat duhet të jepet zekat, ndahen në **mallra të dukshme e mallra të fshehura.**

Mallrat e dukshme, janë mallrat që qëndrojnë gjithmonë sheshit, që mund të vihen në dukje e të numërohen ose maten, si prodhimet bujqësore, kafshët, mineralet dhe mallrat e tregtisë.

Mallrat e fshehura, janë mallrat që qëndrojnë përgjithësisht të depozituara ose të fshehura në një vend të caktuar, si ari, argjendi, monedhat, stolitë dhe perlat. Meqë përcaktimi i sasisë së plotë e të saktë të tyre është i vështirë, merret për bazë deklarata e zotëruesve të tyre.

Dhe tani le të shohim një nga një sasinë e zekatit të mallrave të dukshme e të fshehura.

a. Zekati i të imtave (dele, dhi)

Kafshët që e kalojnë më shumë se gjysmën e vitit duke u vetëushqyer në kullotë të lirë, quhet **kafshë të kullotës së lirë** (saime). Nisabi për zekat i të imtave është 40 krerë. Nëse numri i tyre është më i vogël se dyzet, nuk ngarkohen me zekat. Por nëse tufa e përzier dhen-dhi e plotëson numrin minimal 40, ngarkohet me zekat. Për shembull, tufa e përbërë prej më e pakta 27 dhen dhe më e pakta 13 dhi, ngarkohet me zekat sepse e ka plotësuar numrin minimal 40.

Është sunnet që për tufat e përziera të jepet zekat nga lloji në numër më të madh.

Sasia e zekatit për të imtat është kështu:

Për tufën nga 40 gjer në 120 krerë (përfshi numrin 120), 1 dele ose dhi; nga 121 gjer në 200 krerë (përfshi 200), 2 dele ose dhi; nga 201 gjer në 399 krerë (përfshi 399), 3 dele ose dhi; nga 400 krerë e më tej, për çdo 100 krerë, 1 dele ose dhi.

Është kusht që kafsha e imtë e dhënë si zekat të ketë mbushur vitin. Ndërkaq, nuk është kusht, që kafsha të jetë femër ose mashkull. Zekat mund të jepen dele, dash, dhi, cjap.

b. Zekati i të trashave (lopë, buallicë)

Sasia e zekatit të të trashave të ushqyera në kullotë të lirë është kështu:

Për tufën nga 30 gjer në 39 krerë (përfshi 39), 1 viç njëvjeçar; nga 40 gjer në 59 krerë (përfshi 59), 1 viç dyvjeçar; nga 60 gjer në 69 krerë (përfshi 69), 2 viça njëvjeçarë. Pas kësaj, për çdo 30 krerë jepet 1 viç njëvjeçar dhe për çdo 40 krerë, jepet 1 viç dyvjeçar. Nuk ka ndryshim nëse viçi që jepet për zekat është mashkull ose femër.

Në dhënien e zekatit, numri i lopëve (qeve) mblidhet me numrin e buallicave (buajve).

c. Zekati i deveve

Sasia e zekatit të deveve të ushqyera në kullotë të lirë është kështu:

Për tufën nga 5 gjer në 9 deve (përfshi 9), 1 dele ose dhi; nga 10 gjer në 14 deve (përfshi 14), 2 dele ose dhi; nga 15 gjer në 19 deve (përfshi 19), 3 dele ose dhi; nga 20 gjer në 24 deve (përfshi 24), 4 dele ose dhi; nga 25 gjer në 35 deve (përfshi 35), 1 deve femër e hyrë në të dytat; nga 36 gjer në 45 deve (përfshi 45), 1 deve femër e hyrë në të tretat; nga 46 gjer në 60 deve (përfshi 60), 1 deve femër e hyrë në të katërtat.

Për më tej, gjithashtu jepen si zekat numër i ndryshëm devesh në mosha të ndryshme sipas numrit të tufës.

d. Zekati i kuajve

Nga disa dijetarë është pranuar se duhet të jepet zekat edhe për kuajt që e kalojnë shumicën e vitit në kullotë të lirë, vetëm se për kuajt nuk është përcaktuar nisab. Megjithëkëtë, llogaritet vlera e tufës së përzier prej 5 ose më shumë se 5 kuaj e pela dhe jepet si zekat një e dyzeta (2.5%) e vlerës së llogaritur.

Ekzistojnë disa parime të përbashkëta mbi zekatin e kafshëve, masën e të cilit e shtjelluam më sipër. Këto parime mund t'i radhisim kështu:

Është kusht, që kafshët për të cilat do të jepet zekat, ta kalojnë shumicën e vitit në kullotë të lirë.

Kafshët e ushqyera e të rritura për therje për Kurban, për shitje te kasapi ose për tregti pranohen si mall tregtie dhe për to jepet zekat një e dyzeta (25%) e vlerës së tyre të përgjithshme (e vlerës së përgjithshme të tufës).

Kafshët që përdoren për shalë dhe transport nuk ngarkohen me zekat.

Është kusht që pronësia e personit që do të japë zekat mbi tufën, të jetë e plotë.

Të vegjlit e kafshëve shkojnë bashkë me nënat dhe për ta nuk kërkohet stazhi prej një vit hënor. Për shembull, nëse 65 delet që kanë mbushur stazhin një vit dhe për to është dhënë zekat, pjellin nga një qengj, numri i përgjithshëm i tufës bëhet 130 dhe qengjat ngarkohen me zekat së bashku me nënat edhe sikur të mos e kenë mbushur motmotin.

Nëse tufës, e cila në krye të vitit është sa sasia e nisabit, i shtohen, gjatë vitit, disa krerë të tjerë, në fund të vitit hënor jepet zekat për numrin e përgjithshëm të tufës pa vënë si kusht stazhin njëvjeçar për krerët e shtuar më pas.

e. Zekati i arit dhe i argjendit

Për arin dhe argjendin që e kanë plotësuar sasinë nisab dhe stazhin njëvjeçar, jepet zekat pavarësisht nga gjendja e tyre (monedhë ose masë e punuar) dhe qëllimi i përdorimit.

Sasia nisab e arit është 20 mithkal, e barabartë me **80,14 gram.**

Zekati i arit në sasinë nisab dhe me stazh njëvjeçar është **një e dyzeta** e shumës ose **2,5%**. Kjo sasi mund të jepet si në ar, ashtu dhe në kundërvlerën e saj.

Zekati i argjendit në sasinë nisab 200 derhem ose 561 gram dhe me stazh njëvjeçar është një e dyzeta e saj ose 2.5%.

Te ari dhe argjendi merret për bazë jo vlera, por pesha.

Zekat duhet të jepet edhe për sendet e stolisë dhe zbukurimit, tablotë, etj. të bëra prej ari e argjendi, kur arrijnë sasinë e quajtur nisab. Sasitë e arit dhe argjendit të sendeve të ndryshme mblidhen dhe, kur arrijnë sasinë nisab, për to jepet zekat. Ky zekat jepet në ar nëse sasia e arit është më e madhe, në argjend nëse sasia e argjendit është më e madhe dhe në ar nëse sasitë e arit e të argjendit janë të barabarta.

Nëse vlera e sendeve të metalta veç arit e argjendit, të cilat nuk përdoren si sende për qëllime shtëpiake, arrin sasinë nisab të arit, edhe për to jepet zekat.

f. Zekati i pasurisë në monedhë

Kur vlera e monedhës që ka në dorë personi arrin vlerën minimale prej 80.14 gr. ar, për të jepet zekat sa një e dyzeta ose 2.5% e saj.

Nëse monedha e huaj përdoren në një vend si njësi pagese, ajo ngarkohet me zekat si monedha e vendit. Nëse blihet e shitet, futet në mallrat e tregtisë dhe, për zekat, trajtohet si to.

Nëse ari, argjendi, monedha e vendit, monedha e huaj dhe mallrat e tregtisë që ndodhen nën pronësi të një personi, nuk arrijnë secila më vete sasinë minimale të quajtur nisab, mblidhet vlera e të gjithave dhe, nëse arrin vlerën e nisabit, për të jepet zekat.

g. Zekati i të ardhurave, rrogave dhe mëditjeve

Të ardhurat ndahen në tre lloje:

1. Të ardhura të fuqishme. Këto janë paratë e dhëna borxh, kreditë e dhëna me çek, bono, etj. dhe të ardhurat nga shitja e mallrave të tregtisë. Këtu futen edhe qiratë e mjediseve për tregti.

Kur këto të ardhura të kenë plotësuar stazhin njëvjeçar, pasi të jetë dhënë një e pesta (20%) e nisabit të monedhës, për tërë të ardhurat jepet zekati i një viti më parë

në masën një e dyzeta (2.5%). Nëse për monedhën është dhënë më pak se një e pesta dhe ekziston edhe mall tjetër për të cilin duhet dhënë zekat, i shtohet këtij dhe jepet zekat për të gjithë të ardhurat.

2. Të ardhura të mesme. Janë të ardhura jo nga tregtia, janë të ardhura si shpërblim për një punë ose shërbim. Të tilla janë rrogat, mëditjet, dëmshpërblimet, qiratë e banimit. Këto nuk ngarkohen me zekat gjersa të mos i jenë paguar personit në dorë. Nëse vlera e të ardhurave të paguara personit arrin vlerën minimale të 80.14 gram ar ose të 96 gram ar sipas hanefive dhe plotëson stazhin prej një vit hënor, jepet si zekat një e dyzeta ose 2.5% e saj. Të ardhurat që nuk plotësojnë këto kushte, nuk ngarkohen me zekat. Por nëse krahas këtyre të ardhurave që nuk e plotësojnë sasinë e nisabit, zotëruesi i tyre ka edhe mallra të tjera për të cilat duhet të japë zekat, si ar, argjend, monedhë, mallra tregtie, bashkohen me këto dhe vlerësohen së bashku.

3. Të ardhura të dobëta. Janë të ardhura nga trashëgimia, të ardhura të lëna si porosi, të ardhura si dëmshpërblim plagosjeje si dhe të ardhura si garanci kurore (mehr) që merr gruaja nga burri. Këto të ardhura ngarkohen me zekat pasi të kenë kaluar nën pronësi të personit, të kenë arritur sasinë e quajtur nisab dhe të kenë plotësuar stazhin njëvjeçar.

h. Zekati i mallrave të tregtisë

Çdo lloj malli tregtie që plotëson shumën minimale të quajtur nisab (në vlerën 20 mithkal ar) si dhe stazhin prej një viti hënor, ngarkohet me zekat. Për mallrat e tregtisë merret për bazë sasia në fund të vitit dhe si zekat jepet një e dyzeta (2.5%) e saj. Për shembull, nëse malli në vlerën 20 mithkal ar në fillim të vitit arrin në vlerën 40 mithkal një vit më vonë, zekati jepet sipas gjendjes së dytë. Duke u llogaritur vlera e mallrave në fund të vitit, merret parasysh gjendja e tregut të vendit ku ndodhen mallrat.

Nëse me prodhimet bujqësore për të cilat është paguar e dhjeta, përdoren për tregti, për to nuk jepet një zekat i dytë brenda të njëjtit vit.

Një mall quhet mall tregtie nëse blihet me qëllim tregtie ose shitet me qëllim tregtie. Ndërkaq, nëse një person blen një autoveturë për qëllim tregtie, por, pastaj, e përdor për shërbim personal për lëvizje, nuk është i detyruar të japë zekat. Në të njëjtën mënyrë, nëse një mall është blerë në fillim jo si mall tregtie, por më pas vendoset të shitet dhe hiqet mënjanë (depozitohet) me qëllim për ta shitur në të ardhmen, nuk quhet mall tregtie.

Zekati i kafshëve të buta të ushqyera në kullota me qëllim tregtie, trajtohet si zekati i mallrave të tregtisë. Për këto jepet zekat një e dyzeta (2.5%) e vlerës dhe jo e numrit të krerëve. Për shembull, nëse vlera e një tufe të trashash të ruajtura për tregti, arrin në 20 mithkal ar (sipas një pikëpamjeje, në 200 derhem argjend), për to jepet zekat. Nëse numri i këtyre të trashave të ruajtura për tregti është 30, zekati i tyre nuk është 1 viç, por një e dyzeta e vlerës së tyre.

Nëse sasia e mallrave të tregtisë nuk e arrin vlerën e nisabit dhe zotëruesi i tyre ka edhe sasi ari, argjendi, monedhe, etj., mblidhen dhe vlerësohen të gjitha së bashku.

i. Zekati i prodhimeve të tokës

Zekati që merret nga prodhimet e tokës quhet **e dhjetë.** E dhjeta merret për të gjitha llojet e prodhimeve që dalin nga toka dhe kanë vlerë.

Sasia nisab për prodhimet e tokës është 611 kg. Ndërkaq, sipas imam Adhamit, për prodhimet e tokës plotësimi i sasisë nisab s'është kusht. Për prodhimet e tokës jepet zekat edhe nëse nuk e arrijnë këtë sasi.

Nga prodhimet e tokës së ujitur me ujra natyrore si shiu, lumi, përroi, etj., pa bërë ndonjë shpenzim për këtë, jepet si e dhjetë një e dhjeta (10%) e prodhimit. Kurse nga prodhimi i tokës së ujitur në mënyrë artificiale dhe duke bërë shpenzime për këtë, jepet si e dhjetë një e njëzeta (5%) e prodhimit. Shpenzimet e bëra nuk zbriten nga prodhimi i marrë. Nga prodhimet e tokës, për të cilat nuk kërkohet stazhi prej një viti hënor, merret e dhjeta pasi të jenë vjelur dhe mbledhur. Gjithashtu, merret e dhjetë veç e veç për secilin prodhim të marrë brenda një viti nga e njëjta arë.

E dhjeta e prodhimeve të kultivuara për qëllim tregtie llogaritet mbi kundërvlerën e tyre dhe jepet si zekat në masën 2.5%.

Në çështjen e zekatit të prodhimeve të tokës nuk merret parasysh gjendja e pronarit, por e tokës. E dhjeta e një are prodhimi merret edhe nëse pronari i saj nuk e ka arritur moshën e pubertetit ose nuk ka zhvillim mendor normal. Këtij rregulli i nënshtrohen edhe tokat vakëfe.

Edhe zekati i mjaltit është si zekati i prodhimeve të tokës. Nëse vlera e mjaltit të mbledhur arrin në vlerën e 611 kg. prodhimi të tokës, nga mjalti merret zekat në masën 10% të prodhimit. Nëse për prodhimin e mjaltit bëhen shpenzime, zekati i tij merret në masën 5%.

Nuk merret e dhjetë për prodhimet e mbledhura nga livadhet dhe kullotat që nuk u përkasin personave fizikë, nga pemët e rritura e të zhvilluara vetvetiu në to, nga peshqit e zënë në përronj. Por merret e dhjetë për drurët e prerë e të shitur për çdo vit, për barin dhe frutat e mbledhura nga parcelat që janë nën pronësi të personave fizikë.

k. Zekati i minierave dhe thesareve

Gjërat me vlerë që ndodhen nën tokë, quhen "pasuri nëntokësore" (rikadh). Forma e tyre natyrore quhet **mineral,** kurse forma e groposur nga njerëzit quhet **thesar.**

Mineralet dhe thesaret janë tre llojesh:

1. Të tretshme në zjarr, si: ari, argjendi, bakri, kallaji, nikeli, hekuri, zhiva, etj. Nëse këto nxirren nga parcela që nuk është nën pronësi të një personi fizik, për to merret si zekat një e pesta (20%) e sasisë, kurse pjesa e mbetur i mbetet atij që i ka nxjerrë. Nëse këto nxirren nga parcela që i përket një personi fizik, sipas imam Adhamit, nuk merret një e pesta, por zekat normal si për mallrat e tregtisë.

2. Të patretshme në zjarr, si gëlqerja, allçia, jakuti (smeraldi), elmazi (diamanti), perla, etj. Për këto nuk merret zekat. Por, po të përdoren për tregti, trajtohen si mallrat e tregtisë. Nëse parcela nga nxirren këto, është pronë e një personi fizik, i përkasin atij, ndryshe, i përkasin atij që i gjen dhe i nxjerr.

3. Të rrjedhshme, si bitumi, nafta, etj. Këto nuk ngarkohen me zekat nëse nuk përdoren për tregti.

Për mineralet dhe thesaret që ngarkohen me zekat, nuk kërkohet nisab dhe stazh.

F. MALLRAT DHE SHPENZIMET E PANGARKUARA ME ZEKAT

Mallrat dhe shpenzimet e pangarkuara me zekat janë këto:

a. Mallrat e nevojave bazë. Janë gjërat që shërbejnë për të plotësuar nevojat bazë të një personi vetë dhe personave që ai ka në ngarkim, si: shtëpia e banimit, pajisjet dhe gjërat e tjera të shtëpisë, kafshët e shalës ose mjetet e transportit, ushqimet dhe pijet, armët. Ndër këto futen, veçanërisht, librat e punës dhe mjetet e profesionit.

b. Mallrat që, megjithëse janë të personit, nuk i ka në dorë ai vetë, nuk përfiton dot prej tyre dhe që duket e pamundur t'i bien në dorë përsëri.

c. Për personin që ka borxh ose që është bërë dorëzanës për një borxh, sasia e mallit të tij, duke përjashtuar gjërat e nevojave bazë, e barabartë me vlerën e borxhit (nevojat bazë nuk merren si kundërvlerë e borxhit).

d. Mallrat jo për qëllim tregtie, si shtëpitë, parcelat e tokës, dyqanet, makineritë, veglat, makinat nuk ngarkohen vetë me zekat, por të ardhurat që sjellin ato.

e. Kafshët, si gomari, mushka, qeni i gjahut nuk ngarkohen me zekat. Por, kur përdoren për tregti, domethënë kur shiten e blihen, për këto jepet zekat.

f. Nuk ngarkohen me zekat kafshët e ngarkesës dhe vrapimit, kafshët që ushqehen për therje e ngrënie ose për damazllëk (shtim e përmirësim race), si dhe kafshët që ushqehen nga i zoti të paktën gjashtë muaj në ahur. Po kështu edhe kafshët që ushqehen për mish, qumësht, lesh dhe lëkurë. Por nëse me këto kafshë dhe prodhimet e tyre bëhet tregti, ngarkohen me zekat si mallra tregtie.

g. Nuk ngarkohen me zekat mallrat e përvetësuara me rrugë të ndaluara (haram). Është kusht që një mall i tillë t'i kthehet prapë të zotit.

h. Malli i dëmtuar para se dhënia e zekatit për të të bëhet farz (për shembull, para se të mbushet viti), nuk ngarkohet me zekat. Nga malli i personit që ka vdekur pa e paguar detyrimin e zekatit, nuk mund të paguhet ky detyrim pa lejen e trashëgimtarëve. Tashmë malli i tij u përket trashëgimtarëve. Por, nëse i vdekuri ka lënë porosi lidhur me këtë çështje, pagesa bëhet nga 1/3 e mallit që ka lënë. Sasia që do të paguhet nuk mund ta kalojë 1/3 e mallit që ka lënë pa lejën e trashëgimtarëve.

Lexim letrar
Vendi i agait

Disa nga shokët më erdhën e më thanë:

- Po ndërtojmë një konvikt për nxënësit e varfër. Bëhu ti i pari i kësaj pune e të mbledhim pak ndihma!

E pranova propozimin e tyre dhe, të nesërmen, e kërkova një afarist që ia kishin ngjitur llagabin "aga" pse ishte shumë i pasur.

Kur e kuptoi se i kërkoja para, më tha:

- Punë që bëhet! Eja e të takohemi!

Me një dëshirë të madhe i shkova në zyrë, mora leje në paradhomë nga sekretarja dhe hyra brenda. Pasi më dëgjoi të dhënat mbi ndërtesën, nxori nga xhepi një kartmonedhë një mijëshe që ma drejtoi duke më thënë:

- Urdhëro! Le të kontribuojmë edhe ne!

Mbeta pa mend! Megjithatë, duke e ruajtur qetësinë dhe duke u përpjekur që të bëhem edhe unë pak i pafytyrë, i thashë:

- A s'janë si pak ato zerot e kësaj letre? Pata menduar se do të jepje të paktën njëqind mijë!

Por ai, duke u treguar se s'ishte prekur fort nga fjalët e mia, ma ktheu:

- Kësaj radhe le të mbetet me kaq! Nuk mund të hapem shumë, sepse kam për të blerë tokë për të ngritur një qytezë banimi.

- Sa tokë të duhen? - E pyeta.

- Gjer më 200 dynym. Nëse e realizoj këtë dhe i mbyll shpenzimet e blerjes së tokës, do t'u fal konviktit dhe nxënësve të varfër njëqind mijë lekë! Po t'ia vini ndërtesës emrin tim, këtë shumë e bëj edhe më të madhe.

E falënderova dhe dola. Pas një kohe të shkurtër ia nisëm ndërtimit. Në këtë mes, ngaqë kishim vazhdimisht vështirësi financiare, e kujtonim shpesh aganë dhe ndiqnim se gjer në sa dynymë kishte arritur gjer atë ditë.

Pas tre muajsh nga dita e takimit, kur i telefonuam sekretares, ajo na tha:

- Vendi i agait arriti në njëqind e njëzet dynymë, nga të cilat, shumica në breg të liqenit. Tani radhën e ka zona pyjore ngjitur me liqenin.

Kur e mbaruam ndërtesën si karabina, e kërkuam përsëri aganë.

- Vendi i agait arriti në njëqind e pesëdhjetë dynymë në breg të liqenit dhe mes pyllit. Pas disa muajsh puna merr fund!

Por, pas pak kohe, kur i telefonuam prapë me shpresë se do t'i merrnim qindramijërat e premtuara, sekretarja na u përgjigj:

- Vendi i agait zbriti në 2 metra katrorë nën hijen e një selvie! Agai na vdiq javën që shkoi! A s'e dëgjuat?

G. PERSONAT, TË CILËVE U JEPET ZEKAT DHE RADHA PËRPARËSORE

Personat, të cilëve u jepet zekat janë përcaktuar në Kuran:

إِنَّمَا الصَّدَقَاتُ لِلْفُقَرَآءِ وَالْمَسَكِينِ وَالْعَامِلِينَ عَلَيْهَا وَالْمُؤَلَّفَةِ قُلُوبُهُمْ وَفِى الرِّقَابِ وَالْغَارِمِينَ وَفِى سَبِيلِ اللهِ وَابْنِ السَّبِيلِ...

"Si një farz i Allahut, zekatet u takojnë vetëm të varfërve, nevojtarëve, nëpunësve (që mbledhin zekat)**, atyre që kërkohet t'u ngrohen zemrat me Islamin, skllevërve** (që përpiqen të fitojnë lirinë)**, atyre që kanë borxhe, atyre që luftojnë në rrugë të Allahut dhe udhëtarëve..."**[6]

Sipas këtij ajeti, personat që duhet t'u jepet zekat, janë këta:

a. Të varfrit. Janë personat që s'kanë aq mall ose para sa të quhen të pasur fetarisht, domethënë sa të jenë të detyruar për të dhënë zekat.

b. Nevojtarët. Janë të varfrit që s'kanë asnjë lloj pasurie, që janë nevojtarë për çdo gjë dhe që, për të jetuar, janë të detyruar të lypin.

c. Nëpunësit që mbledhin zekat. Personat me zhvillim mendor normal që kanë arritur moshën e pubertetit, që janë të sigurtë dhe që e njohin të drejtën e zekatit, kur ngarkohen me detyrën e mbledhjes së zekateve, marrin pjesë nga zekatet si shpërblim detyre edhe nëse janë të pasur. Por sot, në ato vende ku zekati nuk mblidhet me nëpunës të caktuar, kjo kategori njerëzish nuk ekziston.

d. Njerëzit që kërkohet të afrohen me Islamin.

Këta janë tre llojesh:

1. Personat e bërë myslimanë rishtazi me besim ende të paforcuar.

2. Personat ende të pabërë myslimanë por që kanë shpresë se kanë për t'u bërë.

3. Personat, të cilëve u jepet zekat për t'i marrë me të mirë e për t'u ruajtur nga e keqja e tyre pse dyshohet se kërkojnë t'u bëjnë keq myslimanëve.

Sipas shkollës hanefite, nga këta, zekat u jepet vetëm personave të grupit të parë, kurse të tjerëve nuk u jepet zekat, sepse nuk janë myslimanë.

6 Kurani, Et-Teube: 60.

Në periudhën e kalifatit të tij, Hz. Omeri (r.a.) nuk u ka dhënë zekat *njerëzve që kërkohet të afrohen me Islamin.* Ai pati thënë se myslimanët, më në fund, ishin forcuar, se Islami nuk kishte më nevojë për njerëz të tillë, se, për rrjedhojë, atyre nuk do t'u jepej më zekat. Ky opinion i Hz. Omerit qe pranuar dhe pas asaj kohe këtij grupi nuk i është dhënë më zekat.

e. Skllevërit (robërit). Zekati jepet për këta për t'i shpëtuar nga robëria ose skllavëria. Por në ditët tona nuk ka më skllavëri dhe robëri të asaj natyre.

f. Borxhlinjtë. Sipas Islamit, këta janë personat e pafuqishëm për ta paguar borxhin e tyre. Ndërkaq, ky borxh nuk duhet të ketë buruar prej situatave dhe marrëdhënieve haram. Nuk u jepet zekat atyre që kanë rënë në borxhe duke shpenzuar për gjëra haram si pijet, bixhozi, etj.

g. Ata që punojnë e përpiqen në rrugë të Allahut. Këta janë nevojtarë që kanë marrë pjesë në luftë në rrugën e Allahut, nevojtarë që janë nisur për në haxh dhe kanë rënë në vështirësi në rrugë e sipër si dhe nxënësit dhe studentët e varfër.

h. Udhëtarët. Janë personat që u janë mbaruar paratë në udhëtim e sipër dhe që, për këtë shkak, nuk arrijnë dot në vendin e tyre. Këtyre, edhe sikur të jenë të pasur, u jepet zekat në qoftë se bien në gjendje të vështirë gjatë udhëtimit dhe ndihmohen gjersa të arrijnë në vendin e vet.

Njerëzit, të cilëve u jepet përparësi në zekat

E drejta e përparësisë në zekat fillon me ata me gjendje materiale më të dobët. Mes këtyre, është më mirë të fillohet nga farefisi më i afërt. Megjithëkëtë, dhënia e zekatit pa e respektuar këtë radhë, është e vlefshme.

Zekati nuk duhet t'u jepet personave që e kanë shpenzuar pasurinë për gjëra haram si pijet, bixhozi, etj.

Zekati mund t'i jepet një personi ose mund të ndahet midis disa personave. Në këtë rast është më mirë të veprohet si është më e dobishme.

Personat, të cilëve s'u jepet zekat

Personi që ka për të dhënë zekat, nuk ua jep këtë personave që ka nën ngarkim, për të cilët është i detyruar të kujdeset për strehimin, ushqimin, veshmbathjen dhe nevoja të tjera jetësore. Këta janë: nëna, babai, gjyshi, gjyshja, fëmijët, nipërit, mbesat, gruaja.

Nuk u jepet zekat të pasurve dhe fëmijëve të tyre të parritur.

Nuk u jepet zekat jomyslimanëve.

Nuk u jepet zekat atyre që, megjithëse janë të aftë për të punuar dhe mund të gjejnë punë, rrinë pa punë nga përtacia.

Nuk jepet zekat për xhamitë, faltoret, rrugët, urat.

Shpenzimet e përgatitjes dhe varrimit si dhe borxhet e një të vdekuri nuk mund të përballohen me anë të zekatit. Por zekat mund t'u jepet fëmijëve të të vdekurit nëse janë të varfër dhe ata mund ta përdorin zekatin për këtë punë.

Lexim letrar
Sa keq për Tha'leben!

Myslimani medinas Tha'lebe ishte shumë i dhënë pas mallit e pasurisë. Ai donte të bëhej i pasur. Më në fund, doli para Profetit dhe i tha:

- O i Dërguari i Allahut! Lutju Allahut për mua që të bëhem i pasur!

Profeti iu përgjigj kështu kësaj kërkese të Tha'lebes:

- Malli i paktë për të cilin mund të falënderosh, është më i dobishëm se malli i shumtë për të cilin s'mund të falënderosh!

Duke menduar një farë kohe mbi kuptimin e kësaj këshille, Tha'lebe shpëtoi qoftë edhe pak nga ambicja e fuqishme që ia turbullonte mendjen. Por kjo ndjenjë kurrsesi s'e lëshonte atë! Dhe një ditë Tha'lebe ia përsëriti sërish kërkesën Profetit:

- O i Dërguari i Allahut! Lutu për mua që të bëhem i pasur!

Kësaj radhe Profeti, duke u shprehur më hapur, e këshilloi kështu Tha'leben:

- A s'jam unë një shembull i mjaftueshëm për ty? Betohem në Allahun se, po të doja, këto male do të bëheshin ar e argjend e do të më viheshin pas...

Megjithëkëtë, Tha'lebe nguli këmbë:

- Betohem në atë që të ka dërguar ty se, po të më bëjë të pasur, do t'i mbroj të varfrit dhe çdo njeriu do t'i jap të drejtën që i takon!..

Dhe Profeti që nuk mundi t'i qëndronte kësaj këmbënguljeje të Tha'lebes, u lut:

- Zoti im! Jepi Tha'lebes pasurinë që kërkon!..

Pas kësaj, Tha'lebe nisi të merrej me kullotjen dhe rritjen e dhenve që u shtuan aq shumë dhe shpejt, saqë ai që e patën mbiquajtur "zogu i

xhamisë" se i falte që të gjitha namazet me xhemaat, tani filloi të shkonte në xhami vetëm në namazet e drekës dhe iqindisë, kurse namazet e tjera t'i falte pas tufës ose, disa herë, kaza.

Shpejt erdhi një ditë që tufën e stërmadhe të Tha'lebes s'e nxinte më zona pranë Medines dhe Tha'lebe u detyrua të dilte për kullotë dhe ujë në zonat më të largëta. Kështu, Tha'lebe dukej tani në xhami vetëm ditët e xhuma. Më në fund, dhentë e bënë atë ta harronte edhe xhumanë!

Një ditë, Profeti pyeti:

- Ku është Tha'lebe që s'duket fare?

Shokët iu përgjigjën:

- U bë me dhen. Dhe tani që dhentë iu shumuan aq shumë sa s'kishte ku t'i kulloste më këtu, vërtitet pas tufës së dhenve nëpër shkretëtirë!..

Profeti tha:

- Sa keq për Tha'leben!..

Pikërisht këtë kohë zbriti ajeti mbi zekatin dhe myslimanët që ishin në gjendje të mirë ekonomike, u urdhëruan t'i ndihmonin vëllezërit e tyre në gjendje të vështirë jetese.

Dhe myslimanët që iu përgjigjën me një gatishmëri dhe dëshirë të madhe urdhrit të këtij ajeti Kuranor, ua dhanë me dëshirë një pjesë të pasurisë vëllezërve myslimanë që jetonin me vështirësi. Kurse Tha'lebe i priti keq nëpunësit që i shkuan për t'u dhënë zekat dhe i ktheu duarbosh, duke u thënë me qortim: "Kjo që po bëni ju, është krejt një vënie nën haraç!"

Kur e dëgjoi këtë gjë, Profeti përsëriti:

- Sa keq për Tha'leben!..

Pasi Tha'lebe e shkeli betimin që kishte bërë para Profetit se "do t'i jepte secilit të drejtën që i takonte", zbriti ajeti Kuranor ku Zoti bënte të ditur se njerëzit që, megjithëse ishin të pasur dhe kishin dhënë fjalën se do të kujdeseshin për të varfrit, kishin kthyer nga fjala, ishin me dy fytyra, hipokritë...

Kur dëgjoi se Kurani e kishte futur në radhën e hipokritëve, Tha'lebe shkoi te Profeti dhe i tha se i kishte sjellë të drejtën e të varfërve, por Profeti, i hidhëruar, i tha:

- Tani s'mund ta marr më ndihmën tënde, Tha'lebe, Allahu më ka ndaluar për këtë! Shko tani!..

Pas vdekjes së Profetit, Tha'lebe u kërkoi edhe Hz. Ebu Bekrit, Hz. Omerit dhe Hz. Osmanit, me radhë, që t'ia pranonin zekatin, por ata i dhanë të njëjtën përgjigje:

- Si mund ta pranojmë ne ndihmën që s'ta pranoi i Dërguari i Allahut?

Në kohën e Hz. Osmanit, duke vdekur, Tha'lebes i tingëllonin në vesh fjalët e urta të Profetit:

"Malli për të cilin mundesh të falënderosh, është më i dobishëm për ty se malli për të cilin nuk mundesh të falënderosh!.."

PËRMBLEDHJE

1. Bëni përkufizimin e zekatit.
2. Thoni kuptimin e një ajeti mbi zekatin.
3. Thoni kuptimin e një hadithi mbi zekatin.
4. Shpjegojeni shkurt rëndësinë e zekatit.
5. Jepni të dhëna mbi dobitë e zekatit.
6. Përcaktoni se për kë është farz zekati.
7. Përcaktoni kushtet që duhet të plotësojë malli që do të jepet si zekat.
8. Thoni kushtet e vlefshmërisë së zekatit.
9. Thoni se cilat janë mallra themelore dhe cilat, mallra dytësore.
10. Jepni shkurt të dhëna mbi sasinë e zekatit të të imtave.
11. Thoni ç'dini mbi zekatin e të trashave.
12. Përcaktoni sasinë e nisabit të arit dhe argjendit.
13. Jepni të dhëna mbi zekatin e monedhave.
14. Jepni të dhëna mbi zekatin e mallrave të tregtisë.
15. Jepni shkurt të dhëna mbi zekatin e prodhimeve të tokës.
16. Thoni zekatin e minierave dhe thesareve.
17. Përcaktoni mallrat e pangarkuara me zekat.
18. Thoni personat, të cilëve duhet t'u jepet zekat.
19. Thoni personat, të cilëve nuk u jepet zekat.

PJESA III
SADAKAJA

ÇËSHTJET

1. Përkufizimi, rëndësia dhe llojet e sadakasë
2. Përkufizimi i sadakasë së fitrit dhe vendi i saj në fenë tonë
3. Nisabi i fitrit dhe kujt i jepet
4. Solidariteti

PUNË PËRGATITORE

1. Mësoni nga një libër ilmihali kuptimin e termit "sadaka".
2. Merrni njohuri nga mësuesit mbi llojet e sadakasë.
3. Ç'dobi ka sadakaja për shoqërinë? Thoni mendimet tuaja mbi këtë çështje.
4. A e dini se kujt nuk duhet t'i jepet sadaka? Thoni mendimet tuaja mbi këtë çështje.
5. Bajramit të Ramazanit i thuhet edhe Bajrami i Fitrit. Si e shpjegoni ju shkakun e kësaj?
6. Kërkoni në një ilmihal anët e përbashkëta dhe të veçanta të zekatit dhe sadakasë.
7. Ç'rol luan solidariteti në bashkimin dhe unitetin kombëtar? Diskutoni mbi këtë çështje.

A. PËRKUFIZIMI, RËNDËSIA DHE LLOJET E SADAKASË

a. Përkufizimi i sadakasë

Si fjalë, sadaka do të thotë *saktësim, të folur i drejtë e i saktë, shpenzim i një gjëje në rrugë të drejtë, etj.*

Si term, sadaka quhen "malli, paraja dhe gjëra të ngjashme të dhëna të varfërve për pëlqim të Allahut".

b. Llojet e sadakasë



Sadakatë janë tre llojesh: farz, vaxhib dhe nafile.

1. Sadakaja farz. Është zekati. Zekati është një adhurim më vete dhe ka konkluzione të posaçme për vete.

2. Sadakaja vaxhib. Këtu futen sadakaja e fitrit, shpërblimet (kefaretet) e kushtimit, betimit, agjërimit, etj.

3. Sadakaja nafile. Janë sadakatë përveç atyre farz dhe vaxhib.

Llojet e sadakasë nafile janë këto:

a. E drejta e të vjelave. Në kohën e të vjelave dhe mbledhjes së prodhimit, dhënia e një pjese të varfërve dhe fqinjve.

b. E drejta e mikut (vizitorit). Është, si sadaka, pritja dhe respekti ndaj udhëtarëve, vizitorëve e miqve, plotësimi i nevojave dhe gostitja e tyre.

c. E drejta e fqinjit. Ndihma ndaj fqinjit, plotësimi i nevojave të tyre, plotësimi, brenda mundësive, i kërkesave të tyre.

d. Sadakaja rrjedhëse. Dhurimi për vendadhurimet, për institucionet mësimore-edukative, për rrugë, ujë, ura, etj., për institucionet e bamirësisë.

Edhe nëse nga të mbjellat dhe frutat hanë kafshët, kjo është një lloj sadakaje. këtyre mund t'u shtohen edhe sadaka të tjera.

c. Dobitë dhe vlerat e sadakasë

Sadakaja është një mjet ndihme dhe solidariteti mes njerëzve. Duke dhënë sadaka, të pasurit ndihmojnë të varfrit të përballojnë nevojat e tyre.

Duke përshkruar besimtarët e devotshëm, Allahu i Lartë thotë kështu për ta: **"... dhe japin nga ajo që Ne u kemi dhënë si pjesë nga të mirat..."**[7] Siç kuptohet edhe nga ajeti, është Allahu që u jep njerëzve pjesë nga të mirat, prandaj njeriu duhet të jetë i vetëdijshëm për këtë, të mos tregohet dorëngushtë ndaj të varfërve, të kujdeset për nevojtarët e t'i mbrojë ata. Po veproi kështu, do ta marrë sevapin dhe shpërblimin nga Allahu me të tepërt. Profeti ynë (a.s.) ka porositur: *"Atij që plotëson një nevojë të vëllait të fesë, edhe Allahu e ndihmon. Atij që ia heq një shqetësim një myslimani, edhe Allahu ia heq atij shqetësimet në ditën e Kiametit!"*[8]

Kjo do të thotë se kur një njeri i jep sadaka një të varfri, njëkohësisht e ndihmon edhe veten. Sepse si përgjigje të asaj që jep, Allahu i Lartë ia heq shqetësimet dhe, në mënyrë të veçantë, i jep edhe sevap.

Dhënia e sadakasë i sjell marrëdhëniet midis njerëzive në një gjendje më të mirë. Mes tyre formohet bashkim, vëllazëri dhe dashuri. Sadakaja është, gjithashtu, shkak për shtimin dhe begatimin e mallit dhe pasurisë. Prandaj askush nuk duhet të rrijë larg dhe të shmanget nga dhënia e sadakasë, nuk duhet të pandehë se, duke dhënë sadaka, ka për t'u varfëruar. Profeti ynë (a.s.) ka porositur: *"Sadakaja nuk e pakëson mallin!"*[9]

Zoti që na jep dhe vazhdon të na japë ne çdo gjë, është bujar. Ai e do bujarinë dhe bujarët. Në lidhje me këtë çështje, Profeti ynë (a.s.) ka porositur kështu: *"Besimtari bujar është pranë Allahut, pranë xhennetit, pranë njerëzve, larg xhehennemit!"*[10]

Kjo do të thotë se sadakaja është njëra nga rrugët që e afrojnë njeriun me Allahun, me njerëzit e tjerë dhe me xhennetin, që e largojnë nga xhehennemi. Çdo mysliman që ka mundësi, duhet të japë sadaka me aq sa ka mundësi dhe duhet t'i nxisë edhe të tjerët për këtë.

7 Kurani, El-Bekare: 3.

8 Sahihu'l-Muslim, Kitabu'l-Birr ve's-Sila, 58.

9 Sahihu'l-Muslim, Kitabu'l-Birr ve's-Sila, 19.

10 Sunenu't-Tirmidhi, Babu'l-Birr ve's-Sila, 40.

Lexim letrar
Vendi i agait

Në një hadith të shenjtë, Allahu i Lartë urdhëron kështu:

"Jep, o njeri, që edhe ty të të jepet!" (Buhari, Muslim)

Poeti Mevlana (Xhelaleddin Rumi) e shpreh kështu të vërtetën e dhënies:

"Malli nuk pakësohet aspak duke dhënë. Të bësh mirë, e mbron mallin nga humbja, nga asgjësimi!"

"Zekati që dhe, bëhet roje i qeses tënde, ta ruan atë. Edhe namazi që fale, të shërben ty si çoban, të mbron nga të këqijat, nga ujqit!"

"Mbjellja ia zbraz hambarin bujkut që mbjell, por pa mendo se sa fishin e farës së mbjellur e merr fshatari, kur vjen koha e të korrave! Mendo se sa hambarë plot merr për një hambar të zbrazur!"

"Por nëse gruri nuk mbillet, nuk përdoret me vend, por fshihet në hambar, bëhet ushqim për krimbat, për minjtë, që s'lenë kokërr gruri në hambar!"

Allahu i Lartë urdhëron:

"Jepni nga gjërat që ju dhamë si pjesë e të mirave!" (Kurani, Munafikun:10)

"(O i Dërguar!) **Paralajmëroji për një ndëshkim të dhimbshëm ata që grumbullojnë ar e argjend e s'e shpenzojnë në rrugë të Allahut!.."** (Kurani, Et-Teube:34)

Është shumë e rëndësishme etika që duhet respektuar duke dhënë sadaka. Duhet dhënë shoqëruar me fjalë të zgjedhura, të kujdesshme, pa e prekur të varfrin. Madje, po të jetë e mundur, të jepet fshehtazi. Pastaj, gjërat e dhëna nuk duhen përmendur në vende të tjera. Etikën e dhënies Kurani e shpreh kështu:

"O ju që keni besuar! Mos i çoni kot mirësitë (mos i asgjësoni sadakatë) **që bëni, duke u mbajtur më të madh e duke e prekur tjetrin, ashtu siç bën ai që, megjithëse nuk e beson Allahun dhe ditën e ahiretit, e shpenzon mallin vetëm për t'u dukur!"** (Kurani, El-Bekare: 264)

d. Rëndësia e sadakasë nafile dhe vendi i saj në fenë tonë

Feja jonë ka nxitur dhënien, dhurimin e gjësë, mallit e pasurisë në atë formë që t'i prekë zemrat e t'i bëjë që ta duan të mirën. Një prej formave të dhurimit është sadakaja.

Allahu i Lartë urdhëron kështu në Kuran:

فَالَّذِينَ آمَنُوا مِنْكُمْ وَأَنْفَقُوا لَهُمْ أَجْرٌ كَبِيرٌ.

"... Për ata nga ju që besojnë dhe shpenzojnë për pëlqim të Allahut, ka shpërblim të madh!"[11]

مَثَلُ الَّذِينَ يُنْفِقُونَ أَمْوَالَهُمْ فِيْ سَبِيلِ اللهِ كَمَثَلِ حَبَّةٍ أَنْبَتَتْ سَبْعَ سَنَابِلَ فِيْ كُلِّ سُنْبُلَةٍ مِائَةُ حَبَّةٍ * وَاللهُ يُضَاعِفُ لِمَنْ يَشَآءُ وَاللهُ وَاسِعٌ عَلِيمٌ.

"Gjendja e atyre që e shpenzojnë mallin në rrugën e Allahut, është si puna e kallirit, nga kokrrat e të cilit dalin shtatë kallinj. Allahu i jep me të tepërt atij që do. Favori i Allahut është i madh. Ai di çdo gjë!"[12]

.... وَبِالْوَالِدَيْنِ إِحْسَانًا وَبِذِي لْقُرْبَى وَالْيَتَامَى وَالْمَسَاكِينِ وَالْجَارِذِى الْقُرْبَى وَالْجَارِ الْجُنُبِ وَالصَّاحِبِ بِالْجَنْبِ وَابْنِ السَّبِيلِ وَمَا مَلَكَتْ أَيْمَانُكُمْ ...

"... Bëjuni mirë nënës, babait, të afërmëve, jetimëve, të varfërve, fqinjit të afërt, fqinjit të largët, shokut të afërt dhe atyre që keni nën urdhër..."[13]

Këto ajete bëjnë shenjë për rëndësinë e sadakasë. Nuk është e drejtë që një njeri i pasur të mos mendojë për të varfrit, nevojtarët, dhe të mos ua zgjasë atyre dorën e ndihmës. Profeti (a.s.), megjithëse ka qenë prej ditësh i uritur, ia ka dhënë gjellën e

11 Kurani, Hadid: 7.

12 Kurani, El-Bekare: 261.

13 Kurani, En-Nisa: 36.

dërguar prej një sahabeje, lypësit që i ka shkuar te dera. Sakrifica të ngjashme shohim edhe në jetën e sahabeve. Myslimani që merr si shembull Profetin dhe sahabet, shokët e tij, duhet të përpiqet t'u ngjajë atyre edhe në ndjenjën e mirëbërësisë.

Të mos i ndihmosh të varfrit e nevojtarët edhe kur ke mundësi për këtë, është qëndrim jomysliman. Këtë e kuptojmë nga ky ajet:

"... Dhe i pyesin: "Ç'është ajo që ju ka zvarritur ju në këtë ndëshkim përvëlues?" Ata thonë: "Ne nuk ishim ndër ata që falnin namaz dhe nuk i ushqenim nevojtarët!"[14]

Në historinë e Islamit, vakëfet dhe institucionet e tjera të ngritura me qëllim për të plotësuar një sërë nevojash të individëve dhe shoqërisë, për ta ndihmuar shtetin në këtë drejtim, për t'u bërë shërbime njerëzve, janë mbështetur dhe mbajtur në këmbë me sadaka. Veçanërisht e madhe ka qenë dhe mbetet rëndësia e sadakave të dhëna për shërbime të tilla masive, si: xhamitë, rrugët, urat, çezmat, etj.

e. Ata që s'kërkohet të japin sadaka

Nuk ngarkohet me dhënien e sadakasë personi që është i varfër, që nuk mundet ta sigurojë jetesën e familjes, që ka borxhe zekati, fitri, kurbani dhe kefareti. Edhe personi që i ka borxh një tjetri, më parë duhet ta paguajë borxhin.

14 Kurani, El-Muddeththir: 40-44.

Lexim letrar
Ka nga ata që japin më shumë se ju!

Një herë, në kohën e kalifatit të Hz. Ebu Bekrit, në Medine u shfaq një zi buke e madhe. Populli nuk gjente dot dhe një kokërr gruri për të bërë bukë.

Kur e panë këtë gjendje tregtarët medinas, të gjithë paranë e vunë për blerjen e grurit për ta shitur, pastaj, me fitim.

Në këtë mes, edhe Hz. Osmani kishte dërguar një karvan tregtar për të blerë grurë në Damask. Karvani prej njëqind devesh të ngarkuara me grurë u kthye në Medine. Kjo sasi gruri plotësonte në një masë të madhe tërë nevojat e popullit për grurë.

Disa tregtarë iu drejtuan menjëherë Hz. Osmanit për të blerë grurë prej tij. Ata jepnin 4 derhem për një masë grurë. Por Hz. Osmanit iu duk pak çmimi i tregtarëve. Ai u tha atyre se ishte dikush tjetër që jepte më shumë se ata dhe nuk i dha grurë askujt. Atëherë, tregtarët propozuan një çmim blerjeje më të lartë, por Hz. Osmani i kundërshtoi duke u thënë përsëri se ishte tjetërkush që jepte më shumë. Më në fund, tregtarët qenë gati të jepnin edhe 7 derhem për masë. Ky ishte çmimi më i lartë i blerjes që mund të jepnin ata. Megjithëkëtë, Hz. Osmani prapë thoshte se ishte tjetërkush që jepte më shumë.

Këtë qëndrim të Hz. Osmanit, disa e shihnin si dëshirë për të përfituar nga rasti dhe si ambicje për të fituar sa më shumë. Ata mendonin se nuk i shkonte Hz. Osmanit një qëndrim i tillë, ndërsa populli përpëlitej në uri.

Më në fund, tregtarët vendosën t'ia paraqesin çështjen kalifit Ebu Bekr dhe t'i kërkonin ta zgjidhte mosmarrëveshjen mes tyre dhe Hz. Osmanit.

Shkuan tregtarët te kalifi dhe ia treguan punën siç ishte. Kalifi Ebu Bekr i dëgjoi gjer në fund dhe u tha:

"Në këtë punë ka diçka që nuk shkon. Mua më duket se ju s'e keni kuptuar Hz. Osmanin. Ai është dhëndrri i të Dërguarit të Allahut dhe shok i tij në xhennet. Ai nuk është njeri i tillë që të shfrytëzojë urinë e popullit për t'u pasuruar. Kjo sjellja e tij e ka një urtësi. Ejani të shkojmë së bashku e ta mësojë prej tij si qëndron puna!

Të gjithë së bashku shkuan te Hz. Osmani. Kalifi ia përcolli ankesën e tregtarëve dhe e pyeti se pse nuk ua shiste grurin me çmimin që ia kishin propozuar ata.

Përgjigjja e Hz. Osmanit i la të habitur. Ai i tha kështu kalifit:

"O zëvendësi i të Dërguarit të Allahut! Këta kërkojnë ta marrin grurin tim me 7 derhem për masë. Domethënë, japin shtatë për një, mirëpo unë kërkoj t'ia shes dikujt që jep 700 për një! A nuk premton Allahu se do të japë si shpërblim shtatëqind fishin e një të mire? Kur është një tregti me një fitim të tillë, pse t'ua shes mallin tim këtyre?"

Tregtarët u vunë në mendime të thella. Ata e kuptuan ç'gabim kishin bërë, duke menduar keq për Hz. Osmanin.

Të nesërmen Hz. Osmani e ndau tërë barrën e grurit prej 100 devesh si sadaka për popullin e Medines. Fytyra e të varfërve qeshi. Zija e bukës në qytet u kapërcye në një masë të madhe!

B. PËRKUFIZIMI I SADAKASË SË FITRIT DHE VENDI I SAJ NË FENË TONË

Fjala *fitër do të thotë agjërim, krijim, natyrë, karakter, moral.*

Si term, fitri është "sadakaja që duhet t'u japë të varfërve për hir të Allahut, një mysliman i pasur dhe i lirë, i cili ka arritur fundin e muajit të Ramazanit.

Fitri është bërë vaxhib në vitin e dytë të hixhretit. Kjo sadaka është shprehje e arritjes së muajit të Ramazanit, i cili, po të vlerësohet si duhet, bëhet pretekst për të fituar shumë sevap, shprehje e arritjes së agjërimit, i cili është një adhurim me vlera të mëdha te Allahu si dhe shprehje e falënderimit për të mirat që na jep Allahu.

Në lidhje me këtë sadaka, Profeti (a.s.) ka thënë kështu: *"Sadakaja e fitrit e pastron personin që agjëron nga gjynahu i fjalëve të shëmtuara të thëna gabimisht, kurse për të varfrit bëhet ushqim!"*[15]

Sipas shkollave malikite, shafiite dhe hanbelite, fitri është farz, sepse në këto shkolla nuk ekziston dallimi farz-vaxhib. Fakti që shkolla hanefite e quan fitrin vaxhib, nuk ia ul vlerën kësaj sadakaje, sepse edhe vaxhibi është një urdhër afër farzit. Çdo individ që plotëson kushtet e duhura, duhet ta japë këtë sadaka në kohë dhe të plotë. Ai që nuk e zbaton këtë, bëhet mëkatar.

Çdo mysliman që ka mundësi, duhet ta japë këtë sadaka që edhe atij vetë i përfton sevap, edhe të tjerëve u jep dobi. Fitri është një adhurim pasuror, zbatimi i të cilit është vaxhib. Personi i ngarkuar me dhënien e sadakasë së fitrit që nuk e jep atë, bëhet mëkatar.

15 esh-Shevkani, Nejlu'l-Eutar, II, 406.

Lexim letrar
Ka nga ata që japin më shumë se ju!

Në Shekullin e Lumtur, shokët e Suffes të cilët, duke ia kushtuar jetën vetëm shërbimit të rrugën e Islamit, nuk mendonin gjë tjetër veç se të mësonin, t'u jepnin mësim të tjerëve dhe të bënin adhurim, nuk gjenin dot kohë për të siguruar jetesën. Prandaj myslimanët e tjerë u çonin hurma. Një radhë, disa persona u patën çuar hurma të prishura dhe ata qenë detyruar t'i hanin. Pas kësaj ngjarjeje, për ata që u japin të varfërve dhe nevojtarëve nga pjesa më e pavlerë e mallit të tyre, zbriti ky paralajmërim hyjnor:

"O ju që besoni!... Mos u përpiqni të jepni duke shpresuar të mirë dhe dobi, mall të keq që nuk do të pranonit ta merrnit pa i mbyllur sytë nëse do t'jua jepnin juve! Dhe dijeni se Allahu është i pasur dhe i denjë për lavdërim!" (Kurani, El-Bekare: 267)

Edhe në një ajet tjetër, Allahu i Lartë na bën të ditur se, për të qenë afër Tij, duhet të japim nga gjërat që duam:

"Kurrë nuk mund ta arrini mirësinë e përsosur gjersa të mos keni dhënë nga gjërat që doni (gjersa të mos keni dhënë për Allahun). Çfarëdo që të jepni, Allahu e di saktë!" (Kurani, Al-i Imran: 92)

Kur u zbrit ky ajet, mes shokëve të Profetit nisi një garë e madhe për të dhënë nga gjërat më të dashura.

Ebu Talhai kishte pranë xhamisë profetike një kopsht hurmash prej gjashtëqind rrënjësh që e vlerësonte dhe e donte shumë. Ai e ftonte shpesh Profetin në kopsht, e gostiste me hurma, gjë që i sillte mbarësi edhe më të madhe kopshtit.

Ebu Talha tha kështu një ditë Profetit:

- O i Dërguari i Allahut! Pjesa më e vlefshme e pasurisë sime dhe më e dashur për mua është ky kopsht mes qytetit që e dini edhe ju. Duke fil-

luar nga ky çast, atë po ia lë të Dërguarit të Allahut për pëlqim të Allahut! Mund ta përdorni si të doni, mund t'ia jepni të varfrit që të doni!

Pas këtyre fjalëve, Ebu Talha u nis menjëherë për në kopsht për të zbatuar vendimin e tij të bukur. Kur arriti atje, e shoqja po rrinte nën hijen e një hurme. Ebu Talha nuk hyri në kopsht. E shoqja e pyeti:

- O Ebu Talha, ç'pret aty përjashta, pse s'hyn brenda?

Ebu Talha i tha:

- Unë s'hy dot brenda, po edhe ti, mblidh plaçkat e dil!

E shoqja që s'e priste një përgjigje të tillë, e pyeti e habitur:

- Pse, o Ebu Talha? A nuk është ky kopshti ynë?

Ebu Talha iu përgjigj:

- Jo, ky kopsht është tani i të varfërve të Medines...

Ebu Talha i tregoi me gëzim të shoqes për ajetin Kuranor dhe vlerën e dhurimit që kishte bërë. E shoqja e pyeti nëse dhurimin e kishte bërë vetëm në emër të vet apo në emër të të dyve dhe, kur mori vesh se Ebu Talha e kishte dhuruar kopshtin në emër të të dyve, i tha:

- Allahu qoftë i kënaqur me ty, Ebu Talha! Edhe unë po këtë gjë mendoja kur shihja të varfrit përreth, por s'kisha guxim të ta thoja! Allahu na e pranoftë mirësinë! Ja ku po dal edhe unë nga kopshti!

Në ajetin më sipër bëhet fjalë për mirësinë e përsosur ose kulmin e mirësisë që në origjinal emërtohet me fjalën birr. Krahas komentit të kësaj fjale si pika kulmore e mirësisë, si mëshira, pëlqimi dhe xhenneti i Allahut, në Kuran, në një ajet tjetër, bëhet një shtjellim tjetër i kësaj fjale:

"Kulmi i mirësisë (birr) nuk është ta ktheni fytyrën nga lindja apo perëndimi. E mira më e madhe e vërtetë është ajo që bën njeriu që u beson Allahut, ditës së pasme, engjëjve, librave dhe profetëve, që, duke kërkuar pëlqimin e Allahut, shpenzon nga pasuria e vet për të afërmit, jetimët, nevojtarët, udhëtarët të mbetur në rrugë, dhe skllevërit, që fal namaz dhe jep zekat, që bën durim në sëmundje dhe në kohë të vështira. Të tillë janë

njerëzit e mirësisë së vërtetë, me të cilën e tregojnë besnikërinë dhe e vërtetojnë sinqeritetin e vet. Këta janë njerëzit vërtetë të devotshëm." (Kurani, El-Bekare: 177)

Siç shihet, ky ajet që parashtron kuptimin e mirësisë së përsosur (birr), përmbledh të gjitha cilësitë e larta që duhet të ndodhen te njeriu. Duke e pasur fjalën për këtë, Profeti ka thënë:

"Kush vepron siç thotë ky ajet, e ka përsosur besimin e vet!" (Nesefi, Medariku't-Tenzil, I, 249)

C. NISABI I FITRIT DHE KUJT I JEPET

a. Nisabi i fitrit

Nisabi ose pasuria minimale bazë e sadakasë së fitrit, pasi të zbriten nevojat themelore, është sa nisabi i paraparë për kurbanin. Ndryshimi midis nisabit të fitrit dhe nisabit të zekatit është se në nisabin e fitrit futen edhe mallrat që nuk ngarkohen me zekat.

Është vaxhib që çdo mysliman i cili zgjohet i gjallë në mëngjesin e Bajramit të Ramazanit dhe i cili ka pasuri më shumë se nevojat themelore, të japë sadakanë e fitrit. Fitrin e gruas që s'ka pasuri, e jep i shoqi, fitrin e fëmijës së parritur, i cili s'ka arritur në moshën e pubertetit, e jep i ati ose e ëma. Edhe fitrin e fëmijës së rritur por që ende nuk ka krijuar familje, e jep i ati ose e ëma.

b. Me çfarë jepet fitër?

Gjërat që jepen si fitër dhe sasia e tyre është kështu:

Një fitër grurë, 1.666 kg. Po kaq është edhe sasia e nënprodukteve të grurit. Kurse një fitër thekërr, rrush i thatë dhe hurma e thatë është 3.333 kg.

Këto sende dhe sasia e tyre, të cilat merren si etalon për fitrin, janë llogaritur si ushqimi njëditor prej dy të ngrënash i një të varfri.

Si fitër mund të jepen si vetë këto sende, ashtu dhe kundërvlera e tyre e llogaritur në monedhë. Fitri në formë paraje është më i pranueshëm për të varfrin, sepse me para i varfri mund të plotësojë nevoja më të shumta e më të ngutshme se sa me sende ushqimore. Dhënia ushqim me qëllim fitri nuk vlen si fitër.

c. Kujt i jepet fitër?

Fitër i jepet çdo myslimani të varfër. Ndërkaq, mes një numri të varfrish, është më e mirë t'u jepet përparësi atyre që janë më nevojtarë, fisit të afërt, fqinjve të afërt. Fitri u duhet dhënë atyre që do ta përdorin atë për nevojat e tyre të domosdoshme dhe për qëllime të bekuara (hallall).

Një person nuk u jep fitër nënës, babait, gjyshit, gjyshes, fëmijëve, nipërve e mbesave, të shoqes si dhe personave të tjerë që ka nën kujdestari dhe që është i ngarkuar t'ua sigurojë jetesën. Është mekruh që fitri t'i jepet një të varfri të largët kur ekziston një i varfër i afërm.

Një person mund t'ia japë fitrin si një të varfri të vetëm, ashtu dhe mund ta ndajë mes disa të varfërve. Ndërkaq, disa dijetarë mendojnë se fitri mund t'i jepet vetëm një personi.

Fitri jepet duke bërë qëllim (nijet).

d. Kur jepet fitër?

Fitri bëhet vaxhib në mëngjesin e Bajramit të Ramazanit dhe duhet dhënë para namazit të Bajramit. Por mund të jepet edhe brenda muajit të Ramazanit.

Fitri i dhënë pas namazit të Bajramit nuk është efektiv, por kaza (i prapambetur).

Lexim letrar

Kopshti i shkatërruar

"Familja jonë është mjaft e madhe, kurse pasurinë e kemi të paktë. Nuk do t'u japim gjë të varfërve! Ta mbledhim prodhimin pa na ardhur ata që të na kërkojnë!"

Kështu u morën vesh djemtë, por Zoti ua shkatërroi prodhimin dhe arat, vreshtat dhe kopshtet e tyre u nxinë e u bënë që të mos njiheshin. Prandaj, kur erdhën të nesërmen djemtë për të mbledhur prodhimin, thanë të habitur:

"Mos kemi gabuar vendin?"

Kur ishte gjallë i ati i tyre, zekati që jepte bujarisht dhe lutjet e nevojtarëve të kënaqur i jepnin mbarësi prodhimit që shtohej vazhdimisht, kurse kjo dukej shumë në sytë e të bijve. Ata s'e dinin se nga i vinte begatia dhe mbarësia pronës së tyre, sepse indiferentizmi dhe ambicja ua kishin verbuar zemrat. Prandaj Allahu urdhëron:

"Mos u bëj ndër indiferentët!" (Kurani, El-A'raf: 205)

D. SOLIDARITETI

Solidariteti është ndihma që i japin individët njëri-tjetrit të nisur nga ndjenjat e bashkimit, unitetit dhe vëllazërimit, mbështetja morale e materiale për njëri-tjetrin.

Feja Islame që i jep njeriut vlerën e duhur, kërkon që njerëzit të jetojnë në paqe me njëri-tjetrin, ta ndihmojnë në mënyrë të dyanshme njëri-tjetrin, të ndajnë me njëri-tjetrin gëzimet e hidhërimet.

Rëndësia e solidaritetit për bashkimin dhe unitetin kombëtar

Allahu i Lartë i ka krijuar njerëzit në raca e gjuhë të ndryshme në mënyrë që, duke u dalluar nga njëri-tjetri, të njihen e të merren vesh mes tyre.[16] Kjo njohje dhe marrëveshje është ndër faktorët që siguron bashkimin dhe solidaritetin mes njerëzve.

Sjellja e mirë ndaj njerëzve, respekti ndaj tyre, respektimi dhe kujdesi për të drejtat e tyre janë ndër çështjet që feja jonë u ka dhënë rëndësi të veçantë. Allahu i Lartë na ka urdhëruar të sillemi mirë me prindërit, të kujdesemi për ta, t'u flasim me fjalë të mira, t'i mbrojmë ata, na ka urdhëruar edhe t'u bëjmë mirë e të ndihmojmë farefisin, të varfrit, fqinjt, të vetmuarit, udhëtarët, shokët, njerëzit e shërbimit, punëtorët: **"... dhe ndihmoni njëri-tjetrin me të mirë dhe devocion, jo për mëkat dhe armiqësi dhe kini frikë Allahun..."**[17]

Edhe Profeti ynë (a.s.) na ka këshilluar dhe porositur që të sillemi mirë me njerëzit, të mos prekim askënd, të mos i bëjmë keq askujt, të respektojmë të drejtën e personit, që myslimanët të bashkohen fort me njëri-tjetrin, të jetojnë si vëllezër, të lehtësojnë shqetësimet e njëri-tjetrit.

Myslimanët që e kanë kuptuar mirë rëndësinë e parimit të ndihmës reciproke dhe solidaritetit, kanë treguar, për këtë, zellin dhe përpjekjet e duhura. Për ta realizuar këtë qëllim, ata kanë themeluar vakëfe dhe institucione ndihme dhe mirëbërësie, duke u bërë shembull për njerëzimin edhe në këtë çështje krahas gjërave të tjera të mira e të bukura. Institucione ndihme dhe solidariteti janë ngritur edhe midis shteteve të botës. Të gjitha këto tregojnë se sa rëndësi kanë ndihma reciproke dhe solidariteti për sigurimin e vazhdimësisë së bashkimit dhe unitetit.

16 Kurani, El-Huxhurat: 13.

17 Kurani, El-Maide: 2.

Lexim letrar
Ka nga ata që japin më shumë se ju!

Një herë e një kohë ishte një njeri shumë i pasur. Ishte aq i pasur sa nuk e dinte se sa mall dhe para kishte. Por ishte edhe shumë dorështrënguar e koprrac.

Një ditë i shkoi në derë një i varfër.

- Për hir të Zotit, më jepni për të ngrënë! - u lut i varfri. Kurse pasaniku i pamëshirë i foli rëndë dhe e përzuri:

- Zhdukmu nga dera! A s'të vjen turp që lyp në vend që të punosh e ta fitosh vetë bukën e gojës?

I varfri i foli duke e përkulur qafën dhe me përulje:

- Sa çudi! Mirë unë që e rrudh fytyrën se jam i varfër, po ti që je i pasur, pse ke harruar të qeshësh e të thuash fjalë të mira?

- Zhduku, po të them, zhduku!

- Mos u mbaj me të madh! - ia ktheu i varfri. - As varfria, as pasuria s'janë të përjetshme. A s'ke menduar se mund të vijë një ditë që ta humbësh gjithë pasurinë e të bëhesh i varfër?

Pasaniku i pamëshirë u nevrikos tepër. E thirri shërbëtorin dhe e urdhëroi:

- Hiqma sysh këtë njeri!

Shërbëtori e përzuri të varfrin. Në këtë mes kaluan disa vite...

Erdhi dita që pasanikut koprrac dhe të pamëshirë t'i shkonin punët keq. Çdo gjë nisi t'i shkonte për së prapi. E gjithë pasuria iu shkri brenda një kohe të shkurtër dhe në dorë s'i mbeti më asgjë.

Një ditë, shërbëtori i doli para dhe i tha:

- Unë nuk mund të shërbej më pranë teje se s'më ke paguar. Po shkoj të kërkoj një derë tjetër!

Pasaniku e përzuri shërbëtorin me të thirrura e me të shara. Shërbëtori iku e zuri punë pranë një pasaniku të mirë, të mëshirshëm e bujar. Zotëria i ri ishte njeri zemërmirë. Ai nuk i përzente të varfrit, që i shkonin në derë për të lypur. I ushqente ata, u jepte rroba, u jepte edhe pak para dhe ata ndaheshin duke e uruar e bekuar.

Një ditë i shkoi në derë një i varfër si zakonisht. Njeriu dukej në gjendje shumë të keqe. Dukej se s'kishte ngrënë prej ditësh. Zgjati dorën dhe u lut:

- Për hir të Zotit, më jepni një copë bukë!

Pasaniku zemërmirë thirri shërbëtorin dhe, duke i treguar lypsarin, e urdhëroi:

- Jepi të hajë, jepi rroba të vishet dhe futi në xhep pak para për udhë!

Kur shërbëtori ia çoi ushqimin dhe e pa në fytyrë, u habit. Vrapoi te i zoti dhe i tha:

- Imzot, a e di se kush është ai lypsari te dera?

- Kush është?

- Zotëria im i vjetër! Ai pasaniku koprrac prej të cilit u largova!

Pasaniku zemërmirë buzëqeshi:

- A s'e njoha unë? Kur ti shërbeje te ai, unë pata ardhur për të lypur tek ju dhe ai të pati urdhëruar ty të më përzeje. Shih urtësinë e Zotit që ai u varfërua, kurse unë u përpoqa dhe u pasurova! Askush s'duhet t'i besojë pasurisë dhe askush s'duhet të ketë turp se është i varfër. Allahu është Zoti i të gjithëve, që i jep kujt të dojë nga thesaret e Tij. Njeriu duhet ta shpenzojë në rrugën e Zotit pasurinë që ia ka dhënë Ai! T'i mbrojë të varfrit e të kujdeset për ta!

PËRMBLEDHJE

1. Bëni përkufizimin e sadakasë.
2. Jepni të dhëna mbi rëndësinë dhe vlerën e sadakasë.
3. Thoni një hadith profetik mbi sadakanë.
4. Thoni llojet e sadakasë.
5. Tregoni rëndësinë e sadakasë nafile.
6. Thoni kuptimin e një ajeti lidhur me sadakanë.
7. Tregoni njerëzit që nuk janë të ngarkuar për të dhënë sadaka.
8. Bëni përkufizimin e sadakasë së fitrit.
9. Jepni të dhëna mbi nisabin e fitrit.
10. Tregoni se me ç'gjëra mund të jepet fitri dhe sasitë e tyre.
11. Tregoni se kujt mund t'i jepet fitër.
12. Thoni se në ç'kohë mund të jepet fitri.
13. Jepni njohuri të shkurtra mbi rëndësinë e solidaritetit për bashkimin dhe unitetin kombëtar.

PJESA IV
HAXHI

ÇËSHTJET

1. Përkufizimi, rëndësia dhe dobitë e haxhit
2. Llojet e haxhit
3. Shtyllat e haxhit
4. Kushtet e haxhit
5. Vaxhibet, sunnetet dhe etika e haxhit
6. Umre
7. Çështje të tjera lidhur me haxhin dhe umren
8. Urtësitë e haxhit

PUNË PËRGATITORE

1. Mësoni duke pyetur mësuesin se kur haxhi u bë farz.
2. Nëse keni në familje njerëz që kanë shkuar në haxh, mësoni prej tyre se si bëhet haxhi.
3. A ka ekzistuar adhurimi i haxhit edhe në fetë e tjera para Islamit? Bëni kërkime mbi këtë çështje në librat e historisë së feve.
4. Thoni pikëpamjet tuaja mbi rëndësinë e Qabes për myslimanët.
5. Diskutoni mbi rëndësinë e haxhit për myslimanët e botës.
6. Ç'ndryshime shohim në mënyrën e jetesës te ata që bëjnë haxh?
7. Mësoni nga një libër ilmihali kuptimet e termave ihram, shaut, tavaf dhe saj.
8. Gjeni dhe shkruani në fletore disa hadithe mbi vlerat e haxhit

A. PËRKUFIZIMI, RËNDËSIA DHE DOBITË E HAXHIT

Si fjalë, haxh do të thotë vizitë e vendeve të nderuara.

Si term i së drejtës Islame (fikh), **haxhi është qëndrimi për një kohë të përcaktuar në Arafat dhe vizita e Qabes duke e bërë tavaf sipas rregullave.**

Personi që e kryen haxhin, quhet "haxhi".

Si një ndër pesë kushtet themelore të Islamit, haxhi është një adhurim pasuror dhe fizik që çdo mysliman, i cili plotëson kushtet përkatëse, e ka për detyrë ta kryejë një herë në jetë.

a. Haxhi si farz

Haxhi është bërë farz (detyrim) në vitin e nëntë të hixhretit të Profetit (a.s.) nga Meka në Medine.

Detyrimi (farz) i haxhit është i vendosur me Kuran, Sunnet dhe ixhma (mendimin e njëzëshëm të dijetarëve Islamë).

Zoti urdhëron kështu në Kuran:

.... وَلِلَّهِ عَلَى النَّاسِ حِجُّ الْبَيْتِ مَنِ اسْتَطَاعَ إِلَيْهِ سَبِيلاً وَمَنْ كَفَرَ فَإِنَّ اللهَ غَنِيٌّ عَنِ الْعَالَمِينَ.

"Është një e drejtë e Allahut mbi njerëzit që ta vizitojnë Qaben ata që kanë mundësi të shkojnë në haxh. Kush e mohon këtë, ta dijë se Allahu është epror mbi botët (nuk ia ka nevojën askujt)."[18]

Edhe Profeti ynë (a.s.) ka shumë hadithe mbi këtë çështje. Njëri nga këta është kështu: *"O njerëz! Allahu e ka bërë haxhin detyrim për ju, prandaj bëni haxh!"*[19] Ky hadith është argument se detyrimi i haxhit është i mbështetur edhe me Sunnet.

Të gjithë myslimanët duhet ta pranojnë se haxhi është farz (detyrim) dhe se ata që kanë mundësi, duhet ta kryejnë, se për detyrimin e haxhit ka mendim të njëzëshëm (ixhma).

---

18 Kurani, Al-i Imran: 97.

19 Sehihu'l-Muslim, Kitabu'l-Haxh, IV, 224.

Personi që nuk e pranon se haxhi është farz (detyrim) dhe që e nënvleftëson atë, del nga feja. Kryerja e haxhit është farz (detyrim), prandaj edhe ai që s'e kryen, bën gjynah (mëkat), pra, bëhet mëkatar.

b. Urtësitë dhe dobitë e haxhit

Të gjitha adhurimet kryhen sepse janë urdhër i Allahut. Edhe gjërat haram lihen, nuk kryhen, sepse janë gjëra të ndaluara me urdhër të Allahut. Çdo gjë që urdhëron Allahu, është, për njeriun, e mirë dhe e dobishme. Ne përpiqemi t'i kryejmë adhurimet edhe pse mund të mos i dimë të gjitha urtësitë e tyre.

Myslimanët e mbledhur bashkë për të kryer adhurimin e haxhit, duke iu drejtuar Allahut me vetëdijen dhe emocionin e adhurimit, i luten Allahut dhe i kërkojnë t'ua falë gjynahet, shfaqin dëshirën të jetojnë me besim të plotë e të shkojnë në jetën e pasme (ahiret) me besim të plotë. Zemrat e myslimanëve prehen e qetësohen me lajmin e gëzuar të Profetit (a.s.) se *"haxhi i fshin gjynahet para tij"*[20] dhe e kuptojnë më mirë kuptimin e hadithit që thotë: *"Kush bën haxh për Allahun dhe, në këtë mes, nuk thotë fjalë të këqija, nuk bën të këqija dhe gjynahe, kthehet nga haxhi krejt i pastër, si të kishte lindur për së dyti!"*[21] Pastaj, me kënaqësinë dhe emocionin e fituar në haxh, bëjnë pendesë dhe japin fjalën se nuk do të bëjnë më!

Në haxh, myslimanët njihen me vëllezërit e fesë të ardhur nga vendet e tjera dhe formojnë miqësi me ta.

Mungesa e disa të mirave gjatë haxhit ia mëson njeriut më mirë vlerën e tyre. Dhe kjo situatë i drejton myslimanët e pasur t'i ndihmojnë më shumë të varfrit. Edhe me këtë anë të tij, haxhi bëhet shkak që t'u zgjatet dora e ndihmës dhe dhembshurisë të varfërve.

Largimi prej të afërmëve dhe miqve ia kujton njeriut vlerën e tyre, kurse lodhja nga pamundësia për t'u çlodhur si duhet, vlerën e shëndetit.

Si veshja e vetme në haxh, ihrami, e bën njeriun ta ndjejë se pasuria, posti dhe pozita të kësaj bote s'kanë rëndësi dhe se para Allahut të gjithë janë të barabartë. Qëndrimi në Arafat me këtë veshje-qefin ia kujton njeriut grumbullimin pas ringjalljes dhe e shtyn njeriun të përgatitet për atë ditë.

20 Sahihu'l-Muslim, Kitabu'l-Iman, Hadithi Nr. 121.

21 Sahihu'l-Muslim, Kitabu'l-Haxh, II, 141.

Vizita e Qabes, e Xhamisë Profetike, e varrit të Profetit dhe e varrezave të dëshmorëve të fesë ua kujton njerëzve Shekullin e Lumtur, ua forcon ndër zemra dashurinë për Profetin dhe i orienton për t'u lidhur më fort pas Sunnetit.

Duke bërë haxh, shijohet qetësia, gëzimi dhe lumturia e zbatimit të një urdhri të Allahut, zemra e njeriut të pastruar prej mëkateve zbutet, i shtohen ndjenjat e dhembshurisë dhe mëshirës ndaj njerëzve. Njeriu tregon kujdes që të mos i bëjë keq askujt, që të mos e ngacmojë dhe prekë askënd.

Haxhi ka edhe shumë urtësi dhe dobi. Kjo është një detyrë e lartë që myslimani, i cili është i detyruar ta kryejë, duhet kryer pa e lënë pas dore.

c. Vendi i haxhit në fenë tonë

Haxhi është një ndër pesë kushtet e Islamit. Profeti (a.s.) e ka treguar në këtë hadith se haxhi është ndër kushtet e Islamit:

"Islami është ngritur mbi pesë gjëra: dëshmia se Allahu ekziston dhe është një dhe se Muhammedi është robi dhe i dërguari i Tij, falja e namazit, dhënia e zekatit, agjërimi i Ramazanit dhe shkuarja në haxh (sipas mundësisë)."[22]



22 Sahihu'l-Muslim, Kitabu'l-Iman, I, 19-20.

Haxhi është një adhurim që duhet ta çojë në vend çdo mysliman, i cili plotëson kushtet e caktuara. Meqë ky adhurim është **farz i njëjtë** (ajn), çdo mysliman është i detyruar ta kryejë vetë personalisht. Nuk është e lejueshme (xhaiz) që një person, i cili nuk ka ndonjë justifikim efektiv, të dërgojë një njeri tjetër për të bërë haxh në vend të tij, por mund të dërgojë një tjetër si dorëzanës në qoftë se nuk është në gjendje të shkojë vetë.

Nëse një mysliman shkon në haxh në një periudhë kur haxhi nuk është farz për të, dhe i plotëson detyrat e haxhit, përgjegjësia mbi të ngrihet dhe nuk kërkohet që të shkojë në haxh përsëri pas kësaj. E kundërta, nëse një mysliman nuk shkon në haxh megjithëse ka mundësi dhe atëherë kur ka mundësi dhe më vonë nuk shkon dot për shkaqe të ndryshme, bëhet përgjegjës.

Gruaja që e ka farz haxhin dhe ka një njeri të afërt në gjak (me të cilin nuk mund të martohet) për ta shoqëruar, është e detyruar të shkojë në haxh. I shoqi nuk mund ta pengojë për të shkuar në haxh. Por gruaja që s'e ka haxhin farz dhe kërkon të bëjë haxh nafile, nuk mund të shkojë pa lejën e të shoqit.

d. Vizitat në haxh

Me vizitat në haxh (si pjesë e adhurimit të haxhit) kuptohet tavafi i Qabes duke qenë i veshur me ihram dhe vajtje-ardhja e nxituar mes kodrave Safa dhe Merve.

Vizita e Qabes, e varrit të Profetit, e xhamisë profetike, janë elementë të etikës së haxhit. Po kështu, nëse gjendet mundësi, edhe varret e dëshmorëve të fesë, varrezën e përgjithshme, xhaminë Aksa dhe vende të tjera të rëndësishme.

e. Termat lidhur me haxhin si adhurim

1. Ihrami. Është largimi i përkohshëm nga disa gjëra të zakonshme (mubah) pasi të bëhet qëllim (nijet) për të bërë haxh ose umre ose të dyja bashkë. Ai që bën ihram, quhet "muhrim". Ky largim i përkohshëm shoqërohet me veshjen e rrobës përkatëse të emërtuar po me këtë fjalë. Nën ihram hyhet dhe Ihrami vishet në vendin e quajtur "Mikat" që është vendqëndrimi i çdo myslimani, i caktuar sipas planifikimit të bërë nga organizatorët e haxhit.

Veprimet e posaçme që kanë të bëjnë me hyrjen nën ihram dhe për të cilat personi që ka për të hyrë nën ihram, duhet të bëjë kujdes të veçantë, janë këto:

Priten thonjtë, shkurtohen mustaqet, rruhen sqetullat dhe vendet e tjera intime.

Qethen (ose rruhen) flokët ose lahen dhe krihen.

Bëhet larja e plotë trupore (gusl) ose merret abdest; larja trupore është më me vlerë.

Pastrohen papastërtitë në një pjesë çfarëdo të trupit nëse ka.

Zhvishen rrobat e qepura, lidhet rreth mesit një copë (izar), kurse një copë tjetër (rida) hidhet mbi supe. Zbathen këpucët.

Gratë nuk i heqin rrobat, nuk e zbulojnë kokën.

Falen dy rekate namaz. Është më me vlerë që në rekatin e parë të këndohet si sure sureja Kafirun, kurse në rekatin e dytë, sureja Ihlas. Ky namaz nuk duhet të falet në kohët mekruh.

Në fund të namazit i drejtohet lutje Allahut dhe kërkohet ndihmë dhe lehtësi prej Tij. Pastaj bëhet telbije.

Pas telbijes thuhet salavat për Profetin (a.s.). Lutjet bëhen me zë dhe telbija pas namazit bëhet e gjatë.

Pas hyrjes nën ihram:

Bëhen përpjekje për t'u shmangur nga gjynahet, nga grindja me të tjerët.

Bashkëshortët nuk krijojnë afërsi me njëri-tjetrin.

Nuk bëhet gjueti, nuk i shkohet në ndihmë gjuetarit.

Nuk vishen rroba të qepura, nuk mbathen këpucë, meshkujt e mbajnë kokën zbuluar. Nuk mbathen çorape, por në këmbë mund të mbathen sheshje ose nallane.

Nuk qethen ose rruhen flokët, nuk qethet ose shkurtohet mjekrra, nuk hiqen qimet e trupit.

Nuk priten thonjtë, nuk bëhet lyerje me aromatikë, në trup nuk lyhet vaj zbutës etj. Por mund të lyhet lëndë pa erë. Nuk digjet këna.

Nuk priten drurët dhe nuk shkulet bari që ndodhet brenda territorit të Qabes. Gjatë kohës nën ihram bëhet kujdes për respektimin gjer në fund të këtyre ndalimeve; edhe vetë fjala "ihram" do të thotë "kufizim, ndalim".

2. Telbije. Është lutja që këndohet pas namazit të ihramit. Por kjo lutje këndohet, gjatë haxhit, edhe kur takohet me një grup njerëzish, kur ngjitet në një vend të lartë, kur zbritet në një vend të ulët, kur ngrihet nga gjumi dhe kur zbardh drita. Përmbajtja e kësaj lutjeje është kështu:

لَبَّيْكَ اللهُمَّ لَبَّيْكَ, لَبَّيْكَ لآ شَرِيكَ لَكَ لَبَّيْكَ, إِنَّ الْحَمْدَ وَالنِّعْمَةَ لَكَ وَالْمُلكُ لآ شَرِيكَ لَكَ.

"Urdhëro, Allahu ynë, urdhëro! I bindem dhe i nënshtrohem gjithmonë urdhrit tënd! Dhe jam gati gjithmonë për këtë! Ti nuk ke të dytë! Urdhëro, Allahu ynë! I përgjigjem gjithmonë sinqerisht urdhrit dhe ftesës tënde! Pa dyshim, pasuria, të mirat dhe lavdërimet të përkasin ty! Ti je i pangjashëm e i pashok!"

3. Rrotullimi rreth Qabes (shaut). Është çdo rrotullim i plotë rreth Qabes që fillon aty ku ndodhet Guri i Zi dhe mbaron po aty.

4. Tavaf. Si një prej shtyllave ose elementëve përbërës të haxhit si dhe pjesë dhe formë e adhurimit të Qabes, tavafi përbëhet nga shtatë rrotullime rreth Qabes siç u përshkrua një pikë më lart. Shtatë rrotullime (shaut) përbëjnë një tavaf.

Duke filluar tavafin, qëndrohet përballë Gurit të Zi, ngrihen duart lart si për lutje dhe thuhet: "Filloj me emrin e Allahut të madh!" Pastaj fillohen rrotullimet që bëhen të gjitha në të njëjtën formë.

Nëse s'ka shumë njerëz, në çdo tre rrotullime bëhet një "ecje e shpejtuar akrobati" **(remel)**.

Pas tavafit falen dy rekate namaz të tavafit në **"vendin e Ibrahimit"** ose në ndonjë vend tjetër të përshtatshëm. Ky namaz nuk duhet falur në kohët mekruh. Si sure, është mustehab të këndohet sureja Kafirun në rekatin e parë dhe sureja Ihlas në rekatin e dytë. Në fund të namazit bëhet lutje.

5. Vajtje-ardhje e nxituar mes kodrave Safa dhe Merve (sa'j). Duke u nisur nga kodra Safa, bëhet shtatë herë vajtje-ardhje e nxituar mes këtyre dy kodrave që është vaxhib.

Kjo vajtje-ardhje fillon pas tavafit. Nisja bëhet nga maja e kodrës Safa drejt kodrës Merve. Në këtë rrugë ndodhen dy shtylla jeshile, largësia mes të cilave kalohet me vrap e i thuhet **"hervele"**. Gjatë këtij vrapimi, bëhet lutja: **"Allahu im! Më mëshiro dhe më fal! M'i fal të gjitha të metat që di Ti! Pa dyshim, Ti je i madh e i lartë!"** Kur arrihet në Merve, plotësohet një rrugë që konsiderohet një shaut. Edhe kthimi nga kodra Merve në kodrën Safa është një rrugë dhe konsiderohet një shaut. Kështu plotësohen shtatë rrugë (shaute).

6. Qëndrimi në Arafat (vakfe). Është qëndrimi në Arafat nga namazi i mesditës (drekës) i ditës së arifesë gjer në zbardhje të ditës së Bajramit të Kurbanit. Vakfe është një ndër shtyllat ose elementët përbërës të haxhit dhe kryerja e tij është farz.

Nëse vakfe lihet pa bërë, haxhi përsëritet kaza.

Gjatë vakfes qëndrohet kthyer nga ana e Qabes, falënderohet Allahu, këndohen Fjala e Njësisë dhe salavate, i bëhet lutje Allahut.

Është kusht i vakfes që të bëhet në Arafat dhe brenda kohës së caktuar.

7. Goditja e shejtanit me gurë. Pas vakfes në Arafat, bëhet vakfe edhe në Muzdefile. Pas kësaj shkohet në Mina, ku hidhen nga shtatë gurë në secilin prej tre shtyllave të gurëve. Në fillim qëllohet në shtyllën e madhe, pastaj në shtyllën e mesme, pastaj në shtyllën e vogël. Kjo hedhje gurësh që bëhet në ditët e Bajramit të Kurbanit, quhet "goditje e shejtanit me gurë".

Goditja e shejtanit, i cili është armiku më i madh i njeriut, me gurë, do të thotë kundërshtimi i tij, përzënia e tij. Personi që e qëllon këtu shejtanin me gurë, pas kësaj, gjatë gjithë jetës së vet, duhet të rrijë larg shejtanit, nuk duhet t'u nënshtrohet dëshirave të tij.

8. Therja e kurbanit në haxh. Për t'iu afruar mëshirës së Allahut ose për të dëmshpërblyer një mëkat të kryer më parë, në zonën e Qabes theret kurban. Cilësitë që kërkohen te kafsha që do të theret për kurban që është vaxhib, kërkohen edhe për këtë rast. Edhe kurbani i therur për një veprim të kryer në haxh në kundërvajtje me haxhin dhe për të cilin jepet ndëshkim, është vaxhib.

9. Qethja në haxh. Qethja e flokëve gjatë ditëve të Bajramit të Kurbanit në territorin e Qabes ose përreth, është ndër vaxhibet e haxhit. Në ditën e parë të Bajramit, në fillim goditet shejtani me gurë shtatë herë në shtyllën e vogël, pastaj thheret kurban dhe pastaj qethen flokët.

Meshkujt i qethin ose i rruajnë flokët plotësisht ose i shkurtojnë, kurse femrat i presin pak majat.

Pas qethjes së flokëve, dilet nga ihrami. Pas daljes nga ihrami marrin fund ndalimet e ihramit me përjashtim të marrëdhënieve seksuale. Haxhinjtë shkojnë në Qabe dhe bëjnë vizitën e quajtur tavaf.

Qethja gjatë kohës nën ihram është e ndaluar dhe kërkon dëmshpërblim (kefaret).

10. Aktet përbërëse të haxhit. Janë farzet, vaxhibet dhe sunnetet e haxhit, të cilat i përftojnë sevap atij që i kryen.

B. LLOJET E HAXHIT

- sipas konkluzionit:

1. Haxhi farz
2. Haxhi vaxhib
3. Haxhi nafile

- sipas përbërjes:

1. Haxhi ifrad
2. Haxhi temettu
3. Haxhi kiran

a. Llojet e haxhit sipas konkluzionit

1. Haxhi farz. Është haxhi që e ka për detyrë një herë në jetë, çdo mysliman që i plotëson kushtet e tij.

2. Haxhi vaxhib. Është kazaja e haxhit nafile të filluar e të ndërprerë në mes. Është vaxhib edhe kryerja e haxhit të kushtuar për diçka.

3. Haxhi nafile. Është haxhi i bërë për pëlqim të Allahut nga ata që e kanë kryer më parë haxhin farz si dhe nga fëmijët që nuk kanë arritur ende moshën e pubertetit.

b. Llojet e haxhit sipas përbërjes

1. Haxhi ifrad (i thjeshtë). Është haxhi farz, vaxhib ose nafile i kryer duke hyrë nën ihram me qëllimin vetëm për haxh dhe pa bërë umre. Duke hyrë nën ihram për këtë haxh, bëhet qëllim (nijet) vetëm për haxh. Ai që e kryen këtë haxh quhet **mufrid**.

2. Haxhi temettu. Në kohën e haxhit, në fillim bëhet nijet për umre, hyhet nën ihram dhe kryhet umreja. Pastaj, po në atë kohë, pa u kthyer në vendin e vet, personi hyn sërish nën ihram, por kësaj radhe, me qëllim për haxh, dhe e kryen atë sipas rregullave. Personi që e kryen këtë lloj haxhi që është më i vlefshëm se haxhi ifrad, quhet **mutemetti**.

3. Haxhi kiran. Është kryerja, në kohën e haxhit, e umres dhe haxhit bashkë nën një qëllim dhe nën një ihram. Personi që e kryen këtë lloj haxhi që është më i vlefshëm se haxhet e tjera, quhet **kárin**.

C. SHTYLLAT E HAXHIT

a. Qëndrimi (vakfe) në Arafat

Me qëndrimin në Arafat nënkuptohet pritja në Arafat nga një ditë para Bajramit të Kurbanit, domethënë nga namazi i mesditës (drekës) i ditës Arife gjer të nesërmen, domethënë ditën e Bajramit në mëngjes në zbardhjen e dytë (fexhri sadik). Është e mjaftueshme edhe një pritje e pjesshme brenda kësaj kohe. Por është vaxhib pritja ditën e Arifesë nga namazi i mesditës gjer në perëndimin e diellit (të asaj dite). Po të shkelet ky vaxhib, duhet therur një kurban si ndëshkim.

Larja trupore e plotë (gusl), qëndrimi i vazhdueshëm me abdest, agjërimi, kthimi kah Qabja dhe bërja e lutjeve, këndimi i salateve dhe selameve, falja e përbashkët e namazeve të mesditës dhe iqindisë në mesditë, fillimi i pritjes (qëndrimit) pas namazit të mesditës janë ndër sunnetet e pritjes (vakfes) në Arafat.

Një qëndrim (pritje) i dytë, i cili është vaxhib, bëhet edhe në Muzdelife. Pas zbritjes nga Arafati shkohet në Muzdelife, ku pritet qysh pas faljes së namazit të agimit të asaj dite që është dita e parë e Bajramit të Kurbanit, gjer sa të lindë dielli. Pritja kalohet me lutje.

b. Tavafi i Qabes

Rrotullimi shtatë herë rreth Qabes quhet **tavaf**. Katër rrotullimet e para të tavafit janë farz, tre të tjerat, vaxhib.

Personi që nuk e kryen tavafin, duhet ta përsërisë haxhin kaza.

Natyra e tavafit

Tavafi ka një veçanti të posaçme për të. Qabeja që bëhet tavaf, është Shtëpia e Allahut (bejtullah) kah e cila kthehen të gjithë myslimanët e botës kur falin namaz. Rrotullimet e bëra rreth kësaj ndërtese të shenjtë, domethënë tavafi, janë një adhurim i bërë edhe për Allahun.

Njeriu s'duhet ta nxjerrë nga mendja se, ashtu si gjithmonë, Allahu i Lartë e sheh atë edhe gjatë tavafit. Meqë tavafi është një adhurim, gjatë kryerjes së tij duhet qëndruar me edukatë dhe respekt. Lutjet e bëra gjatë tavafit të Qabes janë të pranueshme, kurse dhikri dhe tesbihet, me shumë sevap.

Llojet e tavafit

1. Tavafi i të largtëve (kudum). Është tavafi i parë i të ardhurve nga larg të hyrë nën ihram. Ky është sunnet.

2. Tavafi i vizitës. Është tavafi i bërë pas kthimit nga Arafati, pa ihram. Është ndër shtyllat e haxhit. Katër rrotullimet e para të tij janë farz.

3. Tavafi i lamtumirës. Është tavafi pa ihram i bërë pas zbritjes në Mekë nga goditja e shejtanit me gurë. Ky tavaf është vaxhib për të ardhurit jashtë Mekës. Me këtë tavaf haxhi merr formë përfundimtare.

4. Tavafi nafile. Është tavafi që bëjnë herë pas here myslimanët mekas. Për të ardhurit, ky tavaf është më me vlerë se namazi nafile, sepse ata s'mund ta gjejnë gjithmonë këtë rast.

5. Tavafi i umres. Është tavafi, katër rrotullimet e para të të cilit janë shtyllë e umres. Bëhet nën ihram dhe është farz për ata që bëjnë umre.

Kushtet e tavafit

Tavafi bëhet gjatë ditëve të Bajramit të Kurbanit, rreth Qabes, pas qëndrimit (vakfe), nën ihram dhe duke bërë qëllim (nijet) për tavaf të vizitës.

Vaxhibet e tavafit

* Tavafi bëhet me abdest, fillohet nga Guri i Zi, duke e mbajtur Qaben në anë të majtë dhe jashtë murit të quajtur "Hatim".

* Pas katër rrotullimeve të para farz, të bëhen edhe tre rrotullime të tjera.

*Tavafi i vizitës të bëhet brenda ditëve të Bajramit.

* Pjesët e trupit që mbulohen gjatë namazit, duhet të mbulohen edhe gjatë tavafit.

* Pas çdo tavafi (pas çdo shtatë rrotullimesh) të falen dy rekate namaz.

Sunnetet e tavafit

* Njëri cep i copës së ihramit që hidhet supeve, të nxirret nën krahun e djathtë e të hidhet mbi supin e majtë.

* Tavafi të fillohet nga qoshja jugore e Qabes, e quajtur "rukni jemani", duke ecur drejt Gurit të Zi.

* Rrotullimet të bëhen njëri pas tjetrit dhe, pas çdo rrotullimi, të kthehet kah Guri i Zi, të përshëndetet Qabeja e të bëhet tekbir.

* Namazi prej dy rekatesh që duhet falur pas tavafit, të falet në vendin e Ibrahimit.

D. KUSHTET E HAXHIT

a. Kushtet e haxhit si farz

Personi që i plotëson këto kushte, e ka haxhin farz (detyrim):

* Të jetë mysliman.

* Të ketë zhvillim mendor normal.

* Të ketë arritur moshën e pubertetit.

* Të jetë i lirë. Haxhi nuk është farz për robërit e luftës, skllevërit, të arrestuarit dhe të burgosurit. Gjithashtu, në situatë normale dhe në vendet ku veprojnë shteti dhe ligjet, haxhi nuk është farz për personin, të cilit i është hequr liria me vendim gjyqi për gjithë atë periudhë që i është hequr liria.

* Të ketë mundësi materiale për të përballuar shpenzimet e veta të haxhit si dhe nevojat e jetesës së personave që ka nën kujdestari për gjatë gjithë kohës sa të jetë në haxh.

* Të ketë kohë të mjaftueshme për ta kryer haxhin plotësisht.

* Të jetë klinikisht i shëndoshë.

* Rruga nga do të kalojë, të jetë e sigurt.

* Të mos ketë ndonjë pengesë për të shkuar në haxh. Personat që ndodhen në burg, që janë marrë peng e që pengohen për të shkuar në haxh, nuk e kanë të detyrueshëm haxhin për sa kohë që vazhdon për ta kjo gjendje.

* Nëse gruas që do të shkojë në haxh, i ka vdekur burri ose ajo është ndarë nga burri, duhet ta ketë mbaruar periudhën e pritjes (iddet) që është, për gruan që i ka vdekur burri, më e pakta katër muaj e dhjetë ditë, kurse për gruan e ndarë, më e pakta tre muaj.

* Për në haxh, gruaja duhet të jetë e shoqëruar nga burri ose një person i afërt në gjak me të cilin s'mund të martohet, si i ati, gjyshi, vëllai, biri, nipi, xhaxhai, daja.

b. Kushtet e vlefshmërisë së haxhit

* Personi që do të bëjë haxh, duhet të jetë mysliman. Ky është kusht edhe për detyrimin e haxhit, edhe për vlefshmërinë e tij.

* Haxhi bëhet vetëm në mjediset e posaçme për të që janë Qabeja dhe Arafati.

* Koha e kryerjes së elementëve të haxhit. Qëndrimi ose pritja (vakfe) në Arafat bëhet në një kohë të caktuar që është nga namazi i mesditës i ditës arife gjer në zbardhjen e ditës së nesërme që është dita e parë e Bajramit të Kurbanit. Kurse tavafi i vizitës në Qabe bëhet brenda tri ditëve të para të Bajramit të Kurbanit.

* Nën ihram duhet të hyhet me nijetin për të bërë haxh.

E. VAXHIBET, SUNNETET DHE ETIKA E HAXHIT

a. Vaxhibet e haxhit

* Nën ihram të hyhet në Mikat.

* Të respektohen e të mos shkelen ndalimet e ihramit.

* Të qëndrohet në Arafat ditën e Arifesë nga koha e mesditës gjer në perëndim të diellit.

* Të qëndrohet në Arafat ditën e parë të Bajramit të Kurbanit qoftë edhe një orë mes kohës së zbardhjes dhe lindjes së diellit.

* Të bëhet goditja e shejtanit me gurë dhe para qethjes së flokëve.

* Të bëhet tavafi i vizitës brenda tri ditëve të para të Bajramit të Kurbanit.

* Pas katër rrotullimeve farz të tavafit të vizitës të bëhen edhe tre rrotullime të tjera.

* Të ardhurit nga larg (nga jashtë Mekës) të bëjnë tavafin e lamtumirës.

* Gjatë tavafit duhet qëndruar me abdest dhe duhen mbuluar pjesët intime të trupit.

* Tavafi duhet filluar gjithmonë nga vendi ku ndodhet Guri i Zi dhe duhet vazhduar duke e mbajtur Qaben në anë të majtë.

* Nëse s'ka ndonjë justifikim, personi duhet ta bëjë tavafin duke ecur vetë.

* Të falen dy rekate namaz pas çdo tavafi.

* Tavafet të bëhen jashtë vendit që quhet Hatim.

* Të bëhet vajtje-ardhje mes kodrave Safa dhe Merve duke filluar nga maja Safa. Kjo vajtje-ardhje të bëhet në kohën e haxhit.

* Të theret kurban pas goditjes me gurë në Mina. Kjo është vaxhib edhe për ata që bëjnë haxh, edhe për ata që bëjnë umre.

* Kurbani të theret në kohën mes goditjes së shejtanit me gurë dhe qethjes së flokëve.

* Pas therjes së kurbanit, të qethen ose të shkurtohen flokët.

b. Sunnetet e haxhit

* Para se të hyhet nën ihram, të bëhet gusl ose të merret abdest, të falen dy rekate namaz me nijet të sunnetit të ihramit.

* Si rrobë për meshkujt, të përdoren dy copa bezeje të bardhë e të pastër.

* Para ihramit të lyhet me lëngje aromatike.

* Pas ihramit, të këndohet telbije në kohën e zbardhjes, pas namazeve, në ngjitjet në të përpjeta dhe në zbritjet në të tatëpjeta dhe në çdo takim me grupe këmbësorësh.

* Pas telbijes të thuhet shpesh salat dhe selam për Profetin (a.s.).

* Pas salat dhe selameve të bëhen lutje drejtuar Allahut.

* Të lahet trupi për të hyrë në Mekë dhe të hyhet atje ditën.

* Kur të shihet Qabeja, të bëhet lutje, para Qabes të këndohen tekbir dhe tahlil.

* Ata që vijnë nga larg, të bëjnë tavafin kudum.

* Gjatë qëndrimit në Mekë, të bëhet kohë pas kohe tavaf nafile.

* Në tavafin e vizitës, meshkujt ta hedhin copën e sipërme duke e nxjerrë njërin cep të saj nën sqetullën e djathtë për ta hedhur mbi supin e majtë.

* Në tre rrotullimet e para të vizitës, meshkujt të bëjnë ecje të nxituar me hapa të shkurtër e duke tundur supet.

* Gjatë vajtje-ardhjes mes kodrave Safa dhe Merve, meshkujt ta bëjnë me vrap pjesën e rrugës mes dy shtyllave (dritave) jeshile. Kjo ecje me vrap quhet edhe "hervele".

* Ditën e shtatë të muajit dhilhixhe, pas namazit të mesditës, në Mekë, të mbahet një hutbe e vetme ku t'u mësohen njerëzve veprimet e haxhit.

* Ditën e tetë të dhilhixhes, pas lindjes së diellit, të kalohet nga Meka në Mina dhe të qëndrohet atë natë në Mina.

* Ditën e nëntë të dhilhixhes, pas lindjes së diellit, të kalohet nga Mina në Arafat.

* Ditën e parë të Bajramit të Kurbanit të këndohet një hutbe ku të përshkruhen detyrat e mbetura të haxhit.

* Pas namazeve të falura në Arafat dhe Muzdelife, të bëhen lutje drejtuar Allahut për prindët dhe të gjithë myslimanët.

* Të zbritet nga Arafati pas perëndimit të diellit dhe duke ecur ngadalë. Pastaj, pas arritjes në Muzdelife, për të mos iu bërë pengesë kalimtarëve, të qëndrohet për të bujtë në afërsi të kodrës "Kuzah" të mbiquajtur "Mesh'arul Haram".

* Natën e Bajramit të qëndrohet në Muzdelife dhe ditën e Bajramit në mëngjes të zbritet në Mina. Gjatë ditëve të prerjes së kurbanit (nahr) të qëndrohet në Mina bashkë me të gjitha plaçkat e rrugës.

* Goditja e shejtanit me gurë të fillohet ditën e parë në kohën mes lindjes së diellit dhe mesditës, kurse në ditët e tjera, në kohën mes mesditës dhe perëndimit të diellit.

* Nga Mina në Mekë të zbritet me nxitim. Ai që dëshiron, mund të niset për udhë ditën e dymbëdhjetë të dhilhixhes para perëndimit të diellit. Pritja gjer në perëndimin e diellit për të dalë në udhë është gjynah.

* Duke zbritur nga Mina në Mekë, të bëhet pak pushim në vendet e rrafshta të quajtura Muhassab dhe Ebtah.

* Të pihet ujë zemzemi pas tavafit të lamtumirës dhe faljes së dy rekateve namaz. Pirja të bëhet në këmbë duke parë kah Qabeja dhe të derdhet pak ujë mbi kokë dhe trup.

* Të shkohet në Medine dhe të vizitohet varri i Profetit (a.s.).

Ai që i lë sunnetet e haxhit, mbetet i mangët nga vlerat e haxhit.

c. Etika e haxhit

Janë disa rregulla etike, që duhen respektuar nga ata që do të nisen për në haxh. Kryesoret janë:

* Ai që ka ndonjë borxh, duhet ta shlyejë këtë para se të niset për udhë.

* Para nisjes duhet bërë pendesë për gjynahet dhe duhen bërë kaza adhurimet e mbetura pa kryer.

* Duhet ruajtur nga sjellja për t'u dukur, duhet sjellë me thjeshtësi.

* Duhet këshilluar me njerëz me përvojë mbi udhëtimin për në haxh.

* Po të shihet e nevojshme, të merret një shok si udhërrëfyes, si ndihmës dhe këshillues për durim.

* Gjatë rrugës duhet ruajtur nga ngatërresa dhe grindja me shokët e udhës dhe udhëtarët e tjerë.

* Duhen bërë përpjekje për t'i falur armiqtë, në se ka, dhe për t'i parë ata me mirëkuptim.

* Po qe e mundur, të dilet në udhë për haxh të enjten e parë të muajit ose të hënën në mëngjes.

* Duhen vizituar të afërmit, fqinjt dhe miqtë, duhet ndarë me ta duke kërkuar lutjet dhe bekimet e tyre. Edhe ata duhet ta presin personin kur të kthehet nga haxhi.

* Para nisjes dhe pas mbërritjes, të falen nga dy rekate namaz dhe të bëhen lutje.

Lexim letrar
Ka nga ata që japin më shumë se ju!

Qabeja është faltorja e parë e ndërtuar mbi tokë. Puna e parë e Hz. Ademit pas zbritjes në tokë, ka qenë ndërtimi i kësaj faltoreje me ndihmën e engjëjve. Duke u meremetuar herë pas here, Qabeja pati vazhduar të shërbente si faltore gjer në përmbytjen e Nuhut (Noes). Pas përmbytjes, vendi i saj qe humbur dhe prej saj s'pati mbetur më asnjë shenjë.

Allahu do t'ua caktonte profetit Ibrahim me të birin, Ismail, zbulimin e kësaj faltoreje të nderuar dhe rindërtimin e saj për ta bërë si orientues (kible) për myslimanët.

Një ditë, Hz. Ismaili ishte ulur nën një pemë pranë burimit Zemzem dhe po merrej me rregullimin e pajisjeve të harkut dhe shigjetës. Ai pa nga larg se një njeri po vinte drejt vendit ku po rrinte. Njeriu që po vinte, ishte i ati, Hz. Ibrahimi. Sapo Hz. Ibrahimi arriti aty, Ismaili u ngrit dhe e priti të atin me respekt e dashuri. Babë e bir që kishin kohë pa u parë, u përqafuan fort me njëri-tjetrin. Hz. Ibrahimi e puthte të birin në sy duke u përpjekur ta shuante mallin për të. Më në fund, pasi u çmallën, Hz. Ibrahimi i foli të birit:

"O Ismail! Allahu më ngarkoi një punë të madhe!"

"Im atë, bëj ç'të të ketë urdhëruar Allahu! - Iu përgjigj Ismaili.

Hz. Ibrahimi i tha:

"Por duhet të më ndihmosh edhe ti!"

Hz. Ismaili u gëzua fort:

"Im atë, unë të jap çfarëdo ndihme që të më kërkosh! Kurse ndihma në këtë punë të urdhëruar nga Allahu është për mua nder i madh!"

Atëherë Hz. Ibrahimi ia tregoi të birit se ç'duhet të bënin:

"Biri im, Ismail! Allahu më urdhëroi të ndërtojmë së bashku këtu një faltore!"

Duke folur, Ibrahimi bënte me shenjë vendin ku tani ndodhet Qabeja.

Hz. Ibrahimi me Hz. Ismailin filluan nga puna. Ismaili sillte gurë, kurse Ibrahimi ngrinte murin. Por erdhi një çast, kur muret u lartësuan aq sa Ibrahimi nuk i arrinte dot më. Atëherë, të dy, babë e bir u vunë të mendojnë për të gjetur një zgjidhje. Ismaili gjeti dhe solli një gur të gjerë e të lartë që e përdorën si skelë. Hz. Ibrahimi i hipur mbi gur, vazhdoi të ngrinte muret. Ky gur quhet "Pozita e Ibrahimit" (mekamul Ibrahim, vendi i lartë i Ibrahimit). Mbi gur ndodhet gjurma e këmbës së Hz. Ibrahimit.

Sot, pozita e Ibrahimit është, për haxhinjtë edhe vend vizite, edhe vend namazi.

F. UMREJA

a. Kuptimi i umres

Fjala umre do të thotë vizitë. Kurse si term, me umre kuptohet shkuarja në Qabe me qëllim për ta vizituar atë dhe për të kryer disa adhurime si tavafi i Qabes, hyrja nën ihram, vajtje-ardhja mes kodrave Safa dhe Merve, qethja e flokëve. Meqë një pjesë e veprimeve që bëhen në umre, bëhen edhe në haxh, umreja quhet edhe "haxh i vogël".

b. Konkluzioni mbi umren

Sipas shkollës hanefite, umreja një herë në jetë është sunnet muekked.

c. Ndryshimet mes haxhit dhe umres

Përveç anëve të përbashkëta mes haxhit dhe umres, mes tyre ka edhe anë të dallueshme që janë:

* Haxhi një herë në jetë është farz, kurse umreja një herë në jetë është sunnet muekked.



* Koha kur bëhet haxhi është e caktuar, kurse për umren nuk ka ndonjë kohë të caktuar.

* Umre mund të bëhet në çdo kohë të vitit përveç ditëve kur bëhet haxhi, domethënë ditës arife dhe katër ditëve të Bajramit të Kurbanit.

* Në umre nuk përmbahen vakfet e Arafatit dhe Muzdelifes, që duhen bërë në haxh.

* Në umre nuk bëhet goditja e shejtanit me gurë që bëhet në haxh.

* Në haxh mbahet hutbe, kurse në umre, jo.

* Në haxh përmbahen tavafet kudum dhe sader, kurse në umre, jo.

* Gjatë haxhit, në Arafat, namazet e mesditës e të iqindisë bashkohen e falen në mesditë, kurse në Muzdelife bashkohen namazet e mbrëmjes e të jacisë, që falen në mbrëmje. Një gjë e tillë nuk bëhet në umre.

* Në haxh theret kurban, kurse në umre, jo.

d. Koha e umres

Umreja nuk ka ndonjë kohë të caktuar. Umre mund të bëhet në çdo ditë të vitit, me përjashtim të ditës së nëntë të dhilhixhes (dita e Arifesë së Bajramit të Kurbanit) dhe katër ditëve në vazhdim të Bajramit të Kurbanit kur bërja e umres është mekruh.

e. Shtyllat e umres

Shtylla (elementi përbërës themelor) e umres është vizita e Qabes, kurse hyrja nën ihram është kusht i umres.

Tre rrotullimet e fundit të tavafit (i cili përbëhet prej shtatë rrotullimesh) janë vaxhib. Edhe vajtje-ardhja mes kodrave Safa dhe Merve dhe qethja ose shkurtimi i flokëve janë vaxhibe të umres.

Nëse personi që do të bëjë umre, është vendas nga Meka, hyn nën ihram jashtë Qabes; nëse është i ardhur, hyn nën ihram në vendin e quajtur Mikat. Personi që do të bëjë umre, respekton të gjitha ndalimet e haxhit. Ai hyn nën ihram me qëllim umreje. Pastaj bën telbije. Pasi hyn në Mekë, e bën Qaben tavaf sipas rregullave. Pas tavafit bën vajtje-ardhjen mes kodrave Safa dhe Merve. Pastaj qeth ose shkurton flokët. Kështu, ka dalë nga ihrami dhe e ka plotësuar umren.

f. Vendvizitat e umres

Personi që bën umre, viziton edhe varrin e Profetit (a.s.). Duke shkuar për atë vizitë, shpreh shumë salat dhe selam për të. Kur arrin në Xhaminë Profetike, në vendin mes minberit dhe varrit të Profetit fal dy rekate namaz nderimi për faltoren si dhe dy rekate namaz falënderimi dhe bën lutje për vete, për prindërit, për të afërmit dhe të tjerë. Pastaj viziton varret e Hz. Ebu Bekrit dhe Hz. Omerit dhe lutet për ta.

Vendet e tjera të vizitës janë varreza e përgjithshme, varreza e dëshmorëve të Uhudit dhe xhamia e Kubasë.

G. ÇËSHTJE TË TJERA LIDHUR ME HAXHIN DHE UMREN

a. Kurbani në haxh

Kurbani i therur në zonën e Qabes me qëllim për të arritur mëshirën e Allahut ose për të dëmshpërblyer (kefaret) ndonjë gjynah të bërë, quhet **hedj**. Cilësitë që kërkohen te kafsha për kurban, kërkohen edhe në këtë rast.

Ky kurban është tre llojesh:

1. Kurbani vaxhib. Është kurbani, që duhet të therin ata që i bëjnë umren dhe haxhin bashkë. Ky quhet edhe "kurbani i falënderimit" dhe theret brenda tre ditëve të para të Bajramit të Kurbanit në Mina dhe rreth saj. Është më me vlerë therja në ditën e parë të Bajramit. Nga mishi i këtij kurbani mund të hajë i zoti dhe pjesa tjetër t'u shpërndahet të varfërve.

2. Kurbani i therur për shlyerje faji. Personi që ka shkelur njërin prej ndalimeve të haxhit, e ka vaxhib të therë një kurban për dëmshpërblim. Nga mishi i këtij kurbani nuk mund të hanë i zoti, gruaja e tij, prindët, gjyshi dhe gjyshja, fëmijët, nipërit dhe mbesat. Po të hanë, duhet t'u shpërndajnë të varfërve kundërvlerën e sasisë së ngrënë.

3. Kurbani nafile. Është kurbani i therur për hir të Allahut nga personat që bëjnë vetëm haxh ose vetëm umre.

b. Fajet në haxh

Për personat që kanë hyrë nën ihram për haxh ose umre, janë disa veprime të ndaluara që ata nuk duhet t'i kryejnë. Shkelja e këtyre ndalimeve cilësohet si "krim ndaj haxhit" dhe pasohet me një sërë ndëshkimesh.

Këto ndëshkime ndryshojnë sipas cilësisë së shkeljes dhe fajit të bërë. Disa shkelje kërkojnë therjen e një të imte (dele ose dhi), kurse disa të tjera, therjen e një të trashe ose deveje. Për disa faje jepet sadaka. Ndëshkimet jepen të njëjta si për ata që i kanë shkelur ndalimet me qëllim, ashtu dhe për ata që i kanë shkelur për harresë ose pakujdesi.

c. Haxhi me dorëzanës

Thelbësore në adhurimet farz është që ato t'i bëjë personalisht vetë ai që është përgjegjës për to. Është për këtë arsye që adhurime të tilla fizike si namazi dhe agjërimi nuk lejohet të kryhen me dorëzanës ose, e thënë ndryshe, namazi dhe agjërimi me dorëzanës janë të pavlefshëm. Kurse në adhurime pasurore, si zekati dhe haxhi, mund të caktohet dorëzanës. Edhe pse haxhi është një adhurim pjesërisht pasuror, lejohet (është xhaiz) që personi të çojë një dorëzanës duke ia paguar të gjitha shpenzimet.

Dërgimi i një dorëzanësi për haxh nga personi që ka një justifikim për të mos shkuar vetë, quhet **ihxhaxh** (dërgim për haxh). Personi i justifikuar që dërgon dorëzanës, quhet **amir** (urdhërues), kurse dorëzanësi quhet naib (zëvendës, i urdhëruar, i ngarkuar me punë).

Haxhi i bërë me dorëzanës duke i përballuar shpenzimet personi që e ka për detyrë haxhin, ka disa kushte që janë:

a) Amiri duhet të jetë përgjegjës për kryerjen e haxhit, domethënë ta ketë për detyrë shkuarjen në haxh.

b) Ndërkaq, amiri duhet të jetë i paaftë për të shkuar e për të ardhur nga haxhi dhe kjo gjendje për të duhet të ketë filluar para se të caktojë dorëzanës e të jetë e sigurtë se ka për të vazhduar gjer në fund të jetës.

c) Amiri duhet t'ia theksojë dorëzanësit që ta kryejë haxhin në emër të tij (të amirit).

ç) Amiri duhet t'i përballojë vetë të gjitha shpenzimet e haxhit. Por nuk duhet t'i paguajë shpërblim pune dorëzanësit për haxhin.

d) Dorëzanësi, para se të fillojë nga kryerja e punëve të haxhit ose duke hyrë nën ihram, duhet të bëjë qëllim (nijet) për haxh në emër të amirit (për amirin).

e) Dorëzanësi duhet ta kryejë personalisht haxhin në emër të amirit; me fjalë të tjera, dorëzanësi nuk mund të caktojë një dorëzanës tjetër në vend të vet.

f) Dorëzanësi duhet të hyjë nën ihram vetëm në emër të amirit dhe të gjitha detyrat dhe veprimet e haxhit duhet t'i kryejë vetëm në emër të amirit.

g) Dorëzanësi duhet ta kryejë haxhin në vitin e caktuar prej amirit dhe të pranuar prej tij.

h) Amiri me dorëzanësin duhet të jenë të dy myslimanë, me zhvillim mendor normal dhe të aftë për t'i kuptuar detyrat e haxhit.

H. URTËSITË E HAXHIT

Haxhi është një adhurim që e përsos besimin dhe, duke e bërë njeriun ta përjetojë në këtë botë ditën e ringjalljes, bëhet pretekst për zbulimin e të fshehtës së hadithit profetik, "Vdisni para se të keni vdekur!" Haxhi zhvillohet në atmosferën e bekuar dhe madhështore të bashkimit të myslimanëve nga e gjithë bota, ku shfaqet mëshira e Allahut. Haxhi është mundësia për të marrë pjesë nga nënshtrimi dhe dorëzimi i Hz. Ibrahimit dhe Hz. Ismailit si dhe për të goditur me gurë, domethënë për të kundërshtuar dhe përzënë armikun e brendshëm të quajtur nefs, ego, dhe armikun e jashtëm, prirjet tona djallëzore të jashtme.

Haxhi nuk është thjesht një adhurim material. Ai e ka të rëndësishëm anën shpirtërore po aq sa dhe anën materiale. Këtë e tregon fakti se Profeti përdorte për haxhin shprehjen "haxhi mebrur" që do të thotë "haxhi i mirë fund e krye", "haxhi i së mirës së përsosur". Me këtë anë të tij, haxhi është mbushja e zemrave me mëshirë, begati dhe vlera nëpërmjet pendimit, kthimit kah Zoti, lutjeve e premtimeve, është stolisja e jetës me vepra të mira, është premtimi i posaçëm para Allahut se ndryshimet e bëra në haxh do të vazhdojnë edhe pas tij.

Meka është mjedisi, ku zhduken koncepte të tilla si vatani, ngjyra, raca, veshja, etj. dhe shfaqet e vërteta se të gjithë myslimanët janë vëllezër dhe një komb i vetëm.

Medina është qyteti i bekuar, ku kanë jetuar Profeti i dërguar si mëshirë për botët dhe shokët e tij të mirë. Kurse vendi ku prehet Profeti është mjedisi, ku zemra e stolisur me qëndismat e dashurisë hyjnore, fitoi lartësi sublime. Ka katërmbëdhjetë shekuj që dashuria për Profetin dhe bukuria e Islamit i ndriçojnë zemrat. Duhet bërë kujdes që në këtë mjedis ku mëshira hyjnore është derdhur lumë, të qëndrohet vazhdimisht me edukatë dhe dashuri.

Qabeja është synimi, ku orientohet adhurimi i namazit të urdhëruar për t'u zbatuar nga Zoti ynë në Kuran me fjalët **"Bjer në sexhde dhe afrohu!"** Në të njëjtën

kohë, Qabeja është pika, ku drejtohen të gjithë myslimanët e botës, domethënë vendi ku rreh pulsi i botës Islame. Vendi ku shfaqet drita hyjnore te njeriu, është zemra, kurse te gjithësia, Qabeja. Qabeja, pra, është për gjithësinë si zemra për njeriun.

Guri i Zi (haxherul esved) është guri i bekuar që përshëndetet e puthet dhe ku jepet fjala për besnikëri ndaj Allahut. Ta përshëndetësh atë do të thotë, në të njëjtën kohë, të japësh fjalën se do të heqësh dorë nga të gjitha dëshirat egoiste dhe prirjet djallëzore.

Arafati na kujton ngritjen nga varret ditën e Kiametit në mëngjes dhe grumbullimin tufa-tufa në vendin e dhënies së llogarisë. Të gjithë robtë, të dobët, nevojtarë por dhe me shpresë, presin falje para Allahut. Zemrat dhe sytë njomen me lotët e pendimit, lutje e përgjërime të panumërta lartësohen drejt Zotit. Në librat e llogarisë hapen faqe krejt të pastra dhe Zotit i jepet fjala se aty e tutje do të jetohet nën bindje të plotë.

Muzdelife është lartësia nga ku, pas mbrujtjes me shfaqjet hyjnore të madhështisë e fuqisë së Zotit, hidhen pas shpine kjo botë dhe të gjitha interesat materiale.

Minaja është një pozitë dorëzimi dhe nënshtrimi duke marrë për model Hz. Ibrahimin dhe Hz. Ismailin.

Goditja e shejtanit me gurë është mallkim i djallit dhe kthimi kah Zoti me një zemër të pastruar dhe të çliruar nga çdo lloj indiferentizmi dhe lëkundjeje. Dhe kjo punë duhet filluar me goditjen me gurë të shejtanit brenda vetes.

Kodrat Safa dhe Merve, duke na kujtuar vajtje-ardhjet e nënës sonë Haxher për të gjetur ujë, na shtyjnë të strehohemi dhe mbështetemi te Zoti me ndjenjën e qenies së dobët e nevojtare.

Kurbani është një frymëzim mëshire dhe urtësie i cili, duke përjetuar dorëzimin e Ismailit dhe duke u çliruar prej pasurisë, jetës dhe dëshirave egoiste, na kujton t'i dorëzohemi Allahut.

Lexim letrar
Si duhet të veprojmë në haxh?

Personi që ka për të kryer detyrën e haxhit me farzet, vaxhibet, sunnetet dhe etikën e tij, vepron në këtë mënyrë:

Punon dhe fiton me nder dhe hallall. Nëse ka borxhe, i shlyen. Nëse ka adhurime të pakryera, i kryen si të prapambetura, kaza. Bën pendesë për mëkatet dhe i kërkon falje Allahut. E mbron veten prej fjalëve dhe veprimeve të këqija. Kur ka për t'u nisur për në haxh, fal dy rekate namaz, bën lutje dhe mbështetet te Allahu, përshëndetet me familjen, fqinjt dhe miqtë dhe niset.

Kur arrin në njërin prej vendeve të quajtura Mikat, lahet ose merr abdest. Rruan qimet e tepërta dhe pret thonjtë. Nxjerr rrobat dhe mbulohet me dy copa të bardha të pastra. Kokën dhe këmbët i mban zbathur, ose mbath në këmbë sheshje ose nallane. Fal dy rekate namaz për ihram. Pasi bën nijet për të hyrë nën ihram, i lutet Zotit. Për sa kohë që ndodhet nën ihram, ruhet të mos shkelë gjërat e ndaluara nën ihram.

Pas namazit, kur takohet me grupe njerëzish që vijnë e shkojnë, kur ngjitet përpjetë ose zbret tatëpjetë, thotë telbije me zë të lartë. Kur arrin në Mekë, lahet ose merr abdest. Kur hyn në Mekë, shkon menjëherë në Qabe dhe, kur e sheh atë, bën telbije, bën tekbir duke thënë "Allahu Ekber" dhe tehlil duke thënë "La ilahe il'lallah". Këndon salat dhe selam. I drejton lutje Allahut të Lartë. Pastaj, duke u drejtuar nga ana e Gurit të Zi, bën tekbir, e përshëndet Gurin e Zi dhe, po qe e mundur e pa i shqetësuar të tjerët, e puth atë dhe e fërkon me dorë. Pastaj, duke e pasur Qaben në anë të majtë, fillon tavafin kudum jashtë Hatimit gjersa të plotësohen shtatë rrotullime. Gjatë tre rrotullimeve të para bën ecje të shpejtuar që i thonë remel. Në çdo rrotullim, kur vjen para Gurit të Zi, e përshëndet atë.

Pas përfundimit të tavafit, fal dy rekate namaz në një vend të përshtatshëm të Qabes. Pastaj e përshëndet përsëri Gurin e Zi. Kështu, pas plotësimit të tavafit kudum, ngjitet në kodrën Safa për të bërë vajtje-ardh-

jet mes saj dhe kodrës Merve. Kthehet kah Qabeja dhe bën tekbir dhe tehlil, këndon salat dhe selam. Pastaj niset për në kodrën Merve. Mes dy shtyllave (dritave) jeshile, e bën rrugën me vrap. Në çdo vajtje-ardhje bën telbije, i drejton lutje Allahut të Lartë.

Në ditën e tetë të dhilhixhes e fal namazin e agimit në Mekë duke vazhduar të jetë nën ihram dhe pastaj ngjitet në Mina ku qëndron gjer në faljen e namazit të agimit të ditës arife. Pastaj shkon në Arafat. Atë ditë, pas perëndimit të diellit, shkon nga Arafati në Muzdelife ku e kalon natën. Namazin e mbrëmjes e fal me xhemaat në Muzdelife duke e bashkuar me namazin e jacisë. Pastaj shkon në vendin e quajtur "Mesh'arul Haram" të Muzdelifes ku qëndron pak. Gjatë vajtjes në të gjitha këto vende, bën telbije.

Kur zbardh ndërsa ai ndodhet në Mesh'arul Haram, sheh kah Minaja ende pa lindur dielli dhe nis të ecë drejt saj në heshtje. Në Mina hedh shtatë gurë të vegjël në shtyllën e quajtur Akabe. Gurët i hedh duke i kapur me gishtin e madh dhe gishtin e dëshmisë së dorës së djathtë. Pas hedhjes së secilit, bën tekbir. Pasi i hedh gurët, nuk pret më aty. Pastaj, po deshi, ther kurban, pastaj qeth ose shkurton flokët.

Pasi i kryen të gjitha këto, për të ngrihen të gjitha ndalimet e ihramit veç marrëdhënieve seksuale me të shoqen.

Pas kësaj, po atë ditë, zbret në Mekë dhe bën tavafin e vizitës, pas të cilit fal dy rekate namaz. Tashmë, pas tavafit të vizitës që është farz, për të ngrihen të gjitha ndalimet e haxhit.

Pas tavafit të vizitës, shkon përsëri në Mina ku rri tri ditë për të bërë goditje me gurë. Ditën e dytë të Bajramit, pas kohës së mesditës, hedh nga shtatë gurë në shtyllën e parë që ndodhet në afërsi të "Mesxhidul Hajf" dhe në shtyllën e mesme. Në çdo hedhje guri bën tekbir. Tek secila shtyllë pret dhe ndërkohë bën lutje për prindërit dhe vëllezërit e tij të fesë. Pastaj hedh shtatë gurë edhe në shtyllën e fundit por aty nuk pret për të bërë lutje.

Këtë goditje gurësh e bën edhe në ditën e tretë të Bajramit pas kohës së mesditës. Nëse në Mina e gjen dita e katërt e Bajramit, edhe atë ditë e përsërit goditjen me gurë. Pastaj kthehet sërish në Mekë dhe shkon në Qabe. Bën tavafin e lamtumirës dhe fal dy rekate namaz. Pastaj shkon te burimi

Zemzem ku rri përballë Qabes dhe pi ujë. Me këtë ujë lan kokën dhe fytyrën. Po qe e mundur, hedh edhe mbi trup. Pas pirjes së ujit bën lutje.

Pasi pi ujin e Zemzemit, po qe e mundur, hyn brenda në Qabe dhe fal dy rekate namaz. Mbështet fytyrën në mur, e falënderon Allahun dhe kërkon prej Tij falje. Me edukatë të thellë, afrohet te mbulesa e Qabes, mbështetet te ajo dhe lutet. Nëse nuk do të rrijë në Mekë, tërhiqet pas pa i larguar sytë prej Qabes dhe largohet prej saj. Personi kthehet në vendin e vet kur të dojë.

Edhe gratë veprojnë si burrat. Vetëm se gratë nuk i heqin rrobat, nuk e zbulojnë kokën dhe nuk rrinë me këmbët zbathur, në telbije nuk e ngrenë zërin, mes Safasë dhe Mervesë nuk vrapojnë. Për të dalë nga ihrami, gratë i presin pak majat e flokëve. Nuk futen mes meshkujve për të përshëndetur Gurin e Zi.

PËRMBLEDHJE

1. Bëni përkufizimin e haxhit.
2. Thoni argumentet e farzit të haxhit.
3. Tregoni urtësinë dhe dobitë e haxhit.
4. Ç'do të thotë ihram, telbije, tavaf dhe vakfe? Shpjegojini shkurt.
5. Tregoni llojet e haxhit sipas konkluzionit mbi të.
6. Tregoni llojet e haxhit sipas përbërjes së tij.
7. Cilat janë shtyllat e haxhit?
8. Cilat janë kushtet e kryerjes së haxhit?
9. Tregoni se për kë është farz haxhi.
10. Tregoni vaxhibet e haxhit që dini.
11. Tregoni sunnetet e haxhit që dini.
12. Cili është kuptimi dhe konkluzioni mbi umren? Kur bëhet um re? Jepni njohuri të shkurtra.
13. Cila është përbërja e hedjit dhe konkluzioni mbi të?
14. Thoni kushtet e haxhit të bërë me dorëzanës.

PJESA V
KURBANI DHE GJUETIA

ÇËSHTJET

1. Përkufizimi dhe rëndësia e kurbanit
2. Personat që e kanë vaxhib kurbanin
3. Kafshet që bëhen kurban
4. Koha dhe therja e kurbanit
5. Kurbani i kushtëzuar (nezir) dhe kurbani i flokëve (akika)
6. Kafshët që u hahet dhe s'u hahet mishi
7. Natyra dhe kushtet e gjuetisë

PUNË PËRGATITORE

1. Diskutoni mbi dobitë e kurbanit për ndihmën reciproke.
2. Thoni ç'dini mbi historinë e kurbanit.
3. Merrni njohuri mbi cilësitë e kafshëve që do të bëhen kurban.
4. Ç'do të thotë kurban i kushtimit? Ç'ndryshime ka mes kurbanit që theret në Bajramin e kurbanit dhe kurbanit të kushtimit?
5. Merrni njohuri mbi kafshët, të cilave u hahet dhe s'u hahet mishi.
6. A e dini si theret kurbani? Ç'keni vëzhguar duke u therur kurban?
7. Ç'kuptim dhe qëllim kanë ndalimet e herëpashershme të gjuetisë së disa kafshëve?

A. PËRKUFIZIMI DHE RËNDËSIA E KURBANIT

a. Përkufizimi i kurbanit

Kuptimi leksikor i fjalës *kurban* është *afrim*. Kurse si term i së drejtës Islame, kurbani është "kafsha që theret në një kohë të caktuar (në datat 10, 11, 12 të muajit dhilhixhe të kalendarit hënor) me qëllim adhurimi për t'iu afruar mëshirës së Allahut të Lartë dhe që bart cilësitë e kurbanit". Në arabisht emërtohet *ud'hijje*.

b. Rëndësia dhe dobitë e kurbanit

Kurbani është një falënderim për të mirat e dhëna nga Allahu i Lartë, është mjet afrimi ndaj Tij, është ndërmjetës për arritjen e mëshirës dhe faljes së Tij. Profeti ynë i dashur (a.s.) është shprehur kështu për therjen e kurbanit: *"Njeriu nuk i është afruar Allahut me një veprim më të kënaqshëm se derdhja e gjakut ditën e Bajramit të Kurbanit. Ende pa rënë në tokë gjaku i derdhur, njeriu që ther kurban është ngjitur në një pozitë të lartë pranë Allahut! Prandaj therini kurbanët me gjithë zemër!"*[23]

Kurbani ka shumë urtësi dhe dobi. Disa prej këtyre mund t'i radhisim kështu:

* Me therjen e kurbanit njeriu fiton sevap, sepse kurbani është adhurim.

* Kurbani e orienton njeriun të bëjë sakrificë materiale në rrugë të Allahut.

* Kurbani forcon ndjenjat e ndihmës së dyanshme midis njerëzve dhe siguron ndihmën për të varfrit.

* Ushqimi është nevojë e trupit të njeriut. Kurbani bëhet pretekst për plotësimin sado të paktë të nevojave ushqimore të njerëzve.

* Duke ua dhënë institucioneve të bamirësisë lëkurën dhe të brendshmet e kurbanit, ndihmohen dhe mbështeten ato në veprimtarinë e tyre mirëbërëse.

* Në ditët e tjera të vitit, shitblerja e kafshëve bëhet prej personave dhe institucioneve të caktuara, kurse në shitblerjen e kafshëve për kurban merr pjesë pjesa më e madhe e popullsisë, tregu gjallërohet shumë. Njerëzit që merren me ushqimin dhe rritjen e kafshëve për kurban, sigurojnë jetesën e tyre.

23 Imam Malik, el-Muvetta, Kitabu'l-Kurban, 24.

c. Vendi i kurbanit në fenë tonë

Therja e kurbanit për pëlqim të Allahut ka filluar në kohë të Hz. Ibrahimit (a.s.). Këtë çështje, Allahu e shpreh kështu në Kuran:

وَفَدَيْنَاهُ بِذِبْحٍ عَظِيمٍ

"Ne e shpaguam atë (Ibrahimin) **me një kurban të madh."**[24]

Therja e kurbanit është urdhër i Zotit. Këtë e thekson ajeti si më poshtë:

فَصَلِّ لِرَبِّكَ وَانْحَرْ.

"Fal namaz për hir të Zotit tënd dhe flijo (ther kurban) **për Të!"**[25]

Edhe në një ajet tjetër, Zoti urdhëron:

"Ne edhe kafshët e trasha i bëmë për ju ndër shenjat (kurbanet) **e** (fesë së) **Allahut. Në to ka bekim për ju. Atëherë, kujtojeni emrin e Allahut kur ato janë në këmbë** (para se të theren) **dhe, kur të bien në tokë** (pasi të jenë therur)**, edhe vetë hani nga mishi i tyre, edhe jepuni të hanë atyre që e fshehin dhe atyre që s'e fshehin nevojshmërinë e tyre. Këto kafshë jua dhamë juve që të përfitoni prej tyre e të falënderoni. Te Allahu nuk arrijnë as gjaku, as mishi i tyre, vetëm devocioni juaj arrin. Ta dini se Allahu që ju drejton në rrugë të drejtë, është i madh, pra, ta falënderoni Atë! Dhe përgëzoji ata që veprojnë mirë!"**[26]

Me hadithin në vijim, Profeti (a.s.), edhe ka porositur të theret kurban, edhe ka treguar se ky adhurim bëhet qysh në kohën e Hz. Ibrahimit: *"Therni kurban! Pa dyshim, ky është sunneti i atit tuaj, Ibrahimit!"*[27]

Të gjitha këto janë argumente se kurbani ka në fenë tonë një vend të rëndësishëm.

d. Konkluzioni mbi kurbanin

فَصَلِّ لِرَبِّكَ وَانْحَرْ.

24 Kurani, Es-Saffat: 107.

25 Kurani, El-Keuther: 2.

26 Kurani, El-Haxh: 36-37.

27 Sünen Ibn Mace.

Në Kuran, ajeti në vijim tregon sheshit se therja kurban është urdhër i Allahut: **"Ne e urdhëruam çdo bashkësi të therë kurban nga kafshët** (e përshtatshme për kurban) **që ua dhamë si pjesë e të mirave në mënyrë që ta përmendin emrin e Allahut!"**[28]

Personi i cili nuk ther kurban brenda tre ditëve të para të Bajramit të Kurbanit megjithëse ka mundësi për këtë, bëhet mëkatar. Nga borxhi i kurbanit të patherur ai nuk shpëton dot edhe sikur të bjerë më pas në gjendje të vështirë ekonomike.

B. PERSONAT QË E KANË VAXHIB KURBANIN

Therja e kurbanit në Bajramin e kurbanit me qëlim adhurimi është vaxhib (domosdoshmëri) për personin që plotëson këto kushte:

a) Është mysliman.

b) Ka zhvillim mendor normal.

c) Ka mbushur moshën e pubertetit.

d) Është i lirë.

e) Është vendas (nuk është udhëtar).

f) Të zotërojë, përveç gjërave që janë nevoja themelore, pasurinë minimale të quajtur nisab, e cila mund ose mund të mos jetë e vetështueshme. Nisabi i kurbanit është i njëjtë me nisabin e fitrit. Për rrjedhojë, personi që e ka vaxhib të japë sadakanë e fitrit, e ka vaxhib edhe të therë kurban. Dallimi i nisabit të kurbanit nga nisabi i zekatit është se mallrat që nuk ngarkohen me zekat, përfshihen në nisabin e kurbanit.

C. KAFSHËT QË BËHEN KURBAN

Kurban bëhen vetëm kafshët e imta dhe të trasha pavarësisht nga seksi.

Lloji dhe mosha e kafshëve që bëhen kurban si dhe sa vetë mund ta therin:

Dash, dele, cjap, dhi	1 vjeç	1 vetë
Ka, lopë, viç, buall, buallicë	2 vjeç	7 vetë
Deve	5 vjeç	7 vetë

28 Kurani, El-Haxh: 34.

Kurban mund të bëhen edhe qengjat gjashtëmuajsh të rritur në përmasat e qengjave motakë.

Më e shumta shtatë vetë mund të bëhen bashkë e të therin për kurban një deve ose një kafshë të trashë. Ndërkaq, që të shtatë duhet të jenë myslimanë, secili të ketë paguar pjesën e vet dhe secili të marrë pjesë në këtë therje me nijet kurbani dhe për pëlqim të Allahut.

Të metat që nuk janë pengesë për trajtimin e kafshës si kurban:

* Mund të bëhen kurban kafshët me vesh të vrimuar, me cepin e veshit të prerë, me vesh gjysmë të prerë, me dhëmbë pjesërisht të rënë, pa organ seksual ose me organ seksual të atrofizuar.

* Mund të bëhen kurban edhe kafshët çakërr, të çala, të plogështa, të marra, me brirë ose pa brirë që në lindje, me brirë pak të thyer.

Të metat që janë pengesë për trajtimin e kafshës si kurban:

* Nuk mund të bëhen kurban kafshët me një apo të dy sytë qorr, me shumicën e dhëmbëve të rëna, me njërin apo të dy brirët të thyer në rrënjë, me pjesën më të madhe të veshit ose bishtit të prerë, pa vesh ose pa bisht që në lindje.

* Nuk mund të bëhen kurban kafshët me thithkën e gjirit të këputur, shumë të dobëta, të sëmura sa të mos mund të qëndrojnë në këmbë ose të hedhin disa hapa, të çala sa të mos mundin të ecin.

D. KOHA DHE THERJA E KURBANIT

a. Koha e therjes së kurbanit

Therja e kurbanit bëhet vaxhib në ditën e parë të Bajramit të Kurbanit duke filluar që pas faljes së namazit të Bajramit dhe përfundon në perëndim të diellit të ditës së tretë të Bajramit të Kurbanit.

Nëse personi, i cili gjer në këtë kohë nuk i ka pasë plotësuar kushtet e duhura për ta pasur vaxhib therjen e kurbanit, i plotëson brenda kësaj kohe, për të therja e kurbanit bëhet vaxhib. Për shembull, nëse personi i cili i plotëson të gjitha kushtet e tjera përkatëse, por jo kushtin që të jetë vendës për shkak se ndodhet në udhëtim, arrin brenda kësaj kohe në shtëpi, ngarkohet me përgjegjësinë e therjes së kurbanit.

Kurbani duhet të theret brenda tri ditëve të para të Bajramit të Kurbanit (10, 11,

12 dhilhixhe sipas kalendarit hënor). Kurbani i mbetur pa therur brenda kësaj kohe, mbetet të theret kaza. Ndërkaq, therja e kurbanit në ditën e parë të Bajramit është më me vlerë.

b. Forma e therjes së kurbanit dhe lutjet e kurbanit

Shtylla apo elementi themelor i kurbanit vaxhib është derdhja e gjakut të kafshës. Nëse kafsha vritet pa iu derdhur gjaku, nuk quhet kurban.

Kafsha që do të bëhet kurban, sillet në vendin e therjes pa e munduar, shtrihet në anë të majtë përballë kibles, i lidhen tri këmbë duke ia lënë të lirë këmbën e prapme të djathtë. pastaj këndohet ajeti:

قُلْ إِنَّ صَلاَتِى وَنُسُكِى وَمَحْيَاىَ وَمَمَاتِى لِلَّهِ رَبِّ الْعَالَمِينَ.

"...Pa dyshim, namazi im, kurbani im, jeta dhe vdekja ime janë për Allahun, Zotin tim!"[29]

Duke thënë "Bismil'lahi Allahu Ekber", kafsha theret me thikë në grykë duke ia

29 Kurani, El-En'am: 162.

prerë kanalet e ushqimit, të frymës dhe enët e gjakut. Kafshës nuk i ndahet koka nga trungu pa dhënë shpirt plotësisht.

Po pati mundësi, kurbanin duhet ta therë vetë personi që i përket dhe duke filluar me Besmele. Po s'pati mundësi vetë, duhet të ngarkojë një mysliman tjetër për ta therur, kurse vetë duhet të ndodhet aty dhe të marrë pjesë në lutje duke bërë Besmele.

Nëse therja bëhet duke e lënë Besmelenë me qëllim, mishi i asaj kafshe nuk hahet. Por nëse Besmeleja lihet pa u thënë për harresë, mishi i atij kurbani mund të hahet.

Personi ateist ose politeist nuk mund të therë kurban. Edhe ngarkimi i një hebreu ose krishteri për ta therur kurbanin është mekruh. Por nëse hebreu ose krishteri e ther kurbanin duke përmendur emrin e Allahut, mishi i atij kurbani hahet.

c. Veprimet lidhur me mishin dhe lëkurën e kurbanit

Nga mishi i kurbanit vaxhib të therur në Bajramin e kurbanit mund të hanë personi nën përgjegjësi që e ther dhe njerëzit e shtëpisë. Në përgjithësi, mishi i kurbanit ndahet në tri pjesë. Një pjesë u ndahet të varfërve, një pjesë, të afërmve, miqve e shokëve dhe pjesa tjetër lihet në shtëpi. Personi që ther kurban megjithëse nuk është në gjendje të mirë ekonomike, e mban tërë mishin në shtëpi.

Lëkura e kurbanit u dhurohet si sadaka personave që u jepet zekat. Lëkura e kurbanit u dhurohet veçanërisht institucioneve dhe shërbimeve të tilla, si: xhamitë, shkollat, rrugët, urat, uji, institucioneve dhe fondacioneve të bamirësisë që zhvillojnë aktivitet në përputhje me Islamin. Nuk është e lejueshme (xhaiz) që lëkura t'u dhurohet personave ose institucioneve që zhvillojnë veprimtari në kundërshtim me fenë ose veprimtari të ndaluara ose të pabekuara (haram).

Personi që ther kurban mund ta mbajë vetë lëkurën për ta përdorur si postiqe, tullumb, etj.

Lexim letrar

Ç'mbeti pas?

Familja e Profetit (a.s.) kishte therur një dele. Nga gjithë mishi i deles që u ishte ndarë të varfërve, kishte mbetur vetëm kocka e shpatullës. Një çast, Profeti pyeti:

"Ç'mbeti nga mishi i deles?"

"Vetëm një kockë shpatulle mbeti" - iu përgjigj Hz. Aisheja.

Atëherë, Profeti, duke e pasur fjalën për sevapin në jetën tjetër, tha:

"Pse s'thua që na paska mbetur i gjithë mishi veç kockës së shpatullës?"

E. KURBANI I PËRKUSHTUAR (NEDHR) DHE KURBANI I FLOKËVE (AKIKA)

Kuptimi leksikor i fjalës nedhr do të thotë *vetëngarkim me përgjegjësi, parapërgatitje*. Kurse si term i së drejtës Islame, nedhri është "vetëngarkimi me përgjegjësi i një personi që i plotëson kushtet e caktuara, me një adhurim me qëllim madhërimin e Allahut". Për shembull, një person thotë: "Po të më realizohet kjo gjë, do të ther një kurban për pëlqim të Allahut!" Me këtë premtim të përkushtuar, personi e vë veten nën përgjegjësinë e therjes së një kurbani nëse i realizohet gjëja që ka vënë si kusht. Por një person mund të premtojë të therë një kurban për pëlqim të Allahut pa vënë ndonjë kusht, vetëm për adhurim.

Kurbani *nedhr* është kurbani i premtuar nga një person për pëlqim të Allahut me një kusht të caktuar ose pa vënë asnjë kusht. Për shembull, një person premton: "Nëse djali e mbaron shkollën me rezultate të shkëlqyera, do të ther një kurban!" Personi është i detyruar ta therë kurbanin nëse i plotësohet kushti që ka vënë. Një person tjetër mund të premtojë të therë kurban kështu: "Për pëlqim të Allahut, do të ther një dash për kurban!" Edhe ky është një kurban nedhr pa vënë ndonjë kusht për therjen e tij.

a. Konkluzioni mbi kurbanin e përkushtuar

Personi që ka bërë një kushtim, e ka ngarkuar veten me përgjegjësinë e zbatimit të kushtimit të bërë. Zbatimi i kushtimit të bërë është vaxhib. Allahu i Lartë ka urdhëruar: **"...** (Besimtarët) **t'i sjellin në vend premtimet..."**[30]

Therja e kurbanit të kushtuar me kusht bëhet vaxhib kur realizohet kushti i vënë. Po s'u ther në kohë, theret i prapambetur (kaza). Kurse kurbani i kushtuar pa kusht mund të theret në një kohë të përshtatshme. Personi që nuk e çon në vend kushtimin apo premtimin, bëhet mëkatar.

b. Kushtet e vlefshmërisë së kurbanit të përkushtuar

1. Shkaku që merret si shtytje për të bërë premtimin për të therur një kurban me një përkushtim të caktuar, duhet të jetë i vlefshëm fetarisht dhe i realizueshëm. Përkushtimi i bërë për një gjë të parealizueshme është i pavlefshëm. Për shembull, përkushtimi "do të ther kurban po të shkoj në hënë sa hap e mbyll sytë" është i pavlefshëm.

2. Përkushtimi duhet të jetë një gjë ose një punë e mirë, e bekuar dhe e dobishme (hallall). Nuk është i lejueshëm (xhaiz) dhe i vlefshëm përkushtimi mbi gjëra të këqija, të pabekuara, të dëmshme e të ndaluara (haram). Për shembull, përkushtimi "do të ther kurban po të arrij të vjedh sot" është i bërë mbi një gjë haram dhe është i pavlefshëm. Përkushtime të tilla nuk çohen në vend. Në lidhje me këtë, Profeti ynë (a.s.) ka porositur: *"Askush që premton ta kundërshtojë Allahun, të mos e çojë në vend premtimin e tij!"*[31]

3. Gjëja për të cilën bëhet përkushtim, duhet të jetë një adhurim i llojit farz ose vaxhib, si mbajtja e agjërimit, therja e kurbanit, etj. Veç këtyre, të përshtatshme janë edhe gjëra të tilla si vizita e një të sëmuri, dhënia e dorës për pajtim, hyrja në xhami, këndimi i ezanit.

c. Kushtet e kurbanit të përkushtuar

1. Kafsha që do të theret për përkushtim duhet të plotësojë cilësitë dhe kushtet që kërkohen për kurbanin vaxhib dhe duhet të jetë nga lloji i kafshëve për kurban.

2. Kurbani i përkushtuar nuk duhet të jetë po ai kurbani, therja e të cilit për personin është vaxhib.

30 Kurani, El-Haxh: 29.

31 Sahihu'l-Buhari, Kitabu'l-Ejman, 28.

3. Kurbani i përkushtuar duhet të jetë në përshtatje me gjendjen ekonomike të personit që e bën. Personi nuk duhet të përkushtojë një kurban jashtë mundësive të tij.

4. Personi nuk duhet të përkushtojë therjen e një kurbani i mbështetur në shpresën e ndihmës materiale ose të pagesës nga ana e personave të tjerë.

d. Llojet e kurbanit të përkushtuar



1. Përkushtimi sipas kohës

Përkushtimi me kohën të përcaktuar: është përkushtimi me kohën e kryerjes të caktuar. Për shembull: "Në ditën e parë të muajit shkurt do të ther kurban për pëlqim të Allahut!"

Përkushtimi me kohën të papërcaktuar: është përkushtimi me kohën e kryerjes të pacaktuar. Për shembull: "Premtoj të ther një kurban për pëlqim të Allahut!"

2. Përkushtimi sipas kushteve

Përkushtimi i kushtëzuar (relativ): është përkushtimi, zbatimi i të cilit është kushtëzuar me realizimin e një kërkese apo dëshire të caktuar. Për shembull: "Do të ther kurban nëqoftë se do ta kaloj klasën me të parën!"

Përkushtimi i pakushtëzuar (absolut): është përkushtimi i pakushtëzuar. Për shembull: "Premtoj se do të ther një kurban për pëlqim të Allahut!"

Dallimi mes përkushtimit absolut dhe atij me kohë të caktuar është se përkushtimi absolut nuk e ka kohën e kryerjes të caktuar kurse përkushtimi me kohë të caktuar e ka kohën e kryerjes të caktuar.

Dallimi mes përkushtimit absolut dhe atij me kohë të pacaktuar është se përkushtimi me kohë të pacaktuar e ka të pacaktuar kohën se kur do të kryhet, kurse përkushtimi absolut e ka mundësisht të caktuar kohën se kur do të kryhet.

e. Konkluzione mbi mishin e kurbanit të kushtëzuar

Nga mishi i kurbanit të përkushtuar nuk mund të hanë personi që e ther, e shoqja, i ati, e ëma, gjyshi, gjyshja, fëmijët, nipërit e mbesat. Po të hanë, duhet t'ua shpërndajnë të varfërve kundërvlerën e mishit të ngrënë.

Lëkura dhe të brendshmet e kurbanit të përkushtimit, ashtu si lëkura dhe të brendshmet e kurbaneve të tjerë, mund t'u jepet të varfërve ose institucioneve dhe fondacioneve të mirëbërësisë. Lëkura e tij mund të përdoret edhe si plaçkë shtëpie. Vetëm se në këto raste u duhet dhënë të varfërve kundërvlera e saj.

f. Kurbani i flokëve

Në origjinal përdoret fjala akika me të cilën emërtohen flokët e fëmijës së porsalindur. Si term, do të thotë *kurban i therur për pëlqim të Allahut dhe në shenjë falënderimi ndaj Tij për fëmijën e lindur.*

Therja e kurbanit të flokëve është sunnet.

Kurbani i flokëve mund të theret qysh nga dita e parë kur lind fëmija e gjer sa të arrijë moshën e pubertetit. Por therja ditën e shtatë të lindjes është më e vlefshme. Këtë ditë theret kurban, i vihet emri fëmijës dhe i qethen flokët. Shpërndahet si sadaka ar ose argjend i barabartë me peshën e flokëve të fëmijës.

Kafsha e përshtatshme për kurbanin vaxhib është e përshtatshme edhe për kurbanin e flokëve.

Nga mishi i kurbanit të flokëve mund të hanë ai që e ther si dhe të afërmit. Mishi mund të shpërndahet si sadaka. Lëkura mund të përdoret në shtëpi ose të jepet si sadaka.

Është parë me vend që mishi i kurbanit të flokëve të zhvishet nga kockat pa i thyer dhe prerë ato.

Lexim letrar
Kurbani

Pasi i kishte vendosur të birin Ismail dhe të shoqen Haxher në Mekë, profeti Ibrahim qe kthyer prapë në tokat e veta.

Ndërkaq, profeti Ibrahim kthehej herë pas here në Mekë për t'i parë të birin dhe nënën e tij e për të mbledhur së bashku dru në male e gjë për të ngrënë.

Ishte një ditë kur profeti Ibrahim ndodhej përsëri në Mekë. Ishte koha pas mesnate. Ai po flinte. Në ëndërr, një zë po i thoshte kështu:

"O Ibrahim, Allahu të kërkon ta bësh kurban tët bir Ismail!"

Kjo ishte me të vërtetë një provë miqësie. Miku duhet ta bënte fli çdo gjë për mikun. Allahu e pati zgjedhur Ibrahimin halil, mik të tijin. Dhe tani donte ta provonte nëse ishte i denjë për këtë miqësi. Prandaj donte që Ibrahimi ta bënte kurban për këtë miqësi qenien më të dashur!

Por ishte tejet e vështirë që njeriu ta mohonte qenien e njeriut më të dashur për të!

Prandaj Allahu nuk ia pati dhënë Ibrahimit urdhrin drejtpëdrejt, por e kishte mësuar ta pranonte dalëngadalë me anë të ëndrrës së përsëritur për tri net rrjesht.

Atë ditë Ibrahimi i tha të birit që të merrte me vete një thikë dhe një litar se do të dilnin për dru. Kjo ishte një gjë e zakonshme për ta. Ismaili nuk dyshoi për gjë. Dhe u vunë për udhë të dy duke pasur me vete thikë, sëpatë e litar. Kur arritën në zonën e Minasë, profeti Ibrahim nisi t'ia tregonte të birit ëndrrën e parë pjesë-pjesë. Ai ia bëri të ditur djalit se Allahu po e vinte para një prove të madhe!

Te Ismaili nuk u vu re as dhe mërzitja, lëkundja dhe shqetësimi më i vogël.

A nuk ishte Allahu që jepte jetën? Tani, Allahu, Zoti i jetës, i kërkonte atij t'ia kthente prapë jetën që i kishte dhënë! A mund të përfytyrohej një vdekje më e nderuar se kjo? Duke i menduar këto, Ismaili ndihej krejtësisht i nënshtruar dhe dorëzuar Zotit. Ai iu përgjigj kështu të atit:

"O im atë! Bëj ashtu siç urdhërohesh! Dashtë Zoti më sheh mua durimtar!.."

Profetin Ibrahim edhe e gëzoi përgjigjja e djalit, edhe e preku. Sytë iu njomën. Me një dashuri të madhe po shihte nga i biri që po shfaqte një besim të tillë kaq të lartë! Ai po krenohej që kishte një bir të tillë!

Profeti Ibrahim e shtriu të birin në krah të djathtë dhe u përgatit të zbatonte urdhrin e Allahut. Ia lidhi që më parë sytë të birit që të mos e shihte thikën. Kjo ngjarje zhvillohej në Mina në afërsi të vendit ku sot theren kurbanët e haxhit.

Duke u bërë gati t'ia vinte djalit thikën në grykë, profeti Ibrahim përmendi emrin e Zotit dhe tha: "O Zot, ja tek po e çoj në vend urdhrin tënd!"

Por thika nuk preu!

Qëllimi i Allahut nuk qe flijimi i Ismailit. Me këtë ngjarje Ai donte t'u tregonte engjëjve dhe gjithë njerëzimit besnikërinë dhe durimin e familjes së Ibrahimit!

Kjo ishte një provë miqësie dhe besnikërie. Miku i Allahut, Ibrahimi, dhe i biri Ismaili kishin vërtetuar se mund t'i flijonin për Allahun me dëshirë gjërat më të çmuara të tyre: Ibrahimi të birin, kurse Ismaili, jetën e vet! Ata e kishin treguar pa u lëkundur besnikërinë ndaj Allahut. Shkurt, ata e kishin fituar në mënyrën më të bukur këtë provë të jashtëzakonshme!

Ndërsa profeti Ibrahim po bëhej gati ta shkonte edhe një herë tjetër thikën në grykë të të birit, u dëgjua një zë:

"O Ibrahim! E provove se je një rob besnik. U tregove të gjithëve se je mik i Allahut! Qëndro! S'është nevoja ta bësh kurban Ismailin!"

Profeti Ibrahim qëndroi. Pa përreth dhe dalloi që nga qielli po zbriste Hz. Xhebraili me një dash me brirë e me sy të lyer për dore. Xhebraili (a.s.) po e uronte profetin Ibrahim:

"O Ibrahim! Ky dash ka dyzet vjet që ushqehet në xhennet. Tani po dërgohet në tokë që ta bësh kurban në vend të djalit tënd!.."

Me një gëzim të papërshkruar, profeti Ibrahim ia zgjidhi sytë të birit, e mori dashin nga duart e Xhebrailit dhe e theri. Pastaj fali një namaz falënderimi për favorin e madh të Zotit.

Qysh prej asaj dite, të gjithë myslimanët, për të festuar shpëtimin e Hz. Ismailit dhe për të shlyer borxhet e falënderimit ndaj Allahut, therin kurban çdo vit në të njëjtën ditë. Therja e kurbanit është vaxhib për myslimanët që kanë mundësi për të.

G. KAFSHËT, TË CILAVE U HAHET DHE NUK U HAHET MISHI

a. Veçoritë e kafshëve, të cilave u hahet dhe s'u hahet mishi dhe pikëpamjet e imamëve të shkollave juridike-fetare mbi to

Sipas shkollës hanefite:

1. Kafshët, të cilave u hahet mishi dhe veçoritë e tyre

a) Kafshët që nuk kanë natyrë të egër dhe të neveritshme janë hallall. Ndër këto janë: pula, pata, rosa, gjirafa, struci, shkurta, pëllumbi, delja, dhia, deveja, lopa, buallica, palloi. Në këtë grup futen veçanërisht dallëndyshja, lepuri, trumcaku, bilbili, kumria, shtura, laraska, thëllëza.

b) Është hallall çdo lloj peshku që jeton vazhdimisht në ujë pa dalë në tokë.

2. Kafshët, të cilave nuk u hahet mishi dhe veçoritë e tyre

a) Është haram mishi i kafshëve që gjuajnë dhe shqyejnë me dhëmballë, si ujku, ariu, luani, tigri, leopardi, qelbësi, majmuni, hiena, elefanti, qeni, macja dhe dhelpra, etj.

b) Është haram mishi i shpendëve grabitqarë që gjuajnë dhe shqyejnë me kthetra, si qifti, shqiponja, huta, fajkoi, korbi, laraska e zezë, lakuriqi i natës, skifteri, etj.

c) Është haram mishi i kafshëve me natyrë të neveritshme, si miu, akrepi, gjarpri, morri, pleshti, kastori, grenxa, miza e zezë, mushkonja, mola, iriqi, derri, etj.

d) Është haram edhe mishi i mushkës dhe gomarit të butë.

e) Është haram mishi i të gjitha kafshëve të detit që nuk futen në llojin i peshqve, si gaforja, midhjet, aragosta, meduza, etj. Veçanërisht nuk hahen peshqit e ngordhur vetvetiu në det.

f) Janë haram edhe kafshët e therura me qëllim pa besmele, kafshët e ngordhura vetvetiu pa iu prerë koka (pa u therur), kafshët e ngordhura ose të ngordhura duke rënë nga një lartësi, duke u përplasur, duke u zënë brirë më brirë, duke u shpuar ose duke iu këputur koka.

g) Nuk hahet mishi i therur nga adhuruesit e zjarrit, idhujtarët, politeistët dhe ateistët.

h) Është haram ngrënia e mishit të kafshëve që jetojnë edhe në ujë, edhe në tokë, si bretkoca.

3. Kafshët që është mekruh t'u hahet mishi

a) Kali, pela.

b) Çafkëlorja (lauresha me lafshë). Veçanërisht, sipas disa dijetarëve, edhe ngrënia e disa kafshëve si bilbili, korbi, dhe kumria është parë si mekruh.

Pikëpamjet e ndryshme të tre shkollave të tjera janë kështu:

1. Shkolla shafiite

Në dallim nga shkolla hanefite, e ka pranuar si hallall ngrënien e mishit të kalit, dhelprës, iriqit dhe të të gjitha kafshëve të detit.

Kurse mishin e dallëndyshes, palloit dhe çafkëlores e ka quajtur haram.

2. Shkolla malikite

Dallimi i kësaj shkolle nga hanefitët është ky: Kafshë të tilla brejtëse dhe grabitqare si iriqi, brejtësit e nëntokës, skifteri dhe fajkoi janë hallall.

3. Shkolla hanbelite

Në dallim nga shkolla hanefite, mishin e iriqit e quan hallall.

b. Ajetet mbi këtë çështje

Në lidhje me kafshët, mishi i të cilëve është hallall ose haram, në Kuran thuhet:

قُلْ لآ أَجِدُ فِى مَآأُوحِىَ إِلَىَّ مُحَرَّمًا عَلَى طَاعِمٍ يَطْعَمُهُ إِلاَّ أَنْ يَكُونَ مَيْتَةً أَوْ دَمًا مَسْفُوحًا أَوْ لَحْمَ خِنْزِيرٍ فَإِنَّهُ رِجْسٌ أَوْ فِسْقًا أُهِلَّ لِغَيْرِاللهِ بِهِ.....

"Thuaj: ... nuk shoh të jetë bërë haram ndonjë gjë tjetër veç kërmave ose gjakut të derdhur ose mishit të derrit ose ndonjë kafshe të therur në emër të dikujt tjetër veç Allahut..."[32]

32 Kurani, El-En'am: 145.

"Janë bënë haram për ju kërmat, gjaku, mishi i derrit, mishi i therur në emër të tjetërkujt veç Allahut, kafsha e mbytur, kafsha e vrarë (me gur, dru ose me një gjë tjetër të ngjashme), **kafsha e vrarë nga rrëzimi prej një vendi të lartë, kafsha e vrarë nga brirët e një kafshe tjetër, kafsha e prerë nga një kafshë e egër veç asaj që e keni arritur gjallë dhe e keni therur, si dhe kafshët e therura kushtuar idhujve."**[33]

"Të pyesin ty, se cilat gjëra janë bërë hallall për ta. Thuaju: "Të gjitha gjërat e mira e të pastra janë bërë hallall për ju. Hani edhe nga mishi i kafshëve të gjuajtura për ju nga kafshët e gjahut që ju i mësuat nga mësimet që ju dha Allahu juve dhe përmendeni emrin e Allahut (bëni besmele) **mbi to. Dhe kini frikë Allahun se llogaria e Allahut është shumë e afërt!"**[34]

"Për ju është bërë hallall të gjuani në det dhe të hani nga ajo që keni gjuajtur në mënyrë që të përfitoni edhe ju, edhe ata që udhëtojnë..."[35]

c. Hadithet mbi këtë çështje

Ebu Hurejre (r.a.) rrëfen: "Profeti (a.s.) ka porositur kështu:

"Ngrënia e çdo kafshe të egër me dhëmballë është haram."[36]

Ibni Abbas (r.a.) rrëfen: *"I Dërguari i Allahut ndaloi mishin e çdo kafshe të egër me dhëmballë dhe mishin e çdo shpendi grabitqar me kthetra."*[37]

Ebu Tha'lebe (r.a.) ka thënë se *"i Dërguari i Allahut ka ndaluar ngrënien e mishit të gomarit të butë."*[38]

Enesi (r.a.) dhe Ebu Musai (r.a.) kanë thënë: *"Kemi parë se i Dërguari i Allahut ka ngrënë mishin e lepurit e të pulës."*[39]

d. Mënyra e therjes së kafshëve, të cilave u hahet mishi

Ka dy mënyra therjeje për kafshët që u hahet mishi.

33 Kurani, El-Maide: 3.

34 Kurani, El-Maide: 4.

35 Kurani, El-Maide: 96.

36 Sahihu'l-Muslim, Kitabu's-Sajd, 15.

37 Sahihu'l-Muslim, Kitabu's-Sajd, 16.

38 Sahihu'l-Muslim, Kitabu's-Sajd, 23.

39 Sunenu't-Tirmidhi, Babu't-Taaam, 1849, 1887.

1. Kafshët me qafë të gjatë si deveja duhet të theren në vendin ku bashkohet qafa me gjoksin. Kjo mënyrë therjeje quhet "nahr".

2. Kafshët e tjera duhet të theren aty ku bashkohet nofulla me qafën. Kjo mënyrë therjeje quhet "dhebh".

Vdekja e kafshës së gjuajtur, të plagosur, ende pa arritur gjuetari, quhet "vdekje e shtrënguar" dhe konsiderohet në mënyrë konvencionale (me marrëveshje) si therje. Por, nëse gjuetari e arrin atë të gjallë, duhet ta therë.

H. NATYRA DHE KUSHTET E GJUETISË

a. Përkufizimi i gjahut

Gjuetia është mënyra e kapjes dhe përvetësimit të kafshëve të egra, zogjve, shpendve dhe peshqve në tokë e në det. Edhe kapja e kafshës së egër e cila mund të shtihet në dorë vetëm me anë të gjuajtjes (gjuetisë), quhet gjueti dhe kafsha quhet kafshë gjahu. Kështu, kapja e kafshës së egër duke e bërë të paaftë për të ikur ose për të kundërshtuar ose vrasja e saj quhet gjueti.

b. Kafshët, gjuetia e të cilave është hallall

Është hallall:

* Gjuetia e kafshëve të egra nga të cilat njeriu ruhet, si dhelpra, ariu, rrëqebulli, etj., që, edhe pse s'u hahet mishi, u përdoret lëkura.

* Gjuetia e shpendëve grabitqarë, si shqiponja, petriti (gjeraqina), skifteri (fajkoi) dhe shpendëve të ngrënshëm, si thëllëza, shkurta, pëllumbi, turtulli, etj.

* Gjuetia e kafshëve të dëmshme, si gjarpëri, akrepi, etj.

*Gjuetia e peshqve.

c. Veçoritë e gjuetarit

1. Personi që bën gjueti duhet të jetë i aftë për këtë punë, domethënë duhet të dijë të gjuajë me armë dhe, duke gjuajtur, ta përmendë emrin e Allahut, të dijë ta therë kafshën e plagosur të kapur gjallë sipas kushteve të Islamit.

Nëse gjuetari, duke gjuajtur, e lë qëllimisht pa përmendur emrin e Allahut, mishi i kafshës së gjuajtur nuk hahet. Por ky kusht nuk është efektiv në gjuetinë e detit.

2. Nëse gjuetari i kap gjahun të plagosur, ende të gjallë, duhet ta therë. Prandaj, gjuetari, pasi ta qëllojë dhe plagosë kafshën, duhet të vrapojë menjëherë për ta zënë ende të gjallë. Megjithëkëtë, nëse kafsha vdes para se të arrijë gjuetari, mishi i saj është hallall.

d. Mjetet e gjuetisë dhe format e tyre

Gjuetia bëhet me armë plagosëse apo vrasëse ose me mjete të tilla si shigjeta ose me mjete të tilla si kurthet. Veçanërisht në gjueti përdoren kafshë të mësuara posaçërisht për gjueti, si qentë, skifterët, fajkonjtë, etj.

Nuk është i lejueshëm (xhaiz) gjuetia me ndihmën e kafshëve të pamësueshme për gjueti, si luani, tigri, ariu dhe derri. Kafshët e gjuetisë që kanë dhëmbë qeni, kur e kapin kafshën e plagosur apo të vrarë, nuk duhet ta kafshojnë e të hanë prej mishit të saj.

Qeni pranohet si i mësuar për gjueti nëse tri herë me radhë kap gjahun dhe ia sjell gjuetarit pa e ngrënë. Kurse për pranimin e shpendëve si skifteri dhe fajkoi si të mësuar për gjueti është kusht t'i përgjigjen thirrjes së gjuetarit duke shkuar pranë tij.

PËRMBLEDHJE

1. Bëni përkufizimin e kurbanit.
2. Shpjegoni rëndësinë e kurbanit.
3. Cili është konkluzioni mbi kurbanin?
4. Thoni për kë është vaxhib kurbani?
5. Kur bëhet vaxhib kurbani?
6. Kur theret kurbani?
7. Cila është shtylla ose elementi themelor i kurbanit?
8. Cila është natyra e kurbanit dhe cili është konkluzioni mbi të?
9. Cilat janë kushtet e kurbanit të përkushtimit?
10. Ç'është kurbani i flokëve?
11. Cili është karakteri i përgjithshëm i kafshëve që s'u hahet mishi?
12. Ç'është gjuetia? Cilat janë kafshët që janë hallall për t'u gjuajtur?
13. Cilat janë kushtet që duhet të plotësojë gjuetari?

PJESA VI
BETIMI DHE KUSHTIMI

ÇËSHTJET

1. Natyra e betimit
2. Llojet e betimit dhe konkluzioni mbi to
3. Natyra e kushtimit
4. Kushtet e kushtimit dhe llojet e tij

PUNË PËRGATITORE

1. A janë betime shprehjet e përdorura në popull, "si më vraftë buka", "për Zotin", etj.? Pyesni mësuesin për këtë.
2. Pse ndjejnë nevojë njerëzit për t'u betuar? Thoni mendimet tuaja mbi këtë çështje.
3. Në ditët tona bëhemi shpesh dëshmitarë të betimit të njerëzve. Sipas jush, a është gjë e mirë betimi?
4. A mund të bëhet betim mbi gjë tjetër veç emrit të Allahut? Merrni të dhëna mbi këtë çështje nga librat e ilmihalit.
5. A mendoni se kushtimi për një punë ndikon në forcimin e vendosmërisë, zellit dhe përpjekjeve të njeriut?
6. Përgjithësisht, për ç'gjëra bëjnë kushtim njerëzit?

A. NATYRA E BETIMIT (JEMIN)

a. Kuptimi leksikor dhe terminologjik i betimit

Si fjalë, fjala arabishte *jemin do të thotë dorë e djathtë, anë e djathtë, forcë, fuqi*. Kurse si term i së drejtës Islame, jemin do të thotë betim (dhënie e besës) mbi emrin e Allahut në lidhje me një pohim, mohim ose vendim me qëllim për ta mbështetur dhe përforcuar atë, për të dhënë siguri për të. *Jemini* (betimi) përkufizohet edhe si "shprehje e vendosmërisë së një personi për ta bërë ose mos e bërë diçka".

b. Natyra e betimit dhe konkluzioni mbi të

Njeriu betohet për ta kushtëzuar (për ta vënë nën përgjegjësi) veten kur kërkon nga të tjerët që ta pranojnë dhe miratojnë thënien e tij, kur kërkon ta rrisë vendosmërinë për të bërë diçka dhe kur kërkon ta detyrojë veten për të bërë diçka.

Betimi bëhet mbi një emër ose mbi një kusht.

Betimi mbi një emër bëhet duke përmendur emrin e Allahut (Zotit) për ta mbështetur fjalën. Në këtë rast kusht tjetër s'vihet. Për shembull, për Zotin, në emër të Zotit, pasha Zotin, në emër të Allahut, Vallahi, Billahi, Tallahi.

Betimi mbi një kusht bëhet pa përmendur emrin e Allahut por duke vënë një kusht (duke bërë një kushtim ose duke premtuar diçka). Për shembull: "(Betohem se) Këtë gjë s'kam për ta përsëritur më! Po e përsërita, do të ta fal të gjithë pasurinë time!"

Personi që bën një betim, duhet ta çojë në vend. Në të kundërt, bëhet mëkatar. Por personi që është betuar se do të bëjë një gjë që është haram, nuk duhet ta çojë në vend betimin dhe duhet të paguajë kundërshpërblimin përkatës (kefaret).

Megjithëse betimi është, në thelb, mubah, teprimi në betim, domethënë përdorimi i tepruar i betimit është pranuar si mekruh.

Kurse betimi mbi gënjeshtër është gjynah i madh.

c. Dobitë individuale dhe shoqërore të betimit

* Personi, i cili ka dëshirë të bëjë një gjë të mirë ose të lërë, të braktisë një gjë të keqe por nuk ia arrin qëllimit për shkak të vullnetit të dobët, mund t'ia arrijë

qëllimit duke e motivuar, shtyrë dhe detyruar veten me anë të betimit. Në këtë rast, personi që është betuar mbi emrin e Allahut, e di se mosçuarja në vend e betimit do të jetë edhe kundërshtim dhe mungesë respekti ndaj Allahut, edhe mosbesim ndaj vetes. Personi që i mendon këto, përpiqet t'i mbetet besnik betimit që ka bërë.

* Betimi fillestar në detyra dhe profesione tejet të rëndësishme, si shërbimi ushtarak, mjekësia, gjykimi, bën që personi që ka bërë betim, ta kryejë detyrën ose ta ushtrojë profesionin në mënyrën më të mirë, sepse personi që e vlerëson lart nderin e vet dhe beson në vlerën dhe rëndësinë e detyrës apo profesionit të vet, nuk e shkel betimin, i mbetet besnik atij.

* Në gjykatat, detyrimi i dëshmitarit ose personit që merret në pyetje nga gjykatësi apo trupi gjykues, për t'u betuar se do të thotë vetëm të vërtetën, ndihmon ose siguron dhënien e pohimeve dhe dëshmive të vërteta e të sakta, gjë që parandalon gabimet në gjykim dhe padrejtësinë dhe ndihmon në ndëshkimin e fajtorit të vërtetë.

Betimi ka rëndësi për individin dhe shoqërinë, por, më e rëndësishme është frika në zemra nga Allahu. Personi që nuk e ka frikë Allahun, për rrjedhojë, që shpreson se e vërteta s'ka për të dalë në shesh dhe ai do të mbetet pa u ndëshkuar, mund të betohet në gënjeshtër, mund të mos i japë rëndësi betimit dhe mund ta shkelë betimin në çdo kohë, sapo t'i vijë për mbarë për ta bërë një gjë të tillë.

B. LLOJET E BETIMIT DHE KONKLUZIONI MBI TO

Betimet e bëra mbi emrin e Zotit janë tre llojesh; edhe konkluzioni për to është i ndryshëm sipas llojit të tyre.

a. Betimi i rëndë

Betimi i rëndë është betimi i bërë në mënyrë të vetëdijshme mbi një gënjeshtër, që i përket së shkuarës ose së tashmes, si, p.sh., betimi i dikujt, "vallahi e shlyeva borxhin" kur s'e ka shlyer dhe e di shumë mirë se s'e ka shlyer. I tillë është edhe betimi mbi një pohim ose dëshmi të gënjeshtërt gjatë një procesi gjykimi. Ky betim është gjynah (mëkat) shumë i madh.

Për betimin e rëndë nuk paguhet kundërshpërblim (kefaret). Për të shpëtuar prej këtij mëkati të madh, i duhet lutur Allahut për falje. Ndërkaq, nëse me anë të betimit dhe dëshmisë së gënjeshtërt është dëmtuar një person tjetër, personi që ka

bërë betim dhe dëshmi të gënjeshtërt duhet t'i kërkojë personit të dëmtuar që ta falë (t'ia falë hakun), sepse, po s'e fali personi i dëmtuar të drejtën (hakun) e vet, as Allahu nuk e fal hakun e atij dhe nuk ia fal mëkatin personit që ka mëkatuar duke dëmtuar ose përvetësuar padrejtësisht të drejtën e dikujt tjetër.

b. Betimi i pavlerë

Është betimi i bërë mbi një gjë të padrejtë duke pandehur se është e drejtë, është betimi i gënjeshtërt pa dashje. I tillë është betimi i një personi se s'e ka marrë gjënë që duhej ta merrte nga një person tjetër kur, në të vërtetë, e ka marrë atë gjë, por ka harruar. I tillë është edhe betimi i bërë pa qëllim, pa e ditur, mbi një të gabuar. Meqë në të gjitha variantet e këtij lloj betimi nuk ka qëllim të keq, shpresohet se Allahu ka për ta falur personin që e ka bërë. As ky lloj betimi nuk ka kundërshpërblim (kefaret).

c. Betimi i kontraktuar (mun'akid)

Betimi i kontraktuar është betimi i bërë për kryerjen apo moskryerjen e një pune që i përket së ardhmes, si: "Vallahi, këtej e tutje, çdo vit do ta bëj Kuranin hatme!"

Ky betim duhet çuar në vend, fjala e dhënë duhet mbajtur. Nëse personi që ke bërë një betim të tillë, nuk e mban fjalën dhe nuk e çon në vend betimin, duhet të bëjë pendesë dhe ta paguajë kundërshpërblimin përkatës (kefaret).

Ky betim duhet të plotësojë tre kushte:

1. Personi që betohet, duhet të jetë mysliman, me zhvillim mendor normal dhe të ketë mbushur moshën e pubertetit.

2. Puna mbi të cilën është betuar se do ta bëjë, duhet të jetë një punë që mund të bëhet.

3. Betimin nuk duhet ta ketë shoqëruar me shprehjen, "inshallah, në dashtë Allahu".

Po të plotësohen këto tre kushte, betimi është i vlefshëm. Ndërkaq, nëse personi i vë betimit një kusht dhe kushti nuk plotësohet, personi nuk është i detyruar ta çojë betimin në vend. Për shembull, nëse një nxënës betohet se, "po doli me sukses në provim, do t'i blejë një shoku një orë dore si dhuratë", dhe nuk del me sukses, nuk është i detyruar ta mbajë betimin.

Personi që e shkel betimin e kontraktuar, duhet të japë kundërshpërblimin e caktuar (kefaret), si më poshtë:

* Të paguajë për çlirimin e një skllavi ose robi dhe ta çlirojë atë nga skllavëria ose robëria.

* Nëse kjo gjë është e pamundur, të veshë dhjetë të varfër ose t'i ushqejë ata për një ditë (mëngjes e mbrëmje). Është i vlefshëm edhe ushqimi i një të varfri për dhjetë ditë.

* Nëse personi nuk ka mundësi materiale për këtë, duhet të agjërojë për tri ditë të njëpasnjëshme në një kohë jashtë muajit të Ramazanit.

* Kefareti është i pavlefshëm po të jepet para shkeljes së betimit, por pas shkeljes duhet të jepet me doemos.

* Nëse betimi përmban disa objekte ose, nëse në një fjali përmbahen më shumë se një betim, për secilin objekt të një betimi ose për secilin betim të një fjalie (pohimi, shprehjeje) duhet paguar kefaret veç e veç.

* Vlefshmëria e betimit varet nga forma e shprehjes në përputhje me konceptualizmin e përgjithshëm dhe tradicional të vendit të lokalizuar ku bëhet e jo sipas qëllimit ose aludimit. Për shembull, nëse një person betohet se "s'do të hyjë në asnjërën prej dhomave të një shtëpie të caktuar" duke pasur ndërmend banjon dhe, pastaj, hyn në banjo, betimi i tij nuk prishet sepse sipas konceptualizmit të përgjithshëm dhe tradicional të vendit të lokalizuar, me fjalën "dhomë" nuk kuptohet "banjo" dhe anasjelltas, pavarësisht se ç'ka menduar ai në vetvete. Por nëse personi betohet se "s'do të hyjë në asnjërën prej "të ndarave" të një shtëpie të caktuar dhe, pastaj, hyn në banjo, apo kuzhinë, apo dhomë, etj. betimi i tij prishet sepse sipas konceptualizmit të përgjithshëm dhe tradicional të vendit të lokalizuar, "ndarje" është çdonjëra prej mjediseve të kësaj ndërtese të kufizuara me mure dhe dyer. Ndryshon puna sikur personi të thotë në mënyrë të specifikuar "mjedis ndenjeje", gjë që, në këtë rast, dallohet nga mjediset e tjera që quhen "mjedise shërbimi", "mjedise tualeti", "mjedise higjienike", etj.

* Nëse një person bën një betim mbi një gjë të pamundur, duhet të japë menjëherë kundërshpërblimin (kefaret) e betimit të rremë edhe sikur ky të mos jetë i kushtëzuar. Për shembull, nëse personi betohet kështu: "Vallahi, këtë gur do ta kthej tani në flori!"

* Kundërshpërblim duhet të paguajë edhe personi që e shkel betimin e bërë duke harruar, duke gabuar ose nën shtrëngimin e dikujt tjetër.

C. NATYRA E KUSHTIMIT

Kushtimi e ngarkon njeriun me një përgjegjësi që s'i kërkohet, pra, me një përgjegjësi vullnetare. Kushtimi është përgjegjësi e nivelit vaxhib.

Meqë personi që bën një kushtim, i ka dhënë fjalën Allahut se ka për ta zbatuar kushtimin e tij, e ka për vaxhib ta zbatojë kushtimin në fjalë. Por, nëse kushtimi është bërë rreth një çështjeje që është haram, nuk zbatohet dhe për të paguhet kundërshpërblim (kefaret) i betimit.

D. KUSHTET E KUSHTIMIT DHE LLOJET E TIJ

a. Kushtet, që duhet të plotësojë personi që bën betim

Personi që bën një kushtim, duhet të jetë mysliman, të ketë zhvillim mendor normal dhe të ketë arritur moshën e pubertetit.

b. Kushtet që duhet të plotësojë kushtimi

Gjëja për të cilën bëhet kushtimi, duhet të plotësojë këto kushte:

* Të jetë fetarisht e vlefshme. Nuk duhet të jetë një akt haram dhe mekruh.

* Nuk duhet të jetë një adhurim, të cilin personi e ka për detyrë ta kryejë, si agjërimi i Ramazanit, etj.

* Nuk duhet të jetë një gjë e pamundur për t'u bërë. Kushtimi duhet të jetë një gjë e mundshme.

* Nuk duhet bërë, duke u mbështetur në mundësitë materiale të të tjerëve dhe duke shpresuar në ndihmën e të tjerëve.

* Kushtimi duhet të jetë i llojit të adhurimeve farz ose vaxhib, si agjërim, kurban, etj.

c. Llojet e kushtimit

1. Kushtimi me kohën e zbatimit të përcaktuar.

2. Kushtimi me kohën e zbatimit të papërcaktuar.

3. Kushtimi i kushtëzuar (relativ).

4. Kushtimi i pakushtëzuar (absolut).

d. Konkluzioni mbi kushtimin

Pavarësisht nga lloji, zbatimi i kushtimit është vaxhib. Kushtimi me kohën të përcaktuar, kur t'i vijë koha, duhet të zbatohet. Kushtimi i kushtëzuar, kur të plotësohet kushti, duhet të zbatohet. Nëse nuk zbatohet në kohën e vet, duhet të zbatohet si i prapambetur (kaza).

Personi që nuk e zbaton kushtimin e bërë, mbetet përgjegjës dhe hyn në gjynah (mëkat) që nuk e ka zbatuar.

PËRMBLEDHJE

1. Thoni kuptimin terminologjik të betimit.
2. Jepni të dhëna mbi natyrën e betimit.
3. Tregoni dobitë individuale e shoqërore të betimit
4. Shpjegojeni betimin e rëndë.
5. Jepni të dhëna mbi betimin e pavlerë.
6. Jepni të dhëna mbi betimin e kontraktuar
7. Jepni të dhëna mbi shpërblimin (kefaretin) e betimit.
8. Bëni përkufizimin e kushtimit dhe thoni llojet e tij.
9. Thoni konkluzionin mbi kushtimin.

PJESA VII
HALLALLET DHE HARAMET

ÇËSHTJET

I. Hallallet dhe haramet
   a. Llojet e haramit
   b. Allahu bën hallall dhe haram
   c. Situatat shtrënguese i bëjnë haramet mubah
II. Hallallet dhe haramet në sendet për ngrënie dhe pirje
   a. Haramet në sendet për ngrënie
   b. Haramet në sendet për pirje
   c. Haramet në fitim
   d. Pastrimi nga harami

PUNË PËRGATITORE

1. Ç'shprehin për ju konceptet "hallall" dhe "haram"?
2. Kërkoni të mësoni dëmet e pijeve alkoolike për shoqërinë.
3. Kërkoni të mësoni ndikimin e bixhozit mbi lumturinë e familjes.
4. Kërkoni të mësoni ndikimin e mitës (rushfetit) mbi shoqërinë.

A. HALLALLET DHE HARAMET

Hallall është veprimi fetarisht i lejuar e i bekuar.

Haram është veprimi fetarisht i ndaluar në mënyrë të prerë e i pabekuar.

Sipas këtij klasifikimi, një gjë që është hallall, nuk është haram dhe, anasjelltas, po qe haram, nuk është hallall.

Thelbësore në çdo gjë të krijuar nga Allahu, është qenia hallall ose mubah. Asgjë s'është haram përveç gjërave të deklaruara si të tilla.

Gjërat haram janë të kufizuara. Të tjerat janë hallall.

Allahu i ka bërë hallall gjërat e mira, të pastra e të dobishme për shëndetin e njeriut, kurse gjërat e fëlliqura, të këqija e të dëmshme i ka bërë haram.

Në Kuran urdhërohet:

يَسْـَٔلُونَكَ مَاذَآ أُحِلَّ لَهُمْ قُلْ أُحِلَّ لَكُمُ الطَّيِّبَاتُ

"Të pyesin ty se ç'gjëra janë bërë hallall për ta. Thuaj: "Të gjitha gjërat e mira e të pastra janë bërë hallall për ju!"[40]

Gjërat e bëra hallall nga Allahu, duhen pranuar si hallall, kurse gjërat e bëra haram nga Ai, duhen pranuar si haram.

Është gjynah i madh t'u thuash haram gjërave të bëra nga Allahu hallall dhe t'u thuash hallall gjërave të bëra nga Allahu haram.

Në Kuran urdhërohet:

"O besimtarë, mos i quani haram gjërat e mira dhe të pastra që Allahu i bëri për ju hallall dhe mos e teproni se Allahu nuk i do ata që e teprojnë!"[41]

"Mos u thoni gjërave hallall e haram siç ju gënjen gjuha juaj se, kështu, shpifni kundër Allahut. Pa dyshim, ata që shpifin për Allahun, nuk mund të shpëtojnë!"[42]

40 Kurani, El-Maide: 4.

41 Kurani, El-Maide: 87.

42 Kurani, En-Nahl: 116.

a. Llojet e haramit

Gjërat që janë në thelb haram, quhen haram liajnihi (haram në vetvete), si mishi i derrit dhe vera.

Gërat që në thelb janë hallall, por, që në kushte të caktuara marrin veti që i shndërrojnë në haram, quhen haram ligajrihi (haram jo në vetvete).

Për shembull, një dele apo një bukë e vjedhur është në thelb hallall, por janë kthyer në haram për atë që i ka vjedhur sepse i përkasin një tjetri dhe se janë vjedhur.

b. Allahu bën hallall dhe haram

Është Allahu që e bën diçka hallall dhe, diçka tjetër, haram. Ai nuk ia ka dhënë askujt kompetencën për të bërë haram. Duke u mbështetur në rëndësinë e çështjes, dijetarët Islamë s'e kanë cilësuar asgjë haram pa pasur për këtë argument të formës së prerë. Në rastet përkatëse, ata kanë përdorur shprehjen "s'është e këndshme, është e shëmtuar". Sepse Allahu i Lartë ka urdhëruar:

"Thuaj: "Kush i bëri haram zbukurimet dhe dhuntitë e mira që Allahu krijoi për robtë e Tij?" Thuaj: "Në jetën e kësaj bote, ato janë vetëm për ata që besojnë, kurse në ditën e Kiametit janë vetëm për myslimanët". Ja, kështu i shpjegojmë ajetet tona për ata që kuptojnë!"[43]

"Thuaj: "A nuk e shihni se një pjesë të furnizimeve të zbritura nga Allahu, Ai i bëri hallall e, një pjesë, haram?" Thuaj: "A mos ju dha Allahu lejë juve (që të cilësoni), apo po shpifni për Allahun?"[44]

c. Situatat shtrënguese i bëjnë haramet hubah

Feja Islame është fe e lehtësive. Nëse një person, për shkaqe madhore, detyrohet të hajë diçka ose të bëjë diçka që është haram, mund ta hajë gjënë haram ose mund ta kryejë veprimin haram në masën më të paktë të mundshme dhe me kusht që të mos i quajë hallall dhe në këtë rast për të s'është gjynah. Në Kuran thuhet:

"Allahu bëri haram për ju vetëm të vdekurin, ngordhësirën, gjakun, mishin e derrit dhe gjënë e therur në emër të dikujt tjetër veç Allahut. Kush mbetet i detyruar të hajë nga këto, nuk është gjynah të hajë një sasi pa sulmuar kënd dhe pa e kaluar kufirin. Pa dyshim, Allahu është falës i madh!"[45]

Jashtë situatave shtrënguese, duhet ruajtur dhe shmangur nga gjërat haram.

43 Kurani, El-A'raf: 32.

44 Kurani, Junus: 59.

45 Kurani, El-Bekare: 173.

Lexim letrar
Kurbani

Ishte viti i nëntë i hixhretit. Profeti po kthehej nga fushata e Tebukut kundër Bizantit.

Myslimanët medinas kishin dalë gjer jashtë qytetit për të pritur ushtrinë Islame. Kudo kishte një atmosferë gëzimi dhe feste. Mes atyre që kishin dalë për ta pritur Profetin dhe ushtrinë Islame, ndodhej edhe sahabi i madh, Muadh bin Xhebel. Ai s'pati marrë dot pjesë në fushatën e Tebukut për një shkak të justifikueshëm.

Profeti u takua dhe shtrëngoi duart me të gjithë ata që kishin dalë për ta pritur, pranoi urimet e tyre.

Por kur Profeti shtrëngoi duart me Muadh bin Xhebelin, ndjeu se duart e tij ishin krejt të ndryshme nga të të tjerëve. Ato ishin të ashpra, plot kallo. Profeti e pyeti:

"O Muadh, pse të janë bërë duart kështu? Si u bënë këto kallo?"

Muadh bin Xhebel pandehu se e kishte shqetësuar Profetin dhe filloi t'i shpjegonte në formë kërkese faljeje:

"O i Dërguari i Allahut! Unë përpiqem për të siguruar ushqimin e familjes dhe jetesën e tyre. Sharra, sqepari, kazma, lopata, çekiçi kurrë nuk më hiqen nga dora. Prandaj më janë ashpërsuar duart. Kështu u bënë me kallo!"

Pas këtyre fjalëve, Profeti ynë i dashur, i dërguar si mëshirë për botët, e puthi Muadh bin Xhebelin në ballë dhe tha:

"Këto duar flaka nuk i prek, zjarri i xhehennemit nuk i djeg!"

Kjo ngjarje është një përgëzim i madh për myslimanët punëtorë, që përpiqen ta fitojnë me të drejtë (hallall) ushqimin dhe jetesën e familjeve të tyre.

I vetmi kusht për ta merituar këtë lajm të madh të gëzuar, është zbatimi i urdhrave të Allahut, kryerja e adhurimeve farz dhe ruajtja nga gjërat që ka ndaluar Ai. Atëherë, punët e kësaj bote bien në përputhje me pëlqimin e Allahut dhe i përftojnë njeriut sevap adhurimi.

Edhe hadithi në vijim tregon se ç'adhurim i pëlqyeshëm është në lartësinë e Allahut përpjekja për të fituar dhe për të siguruar jetesën e familjes me drejtësi (hallall):

"Mes gjynaheve ka gjynahe të atilla, të cilat as namazi, as agjërimi, as haxhi as dhe umreja nuk mund t'i shlyejnë! Ato mund t'i shlyejnë vetëm shqetësimet e hequra për sigurimin e ushqimit, kapërcimi i vështirësive..."

B. HALLALLET DHE HARAMET NË SENDET PËR NGRENIE DHE PIRJE

I. Haramet në sendet për ngrënie

a. Kërma (kafsha e ngordhur vetvetiu)

Nuk hahen kafshët e mbytura, e vrara me shkop druri apo sende të tjera të ngjashme, e ngordhura duke u rrokullisur nga një vend i lartë ose nga goditjet me brirë prej një kafshe tjetër si dhe mbeturinat e kafshëve të ngrëna nga kafshët e egra. këto mund të hahen vetëm nëse kapen dhe theren para se të ngordhin.

b. Gjaku

Pjesa më e madhe e gjakut në trupin e kafshës së therur sipas rregullave, rrjedh jashtë. Ky gjak i rrjedhur nuk hahet. Kurse gjaku i mbetur brenda organeve si shpretka dhe mëlçia, i pakonsideruar si i rrjedhur, hahet së bashku me to.

c. Mishi i derrit

Siç e pohuam edhe më lart, Allahu i ka bërë haram për njeriun gjërat e fëlliqura e të dëmshme. Një nga këto është edhe mishi i derrit.

Derri ka në trup mikrobe me sasi të mëdha, sepse parapëlqen shumë si ushqim gjërat e fëlliqura. Në krye të këtyre mikrobeve janë trishina ose tenja, që janë shumë të rrezikshme për jetën e njeriut. Në fakt, edhe mjekësia moderne ka arritur në konkluzionin se mishi i derrit është shumë i rrezikshëm për shëndetin e njeriut në çdo klimë, veçanërisht në klimat e nxehta.

Cilësimi i mishit të derrit si haram nuk është bërë vetëm për shkaqe që ne i kemi ditur gjer më sot. Ndoshta në të ardhmen do të njihemi me shkaqe të mundshme për t'u njohur prej nesh, por ndoshta edhe të pamundshme për t'u njohur. Por është një gjë që e dimë dhe e besojmë me siguri se gjëja që Allahu e ka bërë haram për ne, është e dëmshme!

d. Kafsha e therur në emër të tjetërkujt veç Allahut

Ashtu siç është Allahu, që e ka krijuar dhe e krijon çdo gjallesë, është përsëri Allahu që i jep fund jetës së saj, që e bën të vdesë. Ai i ka krijuar kafshët që njerëzit të përfitojnë prej tyre. Kur njeriu e ther kafshën për të përdorur mishin dhe lëkurën e saj, duhet të marrë lejë nga Krijuesi. Dhe kjo bëhet duke e therur kafshën shoqëruar me përmendjen e emrit të Krijuesit. Megjithëkëtë, mospërmendja e emrit

të Krijuesit për harresë nuk prish punë. Por nëse kafsha theret në emër të dikujt tjetër veç Zotit, mishi i saj nuk hahet.

Në Kuran urdhërohet:

"Janë bënë haram për ju kërmat, gjaku, mishi i derrit, mishi i therur në emër të tjetërkujt veç Allahut, kafsha e mbytur, kafsha e vrarë (me gur, dru ose me një gjë tjetër të ngjashme), kafsha e vrarë nga rrëzimi prej një vendi të lartë, kafsha e vrarë nga brirët e një kafshe tjetër, kafsha e prerë nga një kafshë e egër veç asaj që e keni arritur gjallë dhe e keni therur, si dhe kafshët e therura kushtuar idhujve."[46]

Kafshët e tjera të tokës e të ujit veç atyre të përmendur këtu më sipër, ngrënia e të cilave është hallall ose haram, janë përshkruar në pjesën "Therja e kafshëve".

II. Haramet në sendet për pirje

a. Pijet alkoolike

Janë lëngjet që japin të dehur pavarësisht nga sasia që përdoren. Në Kuran është urdhëruar:

"O ju që keni besuar! Vera, bixhozi, zaret, falli dhe llotaritë janë nga një pisllëk shejtani më vete. Shmanguni prej këtyre që të shpëtoni! Me pijet (alkoolike) dhe kumarin, shejtani kërkon vetëm të fusë mes jush urrejtje e armiqësi dhe t'ju pengojë që ta përmendni Allahun. A nuk keni hequr dorë ende prej tyre?"[47]

Megjithëse në këtë ajet, nga pijet alkoolike është përmendur vetëm vera, Profeti, duke porositur si më poshtë, ka bërë të ditur se haram është edhe çdo lloj pjie tjetër që jep të dehur si vera:

"Çdo gjë që jep të dehur është verë dhe çdo verë është haram!"

Kurse në porosinë si më poshtë, Profeti bën të ditur se çdo gjë që jep të dehur është haram pavarësisht nga sasia që përdoret. E thënë ndryshe, sasia e një pijeje alkoolike nuk ndryshon gjë në cilësimin e saj si haram:

"Edhe e pakta e gjësë që në sasi të shumtë jep dehje, është haram!"

Pija alkolike është haram, sepse pijet alkoolike kanë shumë dëme.

46 Kurani, El-Maide: 3.

47 Kurani, El-Maide: 90-91.

Pija shkakton mes njerëzve urrejtje dhe armiqësi. Në Kuran, duke bërë fjalë për dëmet e pijeve alkoolike dhe bixhozit, thuhet: "... Me pijet (alkoolike) dhe kumarin, shejtani kërkon vetëm të fusë mes jush urrejtje e armiqësi dhe t'ju pengojë që ta përmendni Allahun..."[48]

Pijet alkolike prishin funksionin normal të mendimit dhe arsyetimit, ato ndikojnë për keq në shëndetin e njeriut. Dëmtimet që shkaktojnë ato në organe të ndryshme të trupit si stomaku, mëlçia e zezë, enët e gjakut, etj. janë të rënda dhe shpesh të pakthyeshme.

Një pjesë e madhe e aksidenteve automobilistike që paguhen rëndë me jetë njerëzish dhe dëme të mëdha materiale, shkaktohen nga përdorimi i pijeve alkoolike.

Duke e dëmtuar arsyen dhe sistemin nervor, pijet u hapin rrugë grindjeve që jo rrallë përfundojnë me krime.

Pijet alkoolike paralizojnë edhe jetën familjare. Ato çojnë gjer në braktisjen e familjes në fatin e vet, në shkurorëzime dhe copëtimin e familjes duke rënduar më së shumti rritjen, edukimin dhe të ardhmen e fëmijëve. Prandaj Profeti ka porositur:

"Ruhuni nga pija, sepse ajo është nëna e të gjitha të këqijave!"

A është i lejueshëm (xhaiz) kurimi me pije alkoolike?

48 Kurani, El-Maide: 91.

b. Konkluzioni mbi përdorimin e kolonjës

Më sipër u shpjegua se pijet që japin të dehur, janë haram.

Ashtu siç është haram përdorimi i verës pavarësisht nga sasia, vera është edhe gjë e fëlliqtë. Nëse derdhet verë mbi rroba, mbi trup ose në vendin ku falet namaz, namazi i falur pa i pastruar trupin, rrobat ose vendin, është i pavlefshëm. Sepse Zoti në Kuran e ka cilësuar verën si gjë të pistë. Ndërkaq, megjithëse edhe përdorimi i pijeve të tjera është haram ashtu si dhe i verës, çështja nëse pijet e tjera janë apo jo gjëra të pista, është e diskutueshme.

Imam Adhami ka thënë se pikimi në rroba i një derhemi ose më shumë prej lëngjeve alkoolike të tjera veç verës dhe alkooleve të bëra prej rrushi, nuk është pengesë për namaz.

Si përfundim, pirja e shpirtos[49] dhe kolonjës është haram, kurse përdorimi për qëllime të tjera dhe shitblerja e tyre shihet si xhaiz.

III. Haramet në fitim

Bixhozi është loja duke vënë në mes para.

Nuk është e rëndësishme se me ç'mjete dhe mënyra luhet loja. Nëse një lojë, në përfundim të saj, i sjell një ane fitim duke e dëmtuar anën tjetër, ajo lojë quhet bixhoz dhe është e ndaluar. Paraja e fituar me këtë rrugë është haram, e palejuar, e pabekuar.

Në Kuran është urdhëruar:

"O ju që keni besuar! Vera, bixhozi, zaret, falli dhe llotaritë janë nga një pisllëk shejtani më vete. Shmanguni prej këtyre që të shpëtoni!"[50]

Profeti ka porositur që personi, i cili u thotë shokëve, "ejani të lozim bixhoz", vetëm për këtë fjalë duhet të japë sadaka si kundërshpërblim (kefaret).

Duke menduar për shkaqet për të cilat bixhozi është bërë haram, të vijnë ndërmend gjërat e mëposhtme:

1. Ka rrugë të ndryshme fitimi legal, me drejtësi e ndershmëri, prandaj, jetesa duhet siguruar me punë dhe përpjekje në këto rrugë pa ia lënë këtë shansit dhe rastësisë.

2. Bixhozi bëhet pengesë që personi të punojë, të kryejë shërbime të dobishme

49 Lloj lëngu që përdoret për të holluar bojërat industriale.

50 Kurani, El-Maide: 90.

për familjen dhe shoqërinë, madje për tërë njerëzimin si dhe të kryejë adhurimet e caktuara që janë detyrë ndaj Allahut.

3. Dëmet e bixhozit nuk kufizohen vetëm te personi që luan, ato ndikojnë edhe mbi individët e familjes dhe shoqërisë, bëhen shkak për shtimin e njerëzve të pa punë e të dëshpëruar, duke u bërë, kështu, shkak për kriza shoqërore.

Krimet dhe vetëvrasjet për shkak të dështimeve apo konflikteve në bixhoz kanë arritur sot në përmasa që nuk mund të nënvleftësohen. Kjo dhe foletë familjare të shkatërruara janë një e vërtetë e pamohueshme.

Bixhozi që ka edhe shumë dëme të tjera, është haram; po kështu, haram është edhe fitimi i arritur me anë të tij.

IV. Pastrimi nga harami

Nëse personi që ka bërë fitime me rrugë të palejueshme si mita (rushfeti), bixhozi, mashtrimi dhe padrejtësitë e ndryshme, pendohet dhe dëshiron të çlirohet dhe pastrohet nga mëkati i mallit dhe pasurisë së përvetësuar haram, duhet të bëjë dy gjëra:

E para, ta heqë nga pronësia e vet fitimin haram.

E dyta, të bëjë pendesë dhe të kërkojë falje nga Allahu, mëshira dhe falja e të cilit janë të pafundme.

Heqja nga pronësia e fitimit haram bëhet duke ua kthyer gjënë të zotit ose trashëgimtarëve të tij nëse ai nuk rron. Nëse këta nuk gjenden ose nuk dihen, gjërat u shpërndahen të varfërve si sadaka në emër të pronarit të tyre të vërtetë.

Lexim letrar
Kurbani

Një mik i Allahut tregon:

Isha rreth të dyzetepesave. E kujtoj atë kohë si tani. I ndjeri im atë i donte shumë njerëzit e mësuar dhe i ftonte shpesh në shtëpi. Te ne atëherë bëheshin biseda shumë të bukura.

Disa herë, mes të ftuarve ndodhej edhe mulla Rebiiu, një burrë i moshuar, mjaft serioz dhe i rëndë, por edhe po aq i thjeshtë, një person që dukej se lëshonte dritë me të gjithë qenien e tij! Ata dijetarë të lartë aq shumë respekt tregonin dhe aq më të madh e mbanin atë, saqë e vinin gjithmonë në këndin më të respektuar të kuvendit, pranë tij qëndronin gjithmonë kokulur dhe, megjithëse ai qe i thjeshtë e fjalëpak, fjalën gjithmonë atij ia jepnin.

Mulla Rebiiu banonte në Axhibadem të Çamllëxhasë. Kur e kërkonin t'u vinte në kuvend, i dërgonin një pajton duke iu lutur të kishte mirësinë t'i nderonte.

Pothuaj pesëdhjetë vjet më vonë u njoha me një person të quajtur Xhemal që kish qenë më parë krishter e ishte bërë më pas mysliman. Ishte një mysliman i përkryer. Një ditë e pyeta se pse e kishte pëlqyer Islamin. Dhe ma tregoi se si qëndronte puna.

"Ne kishim një komshi të quajtur mulla Rebii që e donim dhe e respektonim shumë. Ishte i dhembshur me të gjithë dhe përpiqej t'u bënte mirë të gjithëve pa bërë dallim për myslimanë e krishterë. Morali dhe sjellja e tij e bukur na pati bërë të gjithëve për vete. Ai ishte një mysliman i vërtetë me fjalë dhe punë!

Në shtëpinë e tij drita pothuaj nuk shuhej gjatë gjithë natës. Në dritare shihej hija e tij e kërrusur mbi libra ose duke lëvizur. Zoti i kishte dhënë një fuqi të veçantë.

Ai nuk i jepte fare vlerë kësaj bote. Jetonte me të ardhurat nga shitja e qumështit të dy lopëve që kishte. Një ditë, lopët i kishin hyrë në kopshtin e fqinjit dhe kishin ngrënë nga bari i atyshëm. Pasi e kishte parë vetë ngjarjen, i shqetësuar, kishte thirrur shërbëtorin, të cilin e kishte porositur ta njoftonte të zotin e bahçes për dëmin dhe t'ia shlyente këtë me qumështin e lopëve. Komshiu iu përgjigj:

"Fundja, barërat kanë qenë tharë! Të qoftë hallall!"

Dhe s'e kishte pranuar qumështin.

Kurse mulla Rebiiu i kishte thënë shërbëtorit:

"Meqë s'e pranoi qumështin, po e derdhim!"

Shërbëtori e kishte kundërshtuar:

"Meqë komshiu na e bëri hallall, nuk ka ndonjë të keqe ta shpërndajmë në ato vende ku e shesim!"

Por mulla Rebiiu e kishte kundërshtuar prerë:

"Jo, jo! As ta shesim, as ta hamë vetë!"

Pastaj, e derdhën qumështin."

Më në fund, zoti Xhemal më tha:

"Ja, pra, ne, si komshinj të tij, duke parë këtë drejtësi dhe ndershmëri të papërfytyrueshme të mulla Rebiiut, të mahnitur pas tij, u bëmë myslimanë..."

PËRMBLEDHJE

1. Shkruani llojet e haramit.
2. Shkruani gjërat haram në sendet e ngrënshme.
3. Shkruani pijet që janë haram.
4. Ç'është fajdeja (ose kamata) dhe cilat janë ndikimet e saj shoqërore?
5. Cilat janë dëmet e akaparimit për shoqërinë?
6. Jepni të dhëna mbi betimin e kontraktuar
7. Jepni të dhëna mbi shpërblimin (kefaretin) e betimit.
8. Bëni përkufizimin e kushtimit dhe thoni llojet e tij.
9. Thoni konkluzionin mbi kushtimin.

PERMBAJTJA

PJESA I

AGJËRIMI 7

A. PËRKUFIZIMI, RËNDËSIA, URTËSIA DHE DOBITË E AGJËRIMIT 9

a. Kuptimi leksikor dhe terminologjik i fjalës "agjërim" 9

b. Rëndësia dhe dobitë e agjërimit 9

B. DETYRIMI (FARZ) I AGJËRIMIT 11

C. LLOJET E AGJËRIMIT 12

a. Agjërimi farz 12

b. Agjërimi vaxhib 13

a. Agjërimet nafile 13

b. Agjërimet mekruh 13

D. KUSHTET, KONKLUZIONI DHE VENDIMI I AGJËRIMIT 15

a. Kushtet e detyrimit (farz) 15

b. Kushtet e rregullsisë së agjërimit 15

c. Konkluzioni dhe vendimi i agjërimit 16

E. GJËRAT QË E PRISHIN DHE NUK E PRISHIN AGJËRIMIN 16

a. Gjërat që e prishin agjërimin 16

b. Gjërat që nuk e prishin agjërimin 16

F. NDËSHKIMI I PRISHJES SË AGJËRIMIT 17

G. RASTET KUR PRISHJA E AGJËRIMIT KËRKON EDHE KAZANË, EDHE KEFARETIN 17

H. RASTET KUR PRISHJA E AGJËRIMIT KËRKON VETËM KAZANË 18

I. GJËRAT QË JANË OSE S'JANË MEKRUH PËR AGJËRUESIN 19
a. Gjërat që nuk janë mekruh për agjëruesin 19
b. Gjërat janë mekruh për agjëruesin 19
J. GJËRAT E PËLQYESHME (MUSTEHAB) TË AGJËRIMIT 20
Lexim letrar: *Si na mban agjërimi?* 21
K. JUSTIFIKIMET QË E BËJNË NORMALE (MUBAH) MOSMBAJTJEN OSE PRISHJEN E AGJËRIMIT 22
a. Justifikimet që e bëjnë normale (mubah) mosmbajtjen ose prishjen e agjërimit të Ramazanit, konkluzioni dhe vendimi mbi to 22
b. Justifikimet që e bëjnë normale (mubah) prishjen e agjërimit nafile, konkluzioni dhe vendimi mbi to 23
L. SHPËRBLIMI (FIDJE) I AGJËRIMIT 24
M. LUTJET E AGJËRIMIT 24
N. I'TIKAFI 25
a. Si bëhet i'tikaf? 26
b. Kushtet e i'tikafit 26
c. Rastet kur prishet i'tikafi 26
d. Rastet që s'e prishin i'tikafin 26
PËRMBLEDHJE 28

PJESA II

ZEKATI 29
A. PËRKUFIZIMI DHE RËNDËSIA E ZEKATIT 31
a. Përkufizimi i zekatit 31
b. Rëndësia e zekatit 31
B. DOBITË E ZEKATIT 32
Konkluzioni mbi zekatin 33
C. KUSHTET E DETYRIMIT TË ZEKATIT 35

a. Kushtet që duhet të plotësojë personi përgjegjës 35
b. Kushtet që duhet të plotësojë malli për të cilin do të jepet zekat 36
D. KUSHTET E VLEFSHMËRISË SË ZEKATIT 38
a. Kushtet që duhet të plotësojë personi që do të japë zekat 38
b. Kushtet që duhet të plotësojë personi që do të marrë zekat 38
E. MALLRAT E NGARKUARA ME ZEKAT 39
a. Zekati i të imtave (dele, dhi) 39
b. Zekati i të trashave (lopë, buallicë) 40
c. Zekati i deveve 40
d. Zekati i kuajve 40
e. Zekati i arit dhe i argjendit 41
f. Zekati i pasurisë në monedhë 42
g. Zekati i të ardhurave, rrogave dhe mëditjeve 42
h. Zekati i mallrave të tregtisë 43
i. Zekati i prodhimeve të tokës 44
k. Zekati i minierave dhe thesareve 45
F. MALLRAT DHE SHPENZIMET E PANGARKUARA ME ZEKAT 45
Lexim letrar: *Vendi i agait* 47
G. PERSONAT QË U JEPET ZEKAT DHE RADHA PERPARESORE 49
Njerëzit që u jepet përparësi në zekat 50
Personat, që s'u jepet zekat 50
Lexim letrar: *Sa keq për Tha'leben!* 52
PËRMBLEDHJE 55

PJESA III

SADAKAJA 57
A. PËRKUFIZIMI, RËNDËSIA DHE LLOJET E SADAKASË 59
a. Përkufizimi i sadakasë 59

b. Llojet e sadakasë 59
c. Dobitë dhe vlerat e sadakasë 60
Lexim letrar: *Vendi i agait* 61
d. Rëndësia e sadakasë nafile dhe vendi i saj në fenë tonë 62
e. Ata që s'kërkohet të japin sadaka 63
Lexim letrar: *Ka nga ata që japin më shumë se ju!* 64
B. PËRKUFIZIMI I SADAKASË SË FITRIT DHE VENDI E SAJ NË FENË TONË 66
Lexim letrar: *Ka nga ata që japin më shumë se ju!* 67
C. NISABI I FITRIT DHE KUJT I JEPET 70
a. Nisabi i fitrit 70
b. Me çfarë jepet fitër? 70
c. Kujt i jepet fitër? 70
d. Kur jepet fitër? 71
Lexim letrar: *Kopshti i shkatërruar* 71
D. SOLIDARITETI 72
Lexim letrar: *Ka nga ata që japin më shumë se ju!* 73
PËRMBLEDHJE 75

PJESA IV

HAXHI 77
A. PËRKUFIZIMI, RËNDËSIA DHE DOBITË E HAXHIT 79
a. Haxhi si farz 79
b. Urtësitë dhe dobitë e haxhit 80
c. Vendi i haxhit në fenë tonë 81
d. Vizitat në haxh 82
e. Termat lidhur me haxhin si adhurim 82
B. LLOJET E HAXHIT 86

a. Llojet e haxhit sipas konkluzionit 86
b. Llojet e haxhit sipas përbërjes 86
C. SHTYLLAT E HAXHIT 87
a. Qëndrimi (vakfe) në Arafat 87
b. Tavafi i Qabes 87
Natyra e tavafit 87
Llojet e tavafit 88
Kushtet e tavafit 88
Vaxhibet e tavafit 88
D. KUSHTET E HAXHIT 89
a. Kushtet e haxhit si farz 89
b. Kushtet e vlefshmërisë së haxhit 90
E. VAXHIBET, SUNNETET DHE ETIKA E HAXHIT 90
a. Vaxhibet e haxhit 90
b. Sunnetet e haxhit 91
c. Etika e haxhit 93
Lexim letrar: *Ka nga ata që japin më shumë se ju!* 94
F. UMREJA 96
a. Kuptimi i umres 96
b. Konkluzioni mbi umren 96
c. Ndryshimet mes haxhit dhe umres 96
d. Koha e umres 97
e. Shtyllat e umres 97
f. Vendvizitat e umres 98
G. ÇËSHTJE TË TJERA LIDHUR ME HAXHIN DHE UMREN 98
a. Kurbani në haxh 98
b. Fajet në haxh 98
c. Haxhi me dorëzanës 99

H. URTËSITË E HAXHIT 100
Lexim letrar: *Si duhet të veprojmë në haxh?* 102
PËRMBLEDHJE 105

PJESA V

KURBANI DHE GJUETIA 107
A. PËRKUFIZIMI DHE RËNDËSIA E KURBANIT 109
a. Përkufizimi i kurbanit 109
b. Rëndësia dhe dobitë e kurbanit 109
c. Vendi i kurbanit në fenë tonë 110
d. Konkluzioni mbi kurbanin 110
B. PERSONAT QË E KANË VAXHIB KURBANIN 111
C. KAFSHËT QË BËHEN KURBAN 111
D. KOHA DHE THERJA E KURBANIT 112
a. Koha e therjes së kurbanit 112
b. Forma e therjes së kurbanit dhe lutjet e kurbanit 113
c. Veprimet lidhur me mishin dhe lëkurën e kurbanit 114
Lexim letrar: *Ç'mbeti pas?* 115
E. KURBANI I PËRKUSHTUAR (NEDHR) DHE KURBANI I FLOKËVE (AKIKA) .. 115
a. Konkluzioni mbi kurbanin e përkushtuar 116
b. Kushtet e vlefshmërisë së kurbanit të përkushtuar 116
c. Kushtet e kurbanit të përkushtuar 116
d. Llojet e kurbanit të përkushtuar 117
e. Konkluzione mbi mishin e kurbanit të kushtëzuar 118
f. Kurbani i flokëve 118
Lexim letrar: *Kurbani* 119
G. KAFSHËT, TË CILAVE U HAHET DHE S'U HAHET MISHI.....122
a. Veçoritë e kashëve që u hahet dhe s'u hahet mishi dhe pikëpamjet e imamëve të shkollave juridike-fetare mbi to..... 122

b. Ajetet mbi këtë çështje 123
c. Hadithet mbi këtë çështje 124
d. Mënyra e therjes së kafshëve të cilave u hahet mishi 124
H. NATYRA DHE KUSHTET E GJUETISË 125
a. Përkufizimi i gjahut 125
b. Kafshët, gjuetia e të cilave është hallall 126
c. Veçoritë e gjuetarit 126
d. Mjetet e gjuetisë dhe format e tyre 126
PËRMBLEDHJE 127

PJESA VI

BETIMI DHE KUSHTIMI 129
A. NATYRA E BETIMIT (JEMIN) 131
a. Kuptimi leksikor dhe terminologjik i betimit 131
b. Natyra e betimit dhe konkluzioni mbi të 131
c. Dobitë individuale dhe shoqërore të betimit 131
B. LLOJET E BETIMIT DHE KONKLUZIONI MBI TO 132
a. Betimi i rëndë 132
b. Betimi i pavlerë 133
c. Betimi i kontraktuar (mun'akid) 133
C. NATYRA E KUSHTIMIT 135
D. KUSHTET E KUSHTIMIT DHE LLOJET E TIJ 135
a. Kushtet që duhet të plotësojë personi që bën betim 135
b. Kushtet që duhet të plotësojë kushtimi 135
c. Llojet e kushtimit 135
d. Konkluzioni mbi kushtimin 136
PËRMBLEDHJE 137

PJESA VII

HALLALLET DHE HARAMET 139
A. HALLALLET DHE HARAMET 141
a. Llojet e haramit 142
b. Allahu bën hallall dhe haram 142
c. Situatat shtrënguese i bëjnë haramet mubah 142
Lexim letrar: *Kurbani* 143
B. HALLALLET DHE HARAMET NË SENDET PËR NGRENIE DHE PIRJE ... 145
I. Haramet Ne Sendet Per Ngrenie 145
II. Haramet ne sendet per pirje 146
III. Haramat ne Fitim 148
IV. Pastrimi nga Harami 149
Lexim letrar: *Kurbani* 150
PËRMBLEDHJE 152

PËRMBAJTJA 153